


BIBLIOTEKA

8JH-32

K 13

THOMA KACORI



DITE QË S'HARROHEN

TIRANË, 1959

8 Sh - 32

R 13

THOMA KACORI

8 Sh - 32
Kac 13

~~26079~~
LIBRIKA E SHTETIT
GJOKASTER

DITË QË S'HARROHEN

(NOVELË)

1288

Botimi i parë i këtij librit
dhe njëri i tretë i përgjithshëm
në Shqipëri. Dëshmorët e Pavarësisë
s'ha bërë librin e tij të dhënë.
Tirana, 1959.

N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËR»

TIRANË, 1959

I

VDEKJA E NËNËS

Do ta filloj tregimin e kësaj historie, që ka të bëjë me jetën time, me ç'mba mënd dhe me ato që më kanë thënë e stërthënë im atë dhe tezja Aishe, e cila më vonë zuri vëndin e nënës sime të dashur. Të gjitha këto më kanë lënë mbresë aqë të thellë në zémër, sa kurrë s'kam pér t'i harruar. Pse, a mund të harrohet ajo që të ka bërë kokën?!

Nënëza ime, e gjora nënëza ime, kishte rënë në rrobat dhe po bënte një mot që po lëngonte e nuk ngrinte dot krye. Kishin ardhur gratë dhe plakat e mëhallës pér ta parë dhe të gjitha i kishin thënë duke përdredhur buzët:

— Gjë s'ke, Nadire! Syri i botës të ka pikur. Pse kush është si ti, moj?! Grua e re, akoma s'ke mbushur të tridhjetat dhe ke bërë katër djem, si katër yj!

Por fjalët e tyre nuk duallén. Nëna sa viinte bëhej keq e më keq. Tani nuk hiqeje dot as zvarrë, si më parë, pér të qeverisur shtëpinë.

Ne fëmija qemë kërthinx e nuk e ndihmonim dot. Dhe të gjitha plakosën babanë. Ngrihej ay, i pari, pa għdir ē mirë, të bënte seftë punët e shtëpisë, pa të dilte jashtë të nxirrte ndonjë lekë. Na zgjonte dhe ne nga gjumi, na lante, na vishte e na mbathte. Dhe pastaj na iepte nga një kothere misérnike në dorë. U bë i shkretti baba si grua, dhe zëvëndësoi nënën e sémurë. Por hallet dhe punët e shumta e bënë dhe nevrik. Kur ndonjë nga ne fëmija nuk rrinte urtë, në vënd që të na merrte me të mirë, përnjëherësh ngrinte dorën dhe na go-

diste. Ahere nëna që nga shtrati, me zë të dobët dhe lutës, i thoshte:

— Mos ashtu, more Hysen, nuk kanë faj fëmija. Ata me lodra do të rriten. Fajnë na e kanë sëmundja dhe fukarallëku...

Ay nuk ja kthente fjalën, por merrte një copë bukë në torbë dhe ndonjë kokë qepë a hudhër, ç'të gjente në dollap, dhe nisej për në punë duke i thënë nënës:

— Nadire, unë po dal të nxjerr ndonjë lekë. Do vete dhe nga Aisheja, t'i them të vijë të të ndihmojë një çikë, se ja dhe ti s'je mirë, s'të ecën!

Dilte babai i kërrusur e i menjuar nga hallet që kishin zënë. Pse, si thotë dhe i vjetri: «Një hall s'të plak kurrë! Vërtet halli më i madh ishte sëmundja e nënës, por dhe të tjerët nuk ishin halle të vogla. Shtëpia dhe sëmundja donin para dhe ay kish marrë borxh tre napolona nga Sali agai, që ja kish dhënë me një qind të lutura dhe e kishin bërë t'ja kthente pas gjash-të muaj. Por afati kishte kohë që kish kaluar dhe huan akoma nuk e kish larë; se nga shkaku i sëmundjes së nënës, babaj një ditë vente në punë e një ditë jo; dhe kur bënte hesap me mënd duke ecur, më fajde e me krerë, i dilnin nja pesë napolona borxh.

Ai si e pa që nëna s'merrte për mbarë, thërriti dhe doktorin.

Erdhi ky një pasdreke me çantë ndënë sqetull në kasollen tonë, në fund, të qytetit. Hyri brënda duke ulur kokën dhe që nga dera pëshpëriti:

— E si të mos sëmuresh në këtë kotec! Këtu të pi notia!

Si e pa nënën, u mbyllën me babanë në të ndarën tjetër, dhe folën gjatë.

Ne fëmija i prisni'n si të hutuar, kruspullo sur në heshtje prapa derës. Vetëm Shabani i vogël, që nuk kish mbushur akoma dy vjet dhe që tërë ditën e mbanim lidhur në djep, qante. Nëna megjithëqë mezi merrte frymë, e tundte duke rënkuar dhe diçka i thoshte në-për buzë për ta qetësuar.

Kur dolli babai me doktorin nga dhòma, dukej shumë i tronditür. Buza e poshtme i dridhej, ashtu si i dridhej nga ndonjëherë kur inatosej dhe sytë i kishte të mbushur si me lot. Ay na shtyri nëpër këmbë, pa na vënë re fare dhe e përçolli doktorin gjer jashtë duke dëgjuar si i shastisur fjalët e tia.

Pas ardhjes së doktorit ne na vunë në të ndarën tjetër. Aty suallën dhe Shabanin me gjithë djep dhe, bashkë me babanë, ne fëmija u vëndosëm ne soba e vogël. Nënën e lamë vetëm filli në vatrën e zjarrit.

Unë ahore nuk isha në gjëndje të kuptoja se ç'kish ngjarë në kasollen tonë, po që qe ndonjë gjë e ligë, shumë e ligë, këtë e mora vesh nga babai, pse zuri të jetë më i heshtur dhe më i rreptë. Dhe ne fëmija filluam, pa na thënë njeri, të mos bëjmë as zhurmë, as fjalë. Lodrat sikur i harruam. Kur dilnim jashtë, e hapnim derën ngadale, si hajdutë, dhe ecnim në majë të këmbëve, sikur ishim në shtëpi të botës. Vetëm Shabani s'pushonte së qari. Edhe për të ngrënë filluam të hamë vec. Për ne që qemë më të rritur ishte kollaj, hanim ç'të hanim, ku thatë e ku me ndonjë kokë qepë a gjizë, por Shabani i vogël, që e zvordhë menjëherë nga gjiri i nënës, pas ardhjes së doktorit, nuk donte të merte vesh, qante sa tundej kasollja e asgjë nuk fuste në gojë. Nëna na thërriste që nga vatra e zjarrit me zërin e saj të dobët e të ngjirrur:

— Sulo, Sulo, Salë, ç'ka Shabani more, tunde një çikë, tunde more Mentor, tunde, xhan' i nënës!

Ne zinim e tundnim si të marrët. Tund e tund sa i trullošnim trutë dhe e zinte gjumi.

Herë pas here Suloja me Salën e hapnin si me frikë derën e konakut të zjarrit. Unë s'guxoja, por fshehur, prapa tyre hidhja syrin brënda, vetëm sa përtaparë një çikë.

Nëna na kanosej, pa lëvizur nga shtrati:

— Mbyllni derën, mbyllni derën! Se s'jam mirë!
— dhe bënte sikur të ngrihej, por koka i binte prapa mbi jastëk si ndonjë popël e rëndë.

Ne rendnim përjashta me zemër të ndrydhur e të trëmbur. Suloja, si më i madh që ishte dhe kuptonte më shumë, ja bënte;

— Nëna do vdesë... dëgjova doktorin unë kur i tha babait: «gruan e ke keq, e ka zënë veremi!» Pse nga veremi kish vdekur dhe Qerimi i Muços, një fqinji ynë.

Sala që ishte më i rreptë ja kthente si me të qarë:
— Gënjen, gënjen!

Unë fillova të qaj me dënesë. Ahere Suloja nxirte nga xhepi dy tri kopsa dhe më thoshte:

— Mentor, na, merri! Kopsat më të mira po të jap, të hekurtat!

— Nuk i dua, nuk i dua kopsat, — ja bëja unë, — pse thua se nëna do vdesë! — dhe i fshija lotët me mëngën e grisur të këmishës, por me bishtin e syrit shikoja kopsat që ndritnin në pëllëmbën e Sulos.

Ay vazhdonte të më qetësonte:

— Unë, o vëllaçko, s'dua të vdesë nëna, por ay tha, dhe pëshpëriste diçka nëpër dhëmbë! Unë qetësoheshë.

Pastaj znim të loznim me kopsa në oborr, që të tre, dhe për një hop i harronim që të gjitha.

Kthehej babai nga puna i lodhur e i rraskapitur, i parruar e gjithnjë i heshtur, dhe ne menjëherë futeshim brënda.

Vetëm babai dhe tezja Aishe hynin e dilnin në kanun ku dergjej nëna, por edhe ata sa i shpinin nënës bukë dhe ndonjë lugë ilaç nga të doktorit.

Nuk e di sepse, por kur e shikoja ilaçin në dorë të babait ose të teze Aishesë, një frikë më rrënqethë trupin dhe më dukej sikur e pija unë dhe ish i hidhur, i hidhur vrer! Dhe çuditesha pse e mundonin me gjëra të tilla nënën e gjorë e nuk i jepnin ndonjë ëmbëlsirë. Unë pandehja se po t'i jepnin hallvë apo sheqer të kuq do të shërohej menjëherë!

Teze Aisheja zuri të vinte më shpesh ndër ne. Ajo na kullandriste tanë ne fëmijët, dhe sidomos Shabanin e vogël. Ç'hiqte e gjora me 'të! I vinte një shishe në gojë, me një llastikë të kuqe, por ay nuk e donte dhe

e nxirte me gjuhë duke u skinjur. Si e shukonte që s'pushonte, e zgidhite nga djepi, e merte në dorë, e tororiste... Ay englendisej pak dhe rekte. E mbante sa e mbante në dorë dhe pastaj e lidhte prapë në djep, dhe menjëherë Shabanin e vogël e zinte gjumi.

Si mbaronte punët ndër ne, teze Aisheja kthehej përsëri, duke nxituar në shtëpinë e saj, ku kish lënë Mershun vetëm.

Ngandonjëherë ne fëmija zhdukeshim rrugëve dhe e linim shtëpinë vetëm filli, me nënën në shtrat dhe me Shabanin në djep.

Zinte Shabani i vogël të qante dhe qante akoma më shumë kur hapte sytë dhe shikonte se nuk kish asnjeri rrotull tij. Ahere nëna zinte të thërriste:

— Sulo, more Salë, ç'u bëre, more Mentor!... — Dhe pastaj mëshonte, — more djaj, ku jini, more... shejtanër! — Dhe si durohej, me fuqitë e saj të fundit, duke u mbajtur anës dhogave të shtratit, ngrihej dale nga dale dhe vente gjer te Shabani i vogël. E shikonte nga larg me mall e me dhemshuri, e megjithë sëmundjen e rëndë, zinte e i këndonte me zérin e saj të dobët e të ngjirrur:

Fli, o bir i nënës fli,
Se je edhe axhami;
Fli, o bir i nënës fli,
More gruri kutruli;
Si asllan të kesh fuqi!
Fli, o bir i nënës fli,
Je i vogël e gjë s'di...
Pa sa ka padrejtësi.
Në jallanan njerëzi...
Ti s'di ç'është varfëri,
Fli, o bir i nënës fli,
Je i vogël e gjë s'di!...

Kënga e saj e ëmbël e qetësonte menjëherë Shabanin e vogël dhe e vinte në gjumë. Dhe flinte ay tanë si ndonjë shqerrë. Kurse nëna e vështronë që nga larg

se si mëerte frymë duke iu ngritur e ulur krahërori; donte ta pushtonte e ta puthte, ta puthte pa pushim, por s'guxonte nga sëmundja të bënte dhe një çap më tutje për nga djepi.

Sa rrinte kështu, si përmendore, e mbështetur pas murit, pa lëvizur as dorën, as kokën, duke vështruar të birin e saj të mbështjellë në djep, me shpërgënji të grisor, por i ngrohtë e i skuqur në fytyrë si lulukuqe, as unë nuk e di! Por, kur ktheheshim ne, e gjenim kështu në këmbë, të gjatë e të hollë, me fytyrë të zbetë e të hequr si të ndonjë shënjtoreje të munduar shumë. Ajo na, e bënte me gishte të rrnim urtë, që të mos zgjonim Shabanin. Dhe ne të tre strukeshim mënjanë, hem të trëmbur, hem të lumtur që kishim parë nënëntona të dashur më këmbë!

Ajo tërhiqej menjëherë në vatrën e zjarrit, duke u mbajtur pas murit dhe duke u kollitur me kollën e saj të thatë.

Nënë, nënë! Për ne këta qenë çastet më të lumtur të jetës sonë, që nuk u kthyen kurrë më! Nënë e dashur, që s't'u gjëzuam dot më tepër... Nënë, nënë! Sajjalë e ëmbël është emëri yt! Dhe tani që e përmënd, pas kaqë vjet, lotë më rrjedhin nga sytë, nga dashuria për ty, o nënë e shtrënjtë! Pse emëri yt është si rreze dielli, i ngrohtë dhe përkëdhelës!

Një ditë Shabani i vogël nuk mbylli sy. Goja i kish lëshuar shkumbë nga të qarët. Tërë ditën e ditës s'kish vënë gjë në gojë. Qumështin, që ja jepnin me shishen e qelqtë, s'e pëlqente, dhe, kur i afroheshim, lebetitej. Gra, plot gra ishin mbledhur në kasollen tonë. Të gjitha ecnin me ngadalë sikur do të zgjonin ndonjë nga gjumi; hynin e dilnin me fytyra të brengosura dhe flisnin pakë e me zë të ulët. Dhe si kurrë ndonjëherë dera e vatrës së zjarrit ishte hapur. Ne fëmija zgjatnim kokën përbrënda; të ndrojtur e me frikë si gjithnjë, por ahore ngrihej nga këndi teze Aisheja dhe na nxirte jashtë. Që nga oborri bënim të shikonim brënda nga dritarja. Ajo që e ulët e pa perde dhe, po

të ngriheshe mbi majën e gishtrinjve të këmbës, mund të shikoje fare mirë brënda, por ne ishim të shkurtër dhe nuk arrinim dot.

Atë ditë teze Aisheja ndënji tërë ditën ndër ne. Si na përzinte përjashta, ajo hynte në të ndarën ku qante Shabani i vogël dhe fillonte ta tundte duke i thënë:

— Shaban i tezes, ç'ju gjeti të keqen tezja! — Dhe qante dhe ajo me dënesë.

Më në fund e kuptuam dhe ne që nëna ishte shumë keq dhe që të tre ja plasëm të qarit.

Nga kuja jonë nëna kish hapur sytë dhe goja, që gjer ahere i ish prerë, i erdhi përsëri e kish filluar të fliste — për shtëpinë, për fëmijët, kish kërkuar babanë dhe më në fund, e prekur nga klithmat tonë, kish kërkuar të na shihte edhe një herë e u kish thënë me grahmë në buzë grave:

— Amani, moj shoqeni... sillmini t'i shoh edhe një herë fëmijët... Shabanin e vogël të nënës!...

Gratë, të mallëngjyera nga fjalët e saj, nă futën brënda. Ne qanim dhe me zor na mbanin që të mos i afroheshim. Teze Aisheja mbante Shabanin e vogël në duar. Foshnja e njozu nënën dhe përpinqej me këmbë e me duar te shpëtonte e të hidhej në krahët e saj. Nëna vetëm sa e shikonte me sytë të hapur si kamare.

E gjora nënë, sa qendryshuar! Buza e poshtme i qe bërë mavi, sytë i qenë venitur, fytyrën e kish të verdhë, si dylli. Oh, kurre nuk do t'i harroj atë fytyrë e ato çaste! Të gjithë qanim të ngashëryer!

Një nga plakat i tha teze Aishesë:

— Aishe, jepja, moj, jepja një çikë djalen në duar, se sëmundja nuk u bë qën e ta kafshojë! Jepja e t'i dalë shpirti gruas së mjerë!

Nëna, me ta prekur Shabanin me dorë, e lëshoi kokën mbi jastëk. Pastaj i duall jargë nga goja, duart i ranë të tendosura anës së shtratit dhe kështu mbaroi.

Gratë, të lebetitura ja rrëmbyen foshnjën nga duart. Ne na përzunë në të ndarën tjetër dhe dy ditë e dy netë nuk na pushonin dot së qari.

TEZE AISHEJA

Pas vdekjes së nënës sonë ndër ne erdhi teze Aisheja bashkë me Merushen, një vajzë e dobët dhe e hollë si shkarpë. Ajo ishte tre katër vjeç, por kishte hedhur boj dhe tregonte më e madhe. Teze Aisheja kishte mbetur e ve shumë e re. I shoqi, xha Dalipi, qe vrrë në lëvizjen e Fierit, dhe që ahore mbante rroba të zeza. Teze Aisheja ishte më e vogël nga babai dhe ngjiste shumë me 'të. Ishte e gjatë dhe me fytyrë të hollë e me tipare të hequra. Ajo ishte thatime dhe e dobët si nëna, por shumë e lezeçme dhe punës i thoshte ku më je. Me ardhjen e saj ndër ne, kasollja sikur u ndryshua. Ajo i leu të dy të ndarat me gëlqere, vetë, si burrë. Leu dhe dyshemetë me baltë. Të gjitha rrobat dhe leckat i shkoi dy herë në alisivë.

Ne fëmija vazhdonim të flinim ne soba e vogël, kurse teze Aisheja flinte në konakun tjetër, bashkë me Merushen dhe Shaßanin e vogël. Dritaret i linte ditë dhe natë hapur.

Babai s'kishte zanat të caktuar — priste dru, ndrejtë kade, bënte mure dhe, kur s'gjente punë në qytet, dilte fshatrave rrotull. Kohët e fundit kish vajtur në Brengas dhe ja vinte, ja jo, një herë në 'dy javë, sa për t'u ndrruar dhe për t'i lënë ndonjë para teze Aishesë. Kur e kalonte natën në shtëpi, ay flinte bashkë me ne në sobën e vogël, si më parë.

Jeta sikur na u ndryshua edhe neve. Vërtet që e kërkonim nënën dhe shpesh herë qanim fshehurazi, por

sa ishte ajo gjallë rronim me ndrojtje e të trëmbur nga sëmundja e saj. Ahere të gjitha dyert i mbanim të mbyllura dhe kur i hapnim, gjithnjë me frikë, kurse tani hy nim e dilnim duke u sulur që të pesë herë andej, herë këtej si zogj të çliruar nga ndonjë kuvli e hekurt. Edhe Shabani i vogël e mori veten. Ai zuri të eci dhe na ndiqte prapa, dilte në oborr shtra-patra, por ne rrugë s'guxonte akoma të dilte vetëm. Të qarat kishin pushuar.

Apo s'ishte e dashur teze Aisheja! na zgjonte e na vinte në gjumë me të puthura e me fjalë të mira. Kur ngriheshim ne mëngjez i vërtiteshim nëpër këmbë si zogjt' e kloqës dhe kush i kërkonte bukë, kush i ankohej nga ne më të mëdhenjtë. Unë hyja në numurin e të mëdhenjve dhe kjo më bënte krenar. Por nga ana tjetër e kisha zili Shabanin pse teze Aisheja atë nuk e lëshonte nga duart. Dhe një lloj cmiri përbrënda kundër vëllait më të vogël. Veç kësaj, ky qe edhe ters. E merte teze Aisheja në prehër dhe ai na e bënte ne të tjerëvet:

— Teze Aisheja më do mua më sumë, më sumë! dhe u binte duarve.

Ahere Merushja ja kërciste të qarit. Ne të tjerët — Suloja, Sala dhe unë e rrethonim teze Aishenë dhe kush e zinte për dore, kush përkëmbe, kush për cipin e fustanit, si këlyshe të vegjël, që s'kanë hapur akoma sytë.

— Lermëni mor fëmijë, lermëni pa të gjithëve ju do tezja, të gjithëve, — ja bënte ajo dhe hapte krahët e na pushtonte. Edhe Merushja u mësua nga neve dhe e thërriste teze. Ne, kur na pushtonte ashtu të gjithëve, qetësoheshim. Por tani zinte qante Shabani i vogël.

Teze Aisheja i thosh si mënjanë, në vesh:

— Mos qaj ti, Shaban se teze Aisheja ty të do një çikë më shumë nga të tjerët, se ti je më i vogël!

Ne s'bënim zë. Bile mburreshim. Unë për vete time këtë e shpjegoja kështu: «Teze Aisheja na do të gjithëve njësoj, por Shabani është i vogël e s'kupton, prandaj i thotë kështu!».

Teze Aisheja dinte dhe tē qepte, pra diku dukej ndonjë myshteri tē dera jonë, me fëmijën e saj pér do-re. Por ëmos pandehni ju kush e di se çfarë! Se ajo vetë kishte mësuar nga nevoja e qepte këmishë pér fëmijë, pantallona e jekë dhe herë herë priste edhe ndonjë fustan, por me frikë shumë, mos i prishte basmen tjetrës. Me tē ardhur myshterija na shpinte ne menjëherë te soba e vogël si ndonjë kope me shqerra. Ne ecnim më zemër tē ndrydhur duke kthyer kryet e duke shikuar me kureshtje fëmijën dhe zonjën që hynin në tē ndarën tjetër.

Sa gëzoheshim kur rrinim dhe ne ngandonjëherë bashkë me myshterinjtë e teze Aishesë, pse na dukej sikur edhe ne kishim marrë pjesë në qepjen e këmishës apo tē pantallonave!

Merushen ajo gjithënjë e mbante pas vetes. Kur i qaheshim ne: — Merushen pse e lë tē rrije me ty në konakun tënd me myshterinjtë? ajo na përgjigjej:

— Që tē shikojë e tē mësojë. Nesër do tē bëhet grua! Dhe gruaja duhet tē dijë nga tē gjitha!

Këto fjalë, jo vetëm unë, por besoj se edhe Suloja që ishte më i madh nga tē gjithë nuk i kuptonte; megjithatë i bindeshim teze Aishesë dhe dilnim pa i kundërshtuar.

Kur kishte pér tē kthyer ndonjë palë pantallona tē vjetra, ajo ja jepte Sulos pér t'i shqepur, pse ky qe i urtë, e dëgjonte shumë dhë punën e bënte me kujdes. Rinte Suloja mbi rrogoz dhe nuk i vinte mëndja as në lodër, as pér jashtë, sikur t'ishte ndonjë i madh.

Kur e shikonte teze Aisheja aqë shumë tē dalldisur pas punës, e vështronte, e vështronte, sikur nuk e kish parë kush e di se qëkur, pastaj e puthte dhe i shoshte:

— Të keqen tezja, ti do më bëhesh mjeshtër i mjeshtërvë!

Penjët i qeronte pastaj një pas një Merushja, me gishtrinjtë e saj tē hollë si gjilpërë.

Sala ishte tjetër. Kur i jepte teze Aisheja për të mbajtur anën e basmës a për të shpënë ndonjë gjë ne soba matanë, e bënte si me pahir e pa qejf.

Teze Aisheja s'më harronte dhe mua, ajo më jepte të heq penjët e qepur kaluar.

Dhe e ndara ku rrinte teze Aisheja i shëmbellente dyqanit të ndonjë rrrobaqepësi vigan me shkurtabiqët e verdhë.

Për ne qenë ditë të kremte: kur kthehej babai dhe i linte teze Aishesë ndonjë para ose kur mbaronte ajo ndonjë punë dhe mirte hakën. Me të marrë pesë a gjashtë lekët, që i paguante myshteriu, teze Aisheja rendte në pazar. Ne losnim të gjëzuar në oborr dhe e prisnim të kthehej me padurim se e dinim që do të na sillte gjëkafsh të mirë për të ngrënë. Por ç'mund të blente ajo me pesë-gjashtë lekë, do të thoni ju? Teze Aishesë i vinte ndore më pak pare të blente shumë gjëra dhe kthehej nga pazari si bletë e plotë. Ne i turreshim përrpara dhe më të lumtur e njente veten ay që arrinte i parita zinte teze Aishenë për dore. Në bisht mbetej gjithënjë Shabani i vogël, por teze Aisheja atë, jo vetëm që e puthte, por e merrte edhe ndër duar.

Shabani e pushtonte teze Aishenë për qafe dhe i thoshte:

— Teze Aise, ç'na solle?

— Nga të gjitha ju kam sjellë, — ja kthente ajo duke e përkëdhelur në faqe.

Po ay s'kish durim, donte t'i shikonte plaçkat sa më parë dhe zinte skinjej. Tezja e qetësonte:

— Prit, Shaban i tezes, të hyjmë brënda se këtu na qeshin bota!

Dhe ne të gjithë rendnim prapa saj, si ndonjë kortezi triumfal dhe hynim në vatrën e zjarrit. Rrinte teze Aisheja në krye të këndit dhe zinte të nxirrte plaçkat me kujdes e i vinte mënjanë në rrugoz — dy bukë të grynya, një plëndës dhe një okë zorrë, një tufë qepë, ca gjizë dhe... një këndeskë me sheqer të kuq dhe pakë hallvë. Pastaj na radhiste sipas moshës, ja jepte sefte Shabanit këndeskën në dorë e i thoshte:

— Pa këndo një herë, Shaban i tezes, si këndon këndez!

Dhe ay ja bënte me zërin e tij të hollë:

— Kikiki...
Ne kërdisheshim së qeshuri!

Pas tij e merte Merushja dhe kështu me radhë.
Kur arrinte këndeska te Suloja, ajo i thoshte:

— Hajde Sulo, hajde të keqen tezja, si më i madh që je, ndaje tani!

Ne të gjithë e pranonim ta ndante Suloja, se ay qe shumë i drejtë dhe ngandonjëherë mbetej dhe pa pjesë. Por ahene teze Aisheja na detyronte të gjithëve t'i jepnim nga një copëzë dhe Sullos i bëhej më tepër. Vetëm Shabani nuk donte t'i jepte. Ay e mirte copën e tij dhe **e llufiste** menjëherë në gojë që të mos kishte se si t'i kërkonte teze Aisheja.

Si hanim këndeskën, tezja na jepte nga një copë bukë të bardhë në dorë dhe dy gishtrinj hallvë dhe ia bënte duke qeshur:

— Hajde, tani dilni losni në oborr, që tezja t'ju bënjë çorbën!

Merushen prapë e mbante brënda.

Ne losnim sa losnim dhe hynim në konakun e tezes, ku të guduliste hundën era e çorbës që zjente duke valuar në një kusi të madhe varur në çengelin e oxhakut. Goja na lëshonte lëng dhe me padurim e prisnim **drekën**, ndofta më me ankth dhe nga i burgosuri çlirimin e tij. Po dhe çorba ama bëhej të lëpinje gjishtrinjt! Dhe hanim, si të pa fryrë, nga një, nga dy sahanë dinga!

III

E DERVISHIT, HALLE FATIMEJA DHE SALI AGAI

Përveç myshterinjve të rrallë të teze Aishesë, ndër ne vinte dhe fqinjja jonë — e Dervishit, një grua e shkurtër sa një bisht lopate dhe shumë llafazane. Ajo hynte si mjegull, pa e ndjerë ne, me punë e pa punë, në konakun e tezes, ose sic i theshnim ne — në vatrën e zjarrit. Shumë herë e thërriste teze Aishenë që nga oborri i saj, pse kasolleth tona na i ndante një avlli me një mur, nj'a një boj njeriu dhe me që qe e shkurtër e s'arrinte dot të shikonte për nga ne, vinte nën këmbë ku govatën e rrobave, ku ngrinte ndonjë gur të madh kllic, se shkallë nuk kishin, dhe zinte të thërriste:

— Aishe, Aishe moj!

Teze Aisheja, zgjate kokën që nga dritarja e vatrës se zjarrit dhe i përgjigjej:

— Ç'do, moj e Dervishit?

— Dil, dil paikë këtu, — ja bënte ajo dhe, duke mos patur durim, me dorë i bënte ca shënja që tregonin kush e di se çfarë i kishte për të thënë!

Me sa kuptoja unë, edhe teze Aishesë ja kishte këndë të këmbenjë dy fjalë me të, por e mbante veten dhe ja kthente prapë që nga dritareja:

— S'ta kam vahtin, moj e Dervishit. Ti je e vetëm dhe ke kohë për të gjitha. Ti një Dervish ke!

— Hajde de, hajde, — ja bënte ajo përsëri me dorë dhe i queshte buza gjer te veshi.

Kjo e qeshur sikur e magjepste teze Aishenë dhe nisej për nga oborri. Shabani i vogël e ndiqte prapa, por ajo i kanosej:

— Ti Shaban, rri këtu, me Merushen dhe me Mentorin! — Dhe Shabani i vogël kthehej duke qarë.

Teze Aisheja nuk kish nevojë as pér govatë, as pér shkallë dhe, kur arrinte pranë murit, kokët e të
dyjave barazoheshin.

Në fëmija kurrë s'i kuptuam fjalët e së Dervishit, pse teze Aisheja nuk na linte t'u afroheshim. Por edhe që nga larg ajo dukej se si jepete e merte me duar e me gojë dhe aqë nxehet nga ato që thoshte sa që pakë nga pakë faqet i skuqeshin e i bëheshin si kokërrzat e ndonjë shege të arirë shumë.

Tezja rrinte sa rrinte, pastaj e linte fqinjën e saj me fjalë në gojë dhe kthehej brënda. Dhe si pér të ndreçur fajnë që kish bërë, e merte Shabanin e vogël në duar e i thoshte tani me të mirë:

— Herë tjetër, Shaban i tezes, nuk do më ndjekësh prapa, — dhe e puthte në faqe.

* * *

Një grua tjetër që vinte herë pas here në kasollën tonë ishte dhe hallë Fatimeja. Kjo qe e kushërrira e xha Dalipit. Hallë Fatimeja ishte plakë dhe e cte çalë-çalë me bastun në dorë. Vinte dhe i binte portës me dorëzën e bastunit dy-tri herë. Ne qemë mësuar me të trokiturit e saj dhe rendnim kush e kush t'i hapte derën më parë.

Hynte plaka dalë nga dalë brënda në vatrën e zjarrit dhe bënte toka me teze Aishenë e zinte vënd në kryetë këndit. Ne fëmija i mblidheshim rrrotull. Ajo çkembente dy-tri fjalë me tezen tonë, e pyeste pér shëndetin e fëmijëve dhe pér Hysenin dhe pastaj vinte rada Jonë. Ajo e donte shumë Merushen dhe kurrë nuk ja prishte, prandaj ne gjithnjë shtyrim atë t'i thoshte.

Dhe ajo i lutej:

— Hallë Fatime, tregona një përrallë.

Dhe hallë Fatimeja nuk e binte rrrotull, sidomos kur i lutej Merushja; dhe zinte menjëherë. Ne e dëgjonim me gojë hapur, si të humbur në një botë tjetër, ku kuçedrat u zinin ujët njerëzisë, pa delnin trima me fletë si dragonjt, dhe i bënин copë-copë me një të rënë hanxhari a topuzi!

LIBRERIA DOLCI
DARFUR ASTER

260 Y9
128

Një ditë na trokiti në derë një i panishtri Dolci teze Aisheja duke rendur në oborr.

— Çurdhëroni, zotni? — i tha ajo.

— Hysenin, — ja bëri ay pa i hequr sytë nga teze Aisheja, dhe shtoi: — Ti mos je e motra e tij?

— Po, unë jam, — u përgjigj ajo si me drojtje. Pastaj i tha: — Hyseni ka dy javë që nuk ka ardhur në shtëpi, punon në Bregas, por nga e djela e presim të vijë.

— Hë, hë, — ja bëri ay, — pastaj shtoi me mburi: — unë jam Saliu, kisha pakë punë me 'të. Kur të vijë i thuaj së e kam kërkuar. Dhe dolli duke i thënë tezes një:

— Adio, zonjë!

Teze Aisheja u kthyte e zbetë dhe e tronditut në vatrën e zjarrit. Ajo e kuptoi që ay ish Sali agai, që akoma nuk i kishim larë borxhin.

Kur erdhi babai në shtëpi, midis të tjerave tezja i tha dhe për Sali aganë.

Ay iu përgjigj:

— As që do t'i vete. Nuk kam ç'ti jap moj motër. Ay do tani shtatë napolona. Shtatë napolona nuk i thonë shaka, nuk janë shtatë lekë! Por ay do shtatë napolona! — përsëriti babai.

Të nesërmend Babai shkoi për në Bregas pa u kthyer nga Sali agai.

Filloi Sali agai të na e zërë më shpesh derën. Dilte teze Aisheja e trëmbur dhe e priste. Ay hynte, si i zoti i shtëpisë, brënda në oborr dhe ahore sikur kujtohej të pyesë:

— A erdhi Hyseni? — E maste me sy teze Aishenë nga koka në këmbë. Gruas së shkretë i vinte turp dhe i përgjigjej me drojtje:

— Hyseni nuk u kthyte as këtë javë, Sali aga!

Ay s'dilte menjëherë nga oborri, por zinte muhabet me ne fëmijët e na pyeste:

— Ti, kolopuç, i kujt je?

— I Hysenit!

— Po ti? — pyeste tjetrin.

— Dhe unë i Hysenit jam! — ishte përgjigjeja.

— Të gjithë të Hysenit jini, bre?!

— Jo, — i përgjigjet teze Aisheja. — çupa, — dhe i tregonte Merushen me gisht, — éshtë imja.

Sali agai nxirte nga xhepi një dorë sheqerka e na jepte nga një të gjithëve.

T'ju them të drejtën unë nuk e urreja Sali aganë, pse ay nuk dukej aq i egër si agallarët e tjerë dhe as na kanosej, as na ulurinte, megjithëqë babai i kish pér të dhënë. Pastaj ay nuk u ngjiste agallarëve të tjerë edhe nga rrrobat. Vishej krrëk. me qillota të tendosura pas këmbës dhe me një pallto bojë kaçke prej kadifeje përsipër. Apo nuk kish çizmet. i ndritnin si pasqyrë. I rruar e i kruar, ay, që atje tej. kundërmonte erë livando.

Si shkonte Sali agai, tezja mëshonte:

— E theu qafën që kurrë mos u ktheftë!

Nga avllija zgjaste kokën e Dervishit dhe i thoshte teze Aishesë me zë të lartë e duke përdredhur buzët.

— Moj po ky Sali agai (pse ajo e njihte; zaten s'kish njeri në qytetin K. që të mos njihte e Dervishit) si shumë dëndur zuri të vijë nga ju?

Dhe tezja, që e dinte se c'ishte e Dervishit, ja thoshte bromp:

— Hyseni i ka pér të dhënë, moj e Dervishit, pa na mbeti në derë, se pérndryshe as do të na i shohë sytë.

— S'e di, s'e di, po... — dhe mblidhte supet:

Një ditë teze Aisheja nuk ja hapi derën Sali agait. Trokiti, trokiti ay dhe iku i zemëruar. Kaluan tri-katër ditë dhe erdhi prapë. Por teze Aisheja edhe këtë radhë e bëri veshin e shurdhër. Dhe neve na kish thënë të mos i bëjmë zë.

U bë Sali agai derr e shkuar derrë dhe iku duke na u kanosur:

— Le të fshihet Hyseni, le të fshihet! Ka se kush ta gjejë! Ay do që ta marrin xendarët pérpara! Do ta shikojë ay se cili éshtë Sali agai!

Ne dridheshim të struktur prapa derës. Sali agai kishte marrë pamjen e tij të vërtetë.

IV

SI NA SHKOI NGA DUART SHABANI I VOGËL

Nuk kishte sëmundje që binte në qytetin K. e të mos hynte në kasollen tonë. Sefte sëmurej Merushja, se ishte shumë e dobët nga trupi. Edhe e shkuara më lehtë të qe, e mposhtëtë menjëherë. Ajo shpesh e zinte shtratin dhe ngandonjëherë dergjej në rrobat një javë, dy. Por këtë radhë e shkuara kish zënë Shabanin e vogël, me të nxehjtë e me ethe. Përpërlej ay si ndonjë zog që i presin kokën. Teze Aisheja i rrinte mbi krye dhe i jepte zemër duke i vënë një leckë të njomur në ballë, që e lagte në një sahan me uthull. Shabani digjej si prush dhe ftyira i kish marrë një ngjyrë të kuqe të ndezur. Teze Aisheja ishte shumë e shqetësuar.

Ne fëmija silleshim nëpër kasolle si të hutuar. Sapo zinte ndonjë shtratin, neve frika e vjetër që na qe rrënjosur nga sëmundja e nënës, na kapte përsëri, dhe këto ditë i jetonim si të tromaksur.

Atë natë teze Aisheja e gdhui pa vënë gjumë në sy. Tërë natën e natës e kaloi duke fërkuar Shabanin e vogël me shëllirë dhe me uthull. Të nesërmen në mëngjes të nxehjtët i ra pakë, por rrinte si i hutuar, as fliste, as shikonte. Sytë i kishte si të therur. Tërë natën kishte folur përqart.

I bëri teze Aisheja Shabanit të vogël kulaçe, çaj. I bleu dhe qumësht, megjithë skamjen tonë. Ne qumështin e hanim kur nuk ja ndjenim lezeten. Por ay s'futi në gojë asnjë pikë çaj, asnjë lugë qumësht!

U tremb teze Aisheja dhe dërgoi Sulon t'i thoshte hallë Fatimesë të vinte menjëherë. Erdhi plaka e shkretë,

çalë-çalë me bastunin në dorë dhe, me të hyrë në vatrën e zjarrit, filloi t'i bënte ç'i vinte ndore. E mori Shabaniñ dhe e ktheu dy-tri herë rrrotull nëpër këmbë me kokën tatëpjetë. Foshnja i hapi sytë dhe zuri të skinjej sikur lutej ta linim të qetë.

Ahere hallë Fatimeja i tha teze Aishesë:

— Sillmë këtu shpejt tre thëngjij të ndezur. Ka marrë sy djali!

U sul matanë teze Aisheja dhe i solli kacinë me tre thëngjij të mëdhenj që nxirnin akoma tym.

E mori hallë Fatimeja kacinë në dorë, ja kaloi dy-tri herë Shabanit, që rrinte si i humbur mbi kokë. Pastaj, duke pëshpëritur diçka nëpër dhëmbë, ja bëri:

— Ptu, ptu, ptu! — përmbi thëngjijt e ndezur. — Pështyni dhe ju, — na tha neve dhe teze Aishesë dhe shtoi: T'i marri goftë largu të ligat!

Pështymë dhe ne që të gjithë me radhë dhe një cërrri dolli nga thëngjijt që u shuan. Kjo qe shënje e mirë dhe hallë Fatimeja buzëqeshi e kënaqur dhe i hodhi fët e fët tre thëngjijtë me kujdes në një leckë, që kish grisur teze Aisheja nga këmisha e Shabanit të vogël; pastaj dolli përashta çalë-çalë pa u kthyer prapa dhe pa na thënë as «rrini me shëndet» e pa bërë toka as me teze Aishenë.

Por Shabani u bë më keq e më mirë jo. Si e pa teze Aisheja ditën e dytë e të tretë që vinte posht' e më poshtë, u hodh gjer në pazar, gjeti ca fshatare nga Bregasi e u bëri rixha t'i thonë Hysenit të vijë menjëherë në shtëpi.

Kur erdhi babai, i palarë, i parruar dhe me rrrobat copë copë, m'u duk si ndonjë hije që vinte pér të marrë Shabanin e vogël.

— Ç'ka djali? — ja bëri ay i shqetësuar me të hyrë në vatrën e zjarrit.

— Edhe unë s'e di, mor vëlla, — ja ktheu teze Aisheja si më ndrojtje dhe shtoi: — po u zhurit nga të nxehtit!

Babai iu afroa, i vuri dorën e ashpër mbi ballë dhe menjëherë i thà teze Aishesë i tronditit:

— Ç'ke pritur, moj Aishe, do thërritür dok... — por ja preu fjalën një e trokitur e fortë dhe pastaj një zë i ngjirrur ja bëri:

— O Hysen, o Hysen Kondi!

U derdh teze Aisheja të hapë derën. Në obor hynë dy xhandarë.

— Ç'urdhëroni? — u tha teze Aisheja e trëmbur, pa i ftuar brënda, pse e dinte që ne fëmija kishim frikë prej tyre.

Ata nuk i kthyen përgjigje, por njëri prej tyre e e shtyri tezen mënjanë dhe hyri me zhurmë të madhe në vatrën e zjarrit. Babai, që po shikonte Shabanin e vogël i brengosur u kthye prapa. Të dy xhandarët kishin qëndruar si dy hunj te dera. Ne u mblohdhëm në lëkurën tonë. Babai u tha:

— Urdhëroni! Urdhëroni!

— Vishu dhe eja me ne në postkomandë, — ja ktheu njëri nga xhandarët dhe shtoi: — S'kemi kohë pér të ndënjur.

— Ç'më doni në postkomandë? — pyeti babai i shqetësuar.

— Atë e di kapteri që na ka dërguar të të marrim! — u përgjegj xhandari tjetër.

Si e pa babai që s'kish se ç'të bënte, ua ktheu ndryshe!

— Mirë de, kur qënka kështu, do të vij, mor të uruar, por të vete njëherë të thërres pakë doktorin, se e kam keq djalën e vogël. — Dhe u tregoi Shabanin në shtrat që dergjej pér vdekje.

Ata hodhën sytë pér nga Shabani, bile njëri prej tyre bëri dy çape përpara dhe si e pa nga larg, i tha prapë babait:

— Vishu dhe eja, me ne, tan! Nuk do vdesë djali pér një sahat gjë!

— Po lermëni, more të uruar, të lahem e të rrühem një çikë, se ja tanë posa u ktheva nga puna dhe jam si ndonjë hamall. Pastaj më vjen turp edhe nga fqinjët të më merrni përpara si ndonjë hajdut. Do të vij vetë pas një çikë.

— Pazarllëke s'do të bëjmë ne këtu, — i thá me inat ay që ish përpara dhe e zuri pér krahu.

— Mos më prek me dorë, — ja bëri babai sikur e thumboi ndonjë grerë dhe e shtyri, rrëmbeu pallton që kish hedhur mbi rrugoz dhe kryejashtë dolli bashkë me xhandarët, duke bluar diçka nëpër dhëmbë.

Strukur prapa drifores, ne i pamë se si duallën që të tre me radhë dhe si njëri nga xhandarët e mylli derën me tërsëllëm. Ahere ja plasëm të qarit. Teze Aisheja na përqafonte e na qetësonte duke mallkuar:

— Sali agai na e bëri këtë, që allahu i shkurtoftë ditët dhe e bëftë hi e shkrumb! Kurrë të mos ngrerë kokë, si gjarpër i vrarë të përdridhet!

Për një hop e kishim harruar Shabanin e sëmurë.

Pritëm të vinte babai pér drekë, por ay nuk erdhi. Teze Aisheja dilte herë pas here te dera dhe shikonte pér nga sokaku dhe si nuk ja zinte syri babanë, ja bënte:

— Shkrumb u bëfsh, me soj e sorollop, o Sali aga!

Nga ndajnatëhera si e pa teze Aisheja se Shabani i vogël u përvëlua nga të nxehjtët, thërriti të Dervishit dhe e la me djalën. Ajo vetë vajti të marrë doktorin.

Kur erdhi doktori dhe e pa, i tha teze Aishesë duke tundur kokën:

— Pse s'më ke thirrur më parë moj grua? Sëmundja ka përparuar shumë dhe shiko ruaj të tjerët! Në asnjë mënyrë të mos futen në këtë dhomë, pse sëmundja është ngjitëse dhe ka plakosur qytetin. Po të kesh mundësi i dérgo në ndonjë shtëpi tjetër!

Që atë natë teze Aisheja na dérgoi te hallë Fatimeja.

Kur u kthyem në shtëpi, s'gjetëm as babanë, as Shabanin e vogël! Teze Aisheja ishte e hutuar, me sy të enjtur. Ne nuk e ndjenim mungesën e babait se qemë mësuar, por e pyesnim tezen pér Shabanin:

— Ku është Shabani, teze Aishe?

— E shpunë në një kopsht me lule, — na përgjigjej ajo e mallëngjyer.

— Pse e latë atje, — ja bënte Merushja e inatosur, pa kuptuar fjalët e teze Aishesë dhe shtonte: — Me kë do të lozim ne tanë?

Teze Aisheja ulte kokën dhe sytë i mbusheshin me lot. Nuk dinte se si të përgjigjiej prandaj mbyllej me ndonjë marifet në sobën matanë dhe qante me dënesë.

Babanë e lëshuan pas një javë. Kur e kishin shpënë në postkomandë kapteri s'ndodhej atje — ish nisur me ngutësi të madhe për në Selcë, ku qe bërë një vrasje dhe atë e kishin futur në bimsë. Xhandarët kishin frikë ta lëshonin pa urdhërin e kapterit.

Në Selcë kapteri qe vonuar një javë të tërë gjer sa zbuloi vrasësit. S'ishte kush e di se çfarë vrasje — gjë e zakonshme: ishin vrarë dy burra për një hasmëri të vjetër. Kur qe kthyer në post komandë, ish kujtuar menjëherë për babanë, ose më mirë për porosinë e mikut të tij Sali agait dhe e kish thërritur në zyrë sipër, e i qe kanosur t'i kthente paratë Sali Agait se ndryshe do ta kishte keq punën! Do ta hidhnin në gjyq e do t'ia merrnin dhe atë kasolle përdhese që kishte, do ta linin udhëve dhe shumë gjëra të tjera.

Kur erdhi babai në shtëpi dhe mësoi gjëmën e mëdha, u bë si i tërbuar. Zuri shante edhe Sali Aganë, edhe kapterin, edhe allahun ...

Për herë të parë atëhere unë e pashë babanë të qante si foshnjë!

V

BABAI NISET PËR NË KURBET

Babai nuk shkoi më në Bregas. Ngrihej në mëngjez, sa lante sytë dhe dilte në qytet. Për drekë s'kthehej. Kur vinte mbrëmave në shtëpi, ecte me çap të rëndë e i menduar. Kasollen tonë e kishte plakosur një heshtje e rrënqethëshme. Dhe zhurma më e vogël na bënte të dridheshim. Kur flinim, qemë si me sy hapur: me kërcitjen më të vogël kërcenim nga rrobat, të lebetitur.

Zinte të fliste babai me teze Aishenë në vatrën e zjarrit. Ne i dëgjonim më veshët ngritur. E merakosur teze Aisheja e pyeste:

— Ç'bëre more Hysen? — Ne e dinim që flisnin për borxhin e Sali agait.

— E ç'të bënj, moj motër! Njeri s'të jep para sot. Vajta te Mehmeti, i thashë dhe Qamilit (Qamilin e kishim kushëri të largët), po a e di se ç'më tha: «O Hysen, ta dish nga unë këtë, po s'lave borxhin e Saliut, njeri s'ka për të të dhënë hua!» «Mor po unë për atë e dua, t'i laj borxhin Saliut, e të mos hyj në burg e të mos turpërohem përpëra botës», ia ktheva unë. «S'kam, kusho,» ma bëri, moj motër, duke tundur supet. Dhe kush s'ka para... ay që është krimbur në lëpushka!

Një natë babai i tha teze Aishesë:

— Sot, në kafenenë e Tolit, takova një të njojur, Kiço ja thonë emrin, niset për në Australi. Më kripë se unë është, porse Petraqi i Nanos i kish dhënë navllon

dhe nj'a dhjetë napolona pér shtëpinë. Si thua, moj Aishe, a të nisem dhe unë?

Teze Aisheja nuk iu përgjigj menjëherë; siç dukej, ajo mejtohej, se shumë kishin vajtur në Australi e gjetkë, por pa kë ishin kthyer, dhe pas pakë ja bëri:

— Ti di vetë si të bësh, more Hysen, unë grua jam, ç'mëndje mund të të jap!

Dy javë me radhë babai dilte me natë dhe kthehej në shtëpi kur ngrysej fare.

Një ditë ay u kthye shpejt dhe i gjëzuar!

— E rregullova punën! — ja bëri, kur hyri në vatrën e zjarrit. — Atij qelbësirës ja lava borxhin! Dhe a e di, moj Aishe? e ndjej veten sikur jam çkarkuar nga ndonjë barrë e rëndë. Do të nisem me Kiçon dhe me ca të tjere pér në Australi. Dhe kondraton e lidhëm. Petraqi i Nanos na i rregulloi të gjitha. Brënda motmoti, më tha mua, do t'i nxjer paratë e navllos dhe ato që më dha të paguanj borxhin. Punën na e ka zënë që këtu. Do të presim dru në pyjet e Australisë. Dhe ty do të të le tri napolonat, t'i kesh hë pér hë, sa t'ju dërgoj më tutje.

Pér një javë teze Aisheja e bëri gati, I lau rrrobat, e androi ... Babai gjatë kësaj kohe bëri një sëndyq të dhogtë pér plaçkat. Me ne qe shumë i dashur, na mirte para duarsh, na përkëdhelte e na puthte me mall si kurrë ndonjëherë tjetër. Dhe unë thosha me vete: «Babai mund të jetë edhe i mirë!» Ditën e fundit teze Aisheja i bëri babait një byrek dhe një kulaçe t'i kishte pér udhë.

Të nesërmen u ngritëm që të gjithë menatë dhe e përcuallëm gjer në agjensi. Me ne erdhi dhe e Dervishit. Babai mua më kish zënë pér dore dhe unë i hidhja çapet si me mburrije. Përpara autobusit ishin mbledhur një tok njerëz. Babai i përshëndeti me kokë. Para se të hipte në maqinë nxori nga qesja ca para të vogla dhe na dha të gjithëve nga një çerek leku. Hem na puthte, hem na thoshte i mallëngjyer:

— Unë po nisem dhe kush e di se kur do të kthehem, por ju ta dëgjoni teze Aishenë, të mos e inatosni, se ajo ju vështron. Dhe të bëhi të ndershëm, të mos na turpëroni shtëpinë ...

Makina buçiste dhe zhurma e saj të shurdhonte vëshët, por fjalët e tij m'u mbërthyen si peronë në zemër dhe kurrë s'kam për t'i harruar!

Teze Aisheja me të Dervishit rrinin kokëulur dukej sheshit që fjalët e mallëngjyera të babait i kishin prekur dhe ato, por akoma më shumë kishin prekur atë vetë, se zëri zuri t'i dridhej dhe, sado që na thoshte neve «mos qani», atij iu mbushën sytë me lot dhe fjalët e fundit nuk i nxori dot nga goja. Na puthi edhe një herë të gjithëve me radhë dhe hyri brënda në makinë. Udhëtarët e tjerë gjithashtu kishin hipur dhe shikonin nga dritaret të mallëngjyer. Sa mall e sa dhëmshuri kishte në shikimet e tyre!

Kur bëri makina të shkonte, të gjithë ja dhanë kujes sikur ndaheshin me njerëz të vdekur!

Ata që nga makina na tundnin shamitë dhe nembetëm me duart përpjetë përpara agjensisë së zbrázur, sikur kërkonim mëshirë gjersa na humbën nga sytë!

VI

ÇUARJA E FËMIJËVE

Dy tre vjet me radhë babai na dërgoi para mirë. Por teze Aisheja dhe ahere nuk hoqi dorë nga zanati. U qepte jo ndonjë këmishë, jo ndonjë jelek fëmijëve të mëhallës, dhe sikur e muarëm pakë veten. Akoma s'i kishim dhënë fare tartakutin fukarallëkut, pse paratë prapë nuk na arrinin për qdo gjë, por për bukë s'vuanim si më parë. Ne më të vegjëlit, Merushja dhe unë, vazhdonim të dilnim zbathur rrugëve të K..., por Suloja dhe Sala, që venin në shkollë, kishin llastika, pallto dhe nga një çantë të meshintë të kuqe, që ua kish dërguar babai nga Australia dhe jo vetëm ne, por të gjithë djemtë e mëhallës i kishin zili.

Vitin kur Suloja ishte në klasën e katërt dhe Sala bënte të tretën, muarëm nga babai një letër, e cila na çqetësoi shumë. Na shkruante se me shëndet ishte mirë, por kish ca kohë që kish mbetur pa punë. Dhe ato dy napolona, që na kish dërguar, na këshillonte t'i prishnim me kujdes, pse i zoti i sharrës ku punonte kish bërë një shkurtim të punëtorëve dhe kalemi kish zënë edhe babanë tonë. Pas kësaj letre muarëm dhe një tjetër. Kjo qe letra e fundit që muarëm prej tij, tre katër muaj më vonë, me të cilën na lajmëronte se nisej nga Brokenhill për në një qytet tjetër, që ndodhet shumë mila larg — Oodnatatao e kish emrin. «Prej andej, — na thoshte babai, — do t'ju shkruaj që të më mësoni adresën dhe të më ktheni përgjigje». Por kaluan javë dhe muaj dhe babai sikur ra në ndonjë pus të thellë në Oodnatatao. Dhe prej andej s'na shkroi më.

Tezja u bë merak, se na plakosi prapë fukarallëku i parë, dhe shpesh do ta shije me sy të buhavitur nga të qarët. Ajo mbeti akoma më keq, pse kur ishte babai në K... e kishte si krahë dhe një shpresë, kurse tani... të gjitha duhej t'i përballonë vetë.

Si mbaroi Suloja klasën e katërt, teze Aisheja deshi ta vërë medoemos çirak në ndonjë rrrobaqepës, të mësonte zanatin për të cilin ajo vetë kishte ëndërruar, por që nuk e kish mësuar dot. Mirëpo rrrobaqepësit e qytetit K... mësonin ahore o fëmijët e tyre, o të të afërmëve të tyre dhe Sulon tonë nuk e pranuan. Pastaj vendosi ta bënte sahatçji. Nuk e di nga i erdhi kjo ndërmënd, por një ditë duallën prapë nëpër qytet. Edhe sahatçji nuk e rregulloi dot, pse në K... kishte pakë sahatçinj, dhe ata pa çirakë. Sahatçinjtë e mbanin të fshehur zanatin e tyre dhe jo nga çirakët, që s'donin t'i shihnin me sy, por dhe nga myshterinjtë. Kur vinte ndonjë te sahatçiu, ky e mirte orën në dorë dhe i hidhte vetëm një sy sa për të parë se ç'kishte, pastaj menjëherë e mbyllte duke përtypur nëpër dhëmbë: Do shikuar me kujdes, mor zot, eja nesër të të them se ç'ka! — megjithë që ay e kish kuptuar fare mirë se një qime e hollë që kish hyrë nga kapaku e kish qëndruar orën.

Si e pa teze Aisheja që edhe sahatçji nuk e rregullloj dot, vendosi ta bënte këpuçar. U ranë rrrotull këpuçarëve të qytetit, por kush kish dy, kush tre çirakë dhe asnjë nuk e mori Sulon tonë. Më në fund kishin vajtur te xha Goli. E vërteta është se ky xha Goli nuk ish këpuçar, por mballomtar. E kishte dyqanë në një barakë të drunjëtë e të vjetër nga ana tjetër e qytetit. Ajo ishte e tymosur dhe e krrusur si vetë xha Goli, i cili megjithëqë nuk ishte shumë plak, e kishte kokën tullace, mustaqet të thinjura dhe punonte me një palë syze të varurë në veshët me spango. Ay ishte burrë i mirë dhe i shtruar, pa djallëzi, megjithatë nuk i ecte, një që nga zanati nuk merrte shumë shumë erë, por ishte dhe i drejtë e i vinte rëndë t'i gënjen e fshatarët që i shpinin opingat e grisura kur vinin në pazar. Se të tjerë mysht

terinj nuk vinin te xha Goli. Ja ky këpucëbërës e pranoi Sulon tonë çirak, pa rrrogë, ta mësonë si mballosen opingat dhe ngandonjëherë ndonjë palë këpucë dhe t'i jepte dhe një vaht bukë — drekën.

Kthehej Suloja mbrëmave në shtëpi dhe teze Aisheja e pyeste:

— E Sulo, si e kalove sot, të keqen tezja?

— Tërë ditën e ditës kam ndrequr perona, teze. M'u copëtuan thonjtë nga të rënët e çekiçit. Shiko, — dhe i tregonte duart e gjakosura. — Apo s'janë ca perona të shtrëmbra e të ndryshkura!

Ahere teze Aisheja ja merte dorën me dhëmshuri në dorë të saj, ja përkëdhelte butë butë përsipër, pastaj ngrihej dhe i bënte një mehlem me dyllë dhe me vaj dhe, para se të binte në rrobat, ja lyente të dyja duart e ja mbështillte me një shami që të mos ndotej. Të nesërmen Suloja ngrihej me natë, me duar të shëruara dhe nisej përsëri në punë.

Ay, nuk ankohej, ishte i duruar dhe, sikur të mos e pyesnim ne ose teze Aisheja, kurrë nuk do të thoshte gjë, por çdo mbrëmje atij i bëheshin këto pyetje:

— E, mo Sulo, sot ç'ke punuar?

— Ç'kam punuar, — përgjigjej ay si i mërzitur, perona kam ndrequr!

— Ç'hëngre për drekë?

— Ç'hëngra, prapë fasule hëngra. Ca fasule të holla, lëng, tri herë i zjen ustai në një ujë!

— A kini myshterinj? — i thoshte teze Aisheja.

— Moj, myshterinj kemi, teze, por ata që vinë ndër ne s'kanë një lopkë në xhep. U thotë ustai: «Për këto mballoma dua një lekë!» Dhe zënë të bëjnë pazar. «Jo, një gjysmë leku», i thotë fshatari. «Hë, hë, një lekë», ja kthen ustai. «Si o? një lekë», i përgjigjet fshatari me inat «unë e shes misrin gjysmë leku okën, ti për dy mballoma të vjetra më kërkon një lekë!» «More ti po t'i kishe shpënë ne Tasi, st'i bënte as për dy lekë; unë t'i bëra, se të kam myshteri të vjetër, përndryshe as që t'i bëja», i përgjigjet ustai. Dhe zënë të kacambasen jo një lekë, jo

një gjysmë leku me orë të tëra. Ndër ne vinë, oj teze, vëtëm me opinga, këpucë as që kam parë gjer më sot. Dhe unë çuditem pse i ndreq këto perona. Bile dje i thashë dhe ustait, por ay m'u përgjigj: «Edhe unë, kur hyra çirak, perona kam ndrequar!» Dhe kaq. Po zanat, oj teze, as që kam për të mësuar!

— Duro, duro, xhan i tezes, — i thoshte teze Aisheja, — pa do të mësosh. Vetëm merak të kesh! A të pëlqen zanati? — shtonte ajo.

— Më pëlqen shumë, — ja kthente Suloja duke mbledhur vetullat dhe prapë thoshte: — Por zanat, oj teze, as që kam për të mësuar unë ne xha Goli!

Suloja ishte vetëm një vit më i madh nga Sala, por ç'ndryshim kishte midis tyre! Suloja ishte i urtë, i qetë dhe i arësyeshëm, kurse Sala ishte i rrëmbyer dhe kryelartë. Edhe nga trupi vinte më i bëshëm. Kur binim të flinim, Sala i thoshte Sulos:

— Kur e shikon se nuk do të mësosh zanat, pse nuk ikën?

— Si të iki! — i përgjigjej Suloja si i çuditur nga këto fjalë.

— Ta lësh xha Golin e të vesh gjetkë!

— Po dhe gjetkë se mos është më mirë, — i përgjigjej prapë Suloja.

— Mund të mos jetë më mirë, por e di mundobare që je përpjekur për mirë dhe s'ke gjetur.

— Sikur s'vamë me teze Aishenë në sa e sa vënde!

Ahere Sala që kishte vendosur për vete ndryshe, i thoshte:

— Pse s'vete në Tiranë, gjetkë, ku të gjesh kësmenë... unë me të mbaruar do të shkoj prej këtej, ta dish...

Unë, që i dëgjoja me kokën futur thellë nën plaf, zija të qaja, që Sala me Sulon do të iknin e do të na linin vetëm, siç na la babai, siç na kish lënë nëna më parë, dhe tërë këto nga moskamja, nga fukarallëku.

Ahere Sala më pushonte duke më thënë:

— Mos qaj ti, Mentor, se edhe sikur të ikim, ne prapë afër do të jemi. Do të vimë shpesh në shtëpi e do të të sjellim sheqerka, hallvë. Dhe unë pushoja duke mejtuar për sheqerkat, hallvën. Goja më lëshonte lëng dhe kështu më zinte gjumi.

Suloja nuk e hapte gojën, por futej në mendime të thella, një luftë përleshej në tërë qënien e tij. Atij nuk i rrihej më te xha Goli se zanat kurrë nuk kish për të mësuar, por nuk i ikej as nga K. Atij i dhimbsej për kasollen përdhese, për kodrat ku loste të djelave me shokët e mëhallës, për udhët e pluhrosura të qytetit. Por nga ana tjetër edhe e shihte se sado të mësonte, prapë si xha Goli do të bëhej një mballonatar dhe jo më te-për. Megjithatë prapë nuk vendoste dot... Të nesërmen ngruhej në mëngjes dhe përsëri, si gjithnjë, çante baltën e rrugëve të K. dhe arrinte me këmbë të lagura te baraka e xha Golit.

Kur Sala mbaroi klasën e katertë ngjau ajo që duhej të ngjiste. Ay nuk deshi të hynte në zanat, pse kishte dëshirë, për të vazhduar shkollën dhe i tha teze Aishesë:

— Teze, unë do të bëj çmos për të vazhduar shkollën! — i vendosur dhe si ndonjë burrë i pjekur.

— Mirë do të bësh, xhan i tezes, — i u përgjigj teze Aisheja, — por unë s'të ndihmoj dot, ti e shikon vetë se në ç'gjendje jemi. Ja dhe babai iku dhe kush e di ku është tanı...

As letër, as gjë nuk na ka dërguar, s'dimë i gjallë është apo jo... Dhe s'vazhdoi dot më tutje, pse zuri t'i dridhej buza dhe lot i rrnidhnin nga sytë.

— Do të vete një herë gjer në Tiranë; mund të më japid ndonjë bursë; notat i kam të shkëlqyera! — i tha ay.

Tezja nuk e kundërshtoi më.

Atë javë, më i shqetësuar nga të gjithë qe Suloja, as fliste, as qeshte, po rrinte i menduar dhe mënjanë. Bile na zemërohej dhe ne të vegjëlve kur e trazonim.

— Rrini urtë, — na thosh ay, — se nuk juua kam qejfin.

Dhe ne çuditeshim me të, me ndryshimin e tij. Pse më përpara ay na duronte, i hipnim kalakiç dhe ay vërtitej nepër sobë duke hingëllitur si kalë. Loste me ne symbyllazi dhe ne e donim Sulon më shumë nga të gjithë, se na vinte pas vollës. Por javën e fundit para se të ndaheshim ay u ndryshua fare.

Kur kthehej mbrëmave nga puna, teze Aisheja e pyeste si gjithnjë:

— E, Sulo, si kalove sot, të keqen tezja?

— Ç'më pyet, — ja kthente ay i mërzitur, — si gjithnjë...

Dhe teze Aisheja nuk i fliste më, pse e dinte që dhe me çengel nuk ja nxirnje dot fjalët pastaj nga goja.

Ngrihej Suloja dhe dilte përjashta. Ku vinte, ç'bënte, asnjeri s'e dinte dhe nuk e kuptonte. Për një javë u dobësua, u bë shkarpë.

Mbrëmjen e fundit para se të niseshin, Sala i tha Sulos:

— E, Sulo, a do të vish me mua?

— As unë s'e di, — iu përgjigj ay.

— Unë nesër nisem pér Tiranë, — i tha prapë Sala.

— Mirë, mirë do të bësh, — iu përgjigj dhe kaq.

Atë natë Suloja nuk mbylli sy. Një herë thoshte të vejë, një herë jo; herë po, herë jo. Tërë natën e natës nuk fjeti. Më në fund vendosi të niset me Salën, pa le të dalë ku të dalë. Ja kështu u ndamë një ditë edhe me Sulon edhe Salën.

VII

DITA E PARË E SHKOLLËS

Këtë vit fillova edhe unë shkollën. Teze Aisheja më regjistroi shpejt, që të mos na nxirnin ngatërresa. Më bëri, me tërë moskamjen tonë, një palë pantallona prej basme, më bleu dhe një palë llastika. Ünë hem isha i trëmbur që do të filloja shkollën, hem isha i gjëzuar, pse për herë të parë do të mbathja pantallona të ra në jetën time. Gjer ahore mua më vishnin rrobat e vjetra të Sullos apo të Salës, kurse llastika s'kisha vënë në këmbë. Por me gjithë këto unë e prisja ditën e parë të shkollës me dyshim dhe me frikë. Shpesh i thosha teze Aishesë:

— Teze, nuk do të vete në shkollë, kam frikë nga mësuesja.

Ahere teze Aisheja më merte në prehër dhe më puthite në faqet duke më thënë:

— Të mos kesh frikë nga mësuesja; ajo i do fëmijët. Do të të mësojë të shkruash e të këndosh. Të mos jesh i verbër si ne. S'ka përsë të kesh frikë. Hic të mos kesh frikë, të keqen tezja,

Dhe unë sikur qetësohesha.

Më në fund erdhi dhe dita e parë e shkollës. Ishte një ditë vjeshte me diell. Teze Aisheja më ngriti shpejt, më lau e më ndrroi dhe më veshi rrobat e ra dhe llastikat. Në çantën e Salës më vuri abetaren, pllakën dhe një

fletore dhe u nisëm. Mua më dridhej zemra. Kaluam oborrin dhe duallëm në rrugë. Fëmijë të tjerë si unë, me nënët e tyre për dore, po ecnin duke nxituar, kush i gjëzuar, kush duke qarë; të gjithë ecnin me çap të trëmbur dhe duke shtrënguar duart e më të mëdhenjve si për të marrë kurajë. Dielli na ngacmonte me rrezet e tia të ngrohta sikur të na ftonte të loznim nëpër obo-rret e shtëpive, në fushën që shtrihej tutje dhe që nxinte nga arat e punuara. Por ja tani do të na mbyllnin në një dhomë që unë kurrë nuk e kisha parë, por që më dukej si burg; dhe vendosa që, posa të më lëshonte teze Aisheja dorën, t'ua mbathinja këmbëve dhe të mos veja kurrë në shkollë. Por tezja, sikur i kuptoi mëndimet e mia, më shtrëngonte akoma më shumë. Kaluam sokakun e parë, pastaj hymë në një rrugicë të ngushtë. Aty teze Aisheja u takua me një të njohurën e saj, e cila gjithashtu po shpinte të birin në shkollë, dhe duke llafosur jo për këtë, jo për atë, vazhduam rrugën. Unë dhe fëmija tjetër u pamë një herë sy ndër sy dhe kush e di se si, ndofta nga gjëndja jonë e njëjtë, se dhe atë e kishin zënë për dore, më bëri ta ndjeja aqë të afërt, sa kurrë s'kam ndjerë njeri tjetër në botë. Pas pak na dolli përpara dhe shkolla jonë, një godinë e vjetër me dy kate, me dritare të nxira dhe shkallë të drunjta që tronditeshin kur hipnin e zbrisnin fëmija duke kërcyer. Me të hyrë në oborrin e shkollës sikur më zuri njeri përgryke, nuk flisja dot, bile dhe frymë mezi merja. Fëmijët rendnin poshtë e lart dhe unë çuditesha me vëten time si mund të ishin kaqë të gjëzuar. Po kur i vure re mirë, pashë se ata qenë më të mëdhenj dhe e kuptova se nuk vinin për herë të parë në shkollë. Po dhe kjo nuk më qetësoi. Teze Aisheja se si bëri dhe më lëshoi dorën. Unë, sikur prisnja atë, dhe krisa përpjetë pënga dera. Ajo u ndodh e mbyllur dhe tezja më arriu

prapa portës duke më qertuar. Më zuri përsëri për dore, po këtë radhë më shtrëngoi aqë shumë sa dhe gish-trinjtë më dhëmbën. Ajo ma lëshoi dorën kur më futi brënda në klasë.

Mësuesja, një zonjushe e re, me leshra të verdha dhe e qeshur, na priste te dera, e merte secilin nga duart e prindërve dhe e vëndoste nëpër bankat. Ajo kishte një zë të butë dhe fjalët e saj të përkëdhelnin veshin e të bënин për vete. Unë godita të rri përsëri me atë djallën që takova gjatë rrugës. Ky rast na lindi edhe më ngushtë, Zonjushja më pyeti:

- Si ta thonë emrin?
- Mentor, — iu përgjigja unë, duke u skuqur në fytyrë.

- Por ty si të quajnë? — i tha shokut tim.
- Sotir, — iu përgjigj ay me drojtje.
- Ti, Mentor, dhe ti, Sotir, do të rrini këtu bashkë dhe të duheni, të mos ziheni.

Ne rrnim njëri afér tjetrit pa guxuar të kthenim kokën as më të mëngjér, as më të djathë.

Fëmijët, një nga një, po mbushnin klasën. Hynin brënda të drojtur e të turpëruar. Aty priteshin me nën-qeshjet e ëmbla dhe fjalët e ngrohta të mësueses dhe secili jam i sigurtë që thoshte me vete, ashtu si thosha dhe unë: «Nuk qënka kaq e tmerrshme shkolla sa mendova unë!»

Kur të gjitha bankat u mbushën me nxënës, zonjushja hipi në katedër dhe filloi të na flasë. Ajo fliste ngadalë, çkoqur, me buzën në gaz. Ajo na tha se do të jemi si një familje, një familje e madhe, me vëllezër dhe motra dhe se ajo do të ish si nëna jonë.

Sa e dashur që m'u duk! Dhe qërtoja veten për bu-dallallëkun që kisha bërë. Ajo na tha dhe emrin e saj — e quanin Drita. Dhe me të vërtet me ata sytë e kaltër

bojë qelli të saj sikur fuste dritë në shpirratona të errësuara.

Pas një ore ra zilja e parë. Zonjushja na tha të zi-remi për dore secili me shokun e bankës, dhe kështu të dalim në oborr e të zbavitemi pesëmbëdhjetë minuta.

Unë u zura me Sotirin dhe mengadalë duailëm jashtë, por dhe këtu ne nuk guxonim t'i lëshonim duart e njëri tjetrit. Zonjushja që shëtiste midis nesh me një libër të trashë në dorë na u afrua dhe, duke nà përkëdhelur, na tha:

— Këtu lëshojini duart dhe losni si fëmijët e tjerë.

Ne e pamë zonjushen si me turp dhe u futëm në mes të nxënësve të tjerë. Në çast unë e humba Sotirin nga sytë dhe zura të thérres:

— Sotir, o Sotir!

Ay thërriste nga ana tjetër:

— Mentor, o Mentor! Ku je?

Dhe prapë u zumë për dore.

Kur ra zilja për të hyrë brënda, hymë dy nga dy, si shokë të ngushtë.

Kështu mbaroi dita ime e parë e shkollës. Nga një ditë e zyrtë dhe e vrëjtur, ajo u kthyte në një ditë të gjëzuar, në një ditë me diellë.

VIII

SI U RRUKULLIS NJË VIT

Shirat e shpeshtë dhe të rrëmbyer të vjeshtës kishin pushuar. Rrugët ishin tharë dhe balta e ngrirë ndriste si qelq i zi. Kishte ardhur dimri — një dimër i thatë e i ftohtë, me një cingërimë të hidhur. Era e malit frynte herë pas here dhe sillte me vete një dëborë të shkriftë, si hi, që të ngjitej në fytyrë, nëpër duar dhe të digjte. Rrugët e qytetit ishin si të shkreta. Aty këtu do të takoje ndonjë njeri të mbështjellë me shall gjer në sytë. Ndonjë fshatar me gunë kraheve ngiste gomarin e tij përpara të ngarkuar me dru për t'i shitur gjekundi, por nuk thërriste, sikur nuk guxonë të hapte gjënjën nga të ftohtët. Mangaj të ndezur digeshin përpara portave të dyqanëve.

Në këto ditë dimri unë nisësha që menatë, me çantën e Salës kalaqafe, për në shkollë. Sefte kaloja nga Sotiri, pse andaj më binte rruga dhe pastaj, të dy bashkë, si dy lepura të vegjël, rendnim që të mos vonoheshim. Kur arrinim në dhomën e klasës sonë, pori brumbullite me hare dhe fëmijë si ne të mbërdhirë ngroheshin rrëth tij. Faqet u skuqnin si mollë të kuqe nga të ftohtët. Një zhurmë fjalësh të pakuptueshme, të thërritura, të qeshura dhe pastaj binte zilja dhe menjëherë heshtje. Para se të hynte mësuesja në klasë, të gjithë rendnim me nxitim nëpër bankat dhe pas një minute në atë koshere bletësh, po të vije veshin shumë shumë, mund të dëgjoje edhe të rrahurat e zemrave tona. Fillonte mësimi.

Ahere mësonim shkronjat dhe kishim arritur gjë te Q-ja. Gërma Q, si e madhja ashtu dhe e vogla, jo vetëm mua por dhe të tjerëve na dukej shumë e rëndë, sidomos ajo e madhja me bishtin e saj të dredhur përposh.

Të gjithë prisnim me ankth se kë do të nxirrte mësuesja në dërrasë të zezë. Këto hope ishin me të vërtetë të mërzitshme.

Por kjo vazhdonte sa dëgjoje emrin tënd.

— Eja ti, Mentor! — ja bënte zonjushja.

Ahere përnjëherësh e mblidhja veten dhe me çap të pasigurtë drejtohesha për nga dërrasa e zezë. Sa e madhe më dukej ajo, më e madhe se fusha e K. Mirja si me frikë shkumësin në dorë dhe filloja të shkruaja. Shikimet e shokëve sikur më çponin kurrizin.

— Shumë mirë e bëre, Mentor! Hajde tani të shikojmë Q-në e madhe, — ja bënte mësuesja.

Bëja sefte një O të madhe, por atë bishtin tjetër, atë bishtin e përdredhur përposh s'e bëja dot. Nuk më vinte ndërmënd, dora qëndronte në erë si e thatë, Ahere më vinte në ndihmë mësuesja duke thënë:

— Bishti i Q-s së madhe bëhet kështu, Mentor! — Dhe me një copë shkumës tjetër bënte një bisht të përdredhur e të bukur.

Unë e shikoja me gojë hapur dorën e saj të bardhë, e cila dinte të bënte çudira. Nuk kishin bërë çudira këto dy duar, kur na mësuan se si bëhen aeroplanët, vaporët kaiket. O sa gjëra të tjera dinin këto dy duar! Ato mund të të vizatonin ty dhe mua si njeri të vërtetë.

I turpëruar e i skuqur si lulukuqe, unë prisja ndëshkimin, por ajo më përkëdhelte në faqe duke thënë:

— Hajde, shko rri ti, Mentor, dhe le të dalë Sotiri!

Ngrihej i drojtur dhe me frikë edhe Sotiri, Zonjushja Drita i ndihmonte dhe atij. Dhe kështu me radhë dilnin Selimi i shkurtër, Lulja, Afërdita, Dhimitri dhe me të gjithë mësuesja jonë ishte aq e mirë, sa që të çudiste durimi i saj.

Por kishte ditë që edhe ajo nxehet. Ahere ajo nuk fliste, por rrinte e menduar në fronin e katedrës, me shikim të hedhur gjökundi larg. Pastaj pyeste si e zemëruar:

— Selim, pse nuk i ke blerë bojrat?

Selimi i shkurtër bëhej më i shkurtër nga ç'ishte, dhe i përgjigjej:

— Zonjushe, unë i thashë babait!...

— Ahere pse nuk t'i bleu? — përsëriste ajo padashur, pse e dinte fare mirë që i jati i Selimit nuk ja kish blerë bojrat të birit pse nuk i ndodheshin paratë.

Selimi i shkurtër ulej i turpëruar. Po pa bojra nuk ish vetëm Selimi i shkurtër, isha edhe unë, ish edhe Afërdita, edhe Petriti... Zonjushja nuk vazhdonte të na pyeste më tutje, pse e dinte që do të dëgjonte vetëm një përgjigje: «S'kishim me se t'i blejmë!»

Ditët rrukulliseshin njëra pas tjetrës. Koha kalonte si hajdut në errësirën e natës, pa u dalluar prej askujt dhe menjëherë çeli pranvera. Tërë natyra u ringjall. Sefte u zhduk dëbora dhe vëndi u tha, pastaj zunë të shkrijnë akujt e maleve dhe përrënjtë vinin si të tërbuar. Retë nuk mbulonin më qiellin e kaltërt, dielli shkrepte i ngrohtë. Fusha po përtérihej dhe aty këtu dalloheshin lulekaçet e para. Njerzit, të bullandrisur nga të ftohtët e dimrit, sikur shkundeshin nga hallet qysh në ditët e para të pranverës, pse ecnin më lehtë dhe nuk ishin më të mbështjellë me shalla dhe me guna. Çelën edhe pemët. Kumbulla në oborrin e Dervishit u vesh me rrobe të bardha si ndonjë nuse e re veshur me vello dhe me tela. Ditët ahere na dukeshin të gëzuara dhe padashur diçka të shtynte të rendësh, të bredhësh e të këndosh.

Dhe teze Aisheja, me gjithë fukarallëkun dhe hallet e saj, sikur u përtërit. Ngihej menatë e fshinte oborrin dhe, kur kthehej brënda në odën e zjarrit, zinte të na shtynte me radhë:

— Hajde, Mentor, Merushe, ngrihuni se vajti mesi i ditës.

Ne mezi ngriheshim duke fërkuar sytë, venim te pusi dhe atje haheshin kush të lahej më parë. Pastaj unë rrëmbeja një copë bukë në dorë dhe me çantën kalaqafe rendja për në shkollë.

Sa gëzoheshim kur shikonim zogjtë shtegtarë! Sefte vinin dallëndyshet. Fluturonin ato nëpër rrugët e qytetit ose futeshin nëpër hajatet ku kishin foletë dhe ne u afroheshim t'i shikonim më pranë. Pse na dukeshin aqë të bukura? Sikur sillnin me vete diçka përrallore nga vëndet ku kishin qënë! Por ne gëzoheshim më shumë kur shikonim lelekët e parë.

— Lelekët! Lelekët! Lelekët! — dëgjoheshin kudo zëra fëmijësh.

Dhe lelekët, çifte çifte, i vinin rreth e përqark qytetit si për ta përshëndetur. Pastaj drejtoheshin për nga foletë e tyre.

Ne fëmija rendnim të shikonim lelekët e kujt kishin ardhur më parë dhe si gjithnjë sefte vinin lelekët e xha Myrtos: dy lelekë të mëdhenj me qafë të gjata që të shikonin drejt e në sy pa u drojtur fare. I vinin folesë rreth e rrrotull dhe akoma pa zënë vënd mirë do të sillnin kleçka apo fije kashte për ta shtruar e për ta ujdisur. Por ne s'kishim shumë kohë t'u gëzoheshim, kujtoheshim dhe rendnim për në shkollë!

IX

FUNDI I VITIT SHKOLLOR

Erdhi dhe dita e provimevet!

Një të djelë, andej nga fundi i qershorit, ne umblodhëm që menatë në kopshtin e shkollës. Teze Aisheja më kishte qepur një këmishë laragane. Llastikat e lara më shkëlqenin si të qelqta. Dy rrupa, në vënd të tirandave, më kalonin kryq përmbi supe. Si gjithnjë, unë kalova duke rendur për nga Sotiri, i cili po më priste bashkë me nënën e tij me padurim te porta. Nëna e Sotirit më përqafoi dhe më tha duke qeshur:

— Si pëllumb të paska nisur Aisheja sot!

Unë hëm u turpërova hëm edhe më erdhi mirë, pse për herë të parë më shikonin kështu të nisur. Pastaj ajo na tha të dyve duke na përcjellë:

— Dhe shikoni të mos na turpëroni!

Kur arritëm te kthesa e rrugicës, dëgjuam prapë zérin e nënës së Sotirit, e cila po na shikonte me syt e saj të mbushur plot lot:

— Dhe kini mëndjen, kini mëndjen pëllumbat e nënës!

Fëmijët grupe grupe po mblidheshin në oborrin e shkollës. Të gjithë ishin të larë e të ndrruar. Edhe ata më të varfërit kishin veshur robat më të mira që kishin dhe të tërë dukeshin sot sikur nuk ishin ata fëmijët e parë..

Mësuesja kishte ardhur edhe ajo. Bile ajo ishte më e çqetësuar nga ne të gjithë. Hynte e dilte në oborr. Herë na qërtonte të mos thërrisnim. herë buzëqeshte dhe ngandonjëherë mbështetë pas murit dhe hidhte

shikimin e saj gjëkundi larg. Kush e di ç'mendonte zonjushja jonë ahore? Ndofta mendonte për pushimet që, siç na kish thënë, do t'i kalonte në fshat pranë prindërvë të saj; apo mendonte për të ardhmen tonë?! Kush e di, kush e di!

Nga shkolla dolli në oborr drejtori bashkë mësuesit e tjerë dhe me zërin e tij të ngjirur na thirri:

— Fëmijë, radhituni nëpër bankat!

Ne, një nga një, si fajtorë me kokë ulur kaluam përpara mësuesve dhe drejtorit dhe zumë vënd nëpër bankat, të cilat me rastin e provimeve i kishim nxjerë në oborr.

Për të parët e vëndit kishim radhitur karshi nesh nj'a njëzet frona dhe përmbi ta kishim ngritur një si tendë të hapur dhe të mbuluar me rrogozë.

Zunë të vinë dhe njerëzia, rradhiteshin pas froneve, zgjatnin kryet herë më të mëngjér, herë më të djathjtë dhe secili kërkonte të zbulonte djalën ose vajzën e tij dhe kur e gjente i queshte buza dhe një dhëmbje e ëmbël e mundonte për brënda — si do të dalë me provimet? Ç'nota do të ketë? Si do ta thotë vjershën?

Kur erdhi teze Aieshja me nënën e Sotirit, të parët e K. i kishin zënë vëndet. Teze Aisheja u vonua pakë me me Merushen, kurse nëna e Sotirit e kishte të vjehrren plakë të sëmurë e cila mezi e la të dalë. Në fronet e parë, dhe mu në mes, kishte zënë vënd Sali agai. Megjithëqë ishte nën hije, atij i kishte dërsirë ballët dhe herë pas herë fshihej me një shami të mëndafshët që kundërmonte erë livando. Në kraun e djathjtë të tij rrinte një prift me kamillaf në kokë dhe me një kryq të madh të ergjentë varur në qafë. Sali agai seç i thoshte në vesh dhe ay tundte kokën në shënje pohimi. Afër Sali agait kishte zënë vënd dhe një hoxhë me një çallmë të bardhë si dëbhorë në krye dhe me shikim të egër. Pranë tij ishte kryetari i bashkisë drejtori i financës, tregëtarë e nëpunës të tjerë. Prapa tyre vinte populli më këmbë. Dielli kishte kohë që kishte dalë dhe rrezet u binin drejt e nësy, por ata nuk druheshin. Me ankth prisnin të pushonte drejtori dhe të fillonin të dilnin fëmija.

Teze Aisheja mundi tē dëgjonte vetëm fjalët e fundit tē drejtorit:

— Rroftë lart madhëria e tij Zogu i parë!

Disa nga parësia zunë t'u bien duarve dhe u ngritën më këmbë. Populli heshtëte. Nuk e kishin mësuar akoma t'u bjenë duarve pér tē çfaqur gëzimin. Aisheja, që në këtë hop po përpiquej tē më zbulonte mua, mallkoi nëpër dhëmbë:

— Rrini nëpër fronet, mor që ju ndënjtët pér barku ju ndënjtë!

Pas drejtorit e mori fjalën kryetari i bashkisë. Zuri dhe ky t'i binte legenit pér përparimin dhe bujarinë e madhërisë së tij dhe nënës mbretëreshë e tē princeshave që ishin padrone tē sa e sa shoqërive mirëbërëse dhe arsimore.

Populli u mërzit dhe disa nga ata tē fundit zunë tē flisnin midis tyre. Ca nga ca zërat e tyre u shtuan dhe arritën gjer në veshët e Sali agait, i cili hijerëndë, u kthye prapa duke përdredhur mustaqet e tij tē holla dhe hodhi një shikim tē egër me vetulla tē kyçura mbi nj'a katër a pesë veta që se ç'thoshnin dhe qeshnin ngadalë. Pastaj, si u kthye, vështroi kryetarin e bashkisë që vazhdonte tē fliste dhe tha me vete: «Dhe këtij gdhërit ama hiç s'ja pret; more gomar, pse s'flet më shkurtër, sikur nuk e di që këta harbutër nuk marrin vesh nga këto fjalë!»

Por kryetari i bashkisë as që kish ndërmënd tē pu-shonte. Ay filloj tē falnderonte mirëbërësit e qytetit. sidomos tregëtarin e madh Sh., me ndihmat e tē cilit qy-teti K. kishte filluar ta ndryshonte fytyrën e tij...

Gjatë tërë kësaj kohe fëmijët rrinin më këmbë. Por Kasëmi i Shemos, që ishte i dobët dhe i pangrënë, mezi po e mbante veten. Kishte frikë t'i kërkonte leje drejtorit pse qe i rreptë dhe e dinte që do ta qërtonte. Por fuqitë e tij sa vinin po i pakësoshezin fare. Në mëngjëz kishtengrënë vetëm pak përshest me dhallë tē thartë që po i grryente zorrët. Barku i priste herë pas here. Ay shtrëngonte dhëmbët, mblidhej kruspull, por prapë qëndronte më këmbë duke u mbajtur pas bankës. Kur

Kryetari i Bashkise mbaroi fjalimin, atij iu errësuan sytë fare dhe sejte zuri t'i zhdukej qelli, pastaj njerzit dhe më në fund ra përdhe pa nxjerrë zë nga goja. Fëmija që ishin afër tij klithën:

— Kasëmit i ra të fikët! Kasëmit i ra të fikët!

Drejtori rendi për nga Kasëmi. Populli zunë të lë-kunden si valë deti e të shtyhen me njëri tjetrin për të parë se ç'po ngjiste. Parësia po heshtëte. Nga mesi i rrëhit dolli Shemoja. Ay pa shërbëtorin e shkollës që mbante në duar djalën e tij. Shemoja kaloi përpëra parësisë së vëndit, pa i përfillur fare, duke sharë nëpër dhëmbë dhe duke i shkelur.

Pas kësaj ngjarjeje filloi provimi.

I pari dolli Gjika, nxënësi më i mirë i klasës së katërt. Ay iu afrua dërrasës së zezë me çap të sigurtë dhe mësuesi i arithmetikës i dha një problemë.

Gjika u mendua pakë. Pastaj si sprijë filloi ta shpjetonte... dhe e zgjidhi sakaq.

Sali agai e vështronë me një farë cmiri.

Gjika, i biri i furxhiut, i një të humburi, fliste në mënyrë që, ay jo vetëm nuk e kuptonte, por edhe me një lloj epërsie morale që e shtypte fare aganë. Prifti tundte kokën, kurse populli, të gëzuar, flisnin midis tyre:

— Dituria do t'u hapë sytë fëmijëve! Shikoni, more, shikoni Gjikën, më bukur se dhaskali të flet! Goja hekur i pret!

Dhe të tërë kthenin sytë për nga i jati i Gjikës, xha Thanasi, i cili i mallëngjyer dhe me sytë plot me lot, shikonte të birin sikur do ta përqafonte.

— Bravo, paska djalë për kokën e djalit! — thoshin gratë.

Pas Gjikës duallën me radhë vajza e Hasanit, që tha një vjershë nga të Asdrenit, dhe Selimi i shkurtër me Afërditën, që recituan vjershën e Naimit «Zogu dhe djali».

Populli e pëlqeu shumë këtë vjershë. dhe kur mbaruan fëmija, të gjithë zunë të brohoritin. Shumë mendime të errëta u vërtiteshin në kokë; ca i shikonin më qartë. të tjerët nuk i shpjegonin dot, por një gjë e dallonin fare

mirë se liria është gjëja më e shtrënjtë, jo vetëm për njerzit por edhe për kafshët, për çdo gjë të gjallë.

— Ah, i gjori zog, desh vdiq nga meraku, — thoshte me vete teze Aisheja. — Nga brengat as ujët, as buka nuk i shkonte! S'ka si liria.

Zonjushja Drita kishte ndënjur në një fron pranë nesh dhe priste me padurim si do të dilte njëri, pastaj tjetri. Me zërin e saj të ëmbël ajo na ftonte të dilnim nga bankat dhe të thoshnim përparrë të gjithë popullit ato që kishim mësuar gjatë vitit.

— Të dalë Asllan Saliu! — thirri zonjushja Drita.

Asllan Saliu ishte i biri i Sali agait. Ay dolli nga banka krenar, më shumë dhe nga që i jati ishte në radhë të parë, por edhe u turpërua kur pa të gjithë ata njerëz që e shikonin me kureshtje.

Sali agai lojti nga vëndi dhe sikur u zgjua nga ndonjë dremitje, zuri të shtrëngonte gishtrinjtë e duarve.

Asllani dolli përparrë, qëndroi, bëri një përulje dhe filloi të recitonte një vjershë nga të Kristo Floqit përlartmadhérinë e tij. Por që në strofën e parë, ay i hëngri dy tri fjalë dhe ritmi humbi fare. Agai e pa i egërsuar. Po Asllani as që e shikonte të jatin në sy, po vazhdonte të recitonte ku me rimë e ku pa rimë. Nga mesi i vjershës shikimi i Asllanit se si u takua me atë të të jatit, i cili e vështroi me inat. Djali u trëmb dhe mbeti si gurmë këmbë. Asnjë fjalë nuk i vinte ndërmënd. Në kokë sikur i gumëzhinin miza. U mendua dy tri sekonda të kujtohej, por s'kujtohej dot. Ahere e filloi përsëri. Por tha vetëm dy vargjet e para dhe prapë mbetë. Zonjushja Drita përpiquej nga prapa t'ja tregonte, po fjalët e saj, megjithqë arrinin gjer te ay, nuk i kuptonte dot se i ishin shurdhuar veshët të ziut Asllan. Populli zuri të qeshte. Djersa sumbullo-sumbullo mbuloi ballët e babait dhe të djalit, sikur të dy qenë në provim.

Ahere iu afroa Asllanit drejtori e zuri për krahu dhe i tha ngadalë:

— Ti mos e mer me frikë! — Dhe duke u kthyer nga populli shtoi: — Asllanit i kishim dhënë një nga vjershat

më të rënda. Por ju do ta shikoni Asllanin se si reciton tani! — Recito vjershën «Ora!».

Këtë vjershë Asllani kishte tërë vitin që po e mësonte dhe e dinte mirë. Ay mori kurajë dhe filloi. Këtë të paktën e tha mirë dhe në asnjë vënd nuk qëndroi.

Sali agai ahere e mori veten dhe u kthye nga hoxha e i tha:

— Shumë vjersha të rënda u japid fëmijëve, hoxhë efendi!

Dhe hoxha iu përgjigj duke vënë dorën në zemër:

— Allah allah! çudi si i mësojnë këta fëmija!

Gjëndja sikur u qetësua pakë. Asllani u kthye dhe ndënji në vëndin e tij.

Ahere erdhi radha ime. Zonjushja thirri:

— Të dalë Mentor Hyseni!

Me zëmër të ndrydhur, unë bëra pérpara. Njeri nuk guxoja të shikoja në sy. Si nëpër èndër më kalonin dhën, qën i bariut, bariu plak vetë. Kur u pérula pér të pérshëndetur popullin sytë më vanë te teze Aisheja. E gjora teze, me sytë e hapur dollap dhe veshët bërë katër, priste me padurim se si do ta thoshja unë vjershën e Çajupit «Fyelli i bariut»! E mora veten dhe fillova:

Bariu, shokë bariu,
Kur gjëmon e frys veriu,
Eshtë përjashta fatziu,
E rrëh breshëri dhe shiu.

.....

Kur mbarova vjershën teze Aisheja po fshinte lotët dhe më shikonte sikur do të më pështillte të tërin në gjë. Populli brohorisnin. U ktheva në vend dhe më dukej sikur isha në èndërr e sikur fluturonja me krahë.

X

NJË FATKEQËSI E PAPRITUR

Kështu kaluan tre vjet, njëri pas tjetrit. Dhe ndofta do të kishin kaluar dhe shumë të tjerë, po të mos kish ngjarë kjo fatkeqësi e papritur.

Ndër ne jeta s'kishte ndryshuar. Suloja dhe Sala ikën dhe nuk u bënë më të gjallë, si babai që humbi andej nga Australia. Dhe kjo e dëshpëroi fare teze Aishenë. Mëndja i vinte tërë në të ligat dhe megjithëqë donte ta fshinte trishtimin nga ne, ay i çfaqeji në syt e saj të skuqur, që i bëheshin si pufkë nga të qarët dhe pagjumësia. Ngandonjëherë pa dashur bëlbëzonte: «Po dhe ky Hyseni i zi s'u bë i gjallë, se ka fëmijë, se ka motër!» Po menjëherë e mblidhte veten dhe si fajtore ulte kokën të qepët e zinte këndonte ndonjë këngë më të qarë. Edhe këngët e saja tanë qenë të brengosura, të mallëngjyera, të dhimbshme që të tronditnin zemrën, ashtu siç tronditnin zemrën e asaj që i thoshte. Që kur vdiq Shabani i vogël ajo tërë këngët i këndonte në këtë mënyrë: rrinte gjëkundi afër vatrës me fustan në dorë dhe zinte punonte dhe vajtonte, një orë dy, gjersa kujtohej për gjëkafsh e ngrivej menjëherë si nga ndonjë gjumë i rëndë. Myshterinjtë kishin zënë të rrallësohen, pse nga të qarët teze Aishesë zunë t'i prishëshin dhe sytë. Pa ndonjë nga myshterinjtë ankohej:

— Moj Aishe, këtu ma ke qepur shtrëmbër fustanin! Hiç s'e ke qepur mirë!

— Uh, qyqja unë! — ja bënte teze Aisheja, — lere, lere të ta ndreq. Kush e di si më ka shpëtuar!

— Zure të mos shikosh, Aishe! — i thoshte myshterija.

— Jo, jo, me sytë jam akoma mirë! — ja kthente tezja por me vete shtonte e çqetësuar: «Bubu sikur të më lenë dhe sytë! më mirë të futem në dhet e gjallë!».

Gjatë pushimeve teze Aishesë i ndihmoja dhe unë në punët e saj të përditshme si pér të shqepur ndonjë fustan të vjetër, apo pér t'i sjellë ujë nga pusi. Ngandonjëherë më dërgonte edhe gjer nga çarshia pér t'i blerë penjë ose kopsa. Por kur më shikonte të mërzitur ajo vetë më thoshte:

— Hajde xhan'i tezes, shko luaj me shokët tani! — Dhe unë rendnja përjashta si ndonjë qën kur e lëshojnë nga zinxhiri.

Losnim symbyllazi nëpër qoshet dhe prapa portave, ose bakën nëpër pluhurin e sokakëve. Mbrëmave rrinim përpara portave dhe zinim të tregonim historira. Secili përpinqej të shpikte historinë më të bukur e më të çudicëme. Sotiri na e kalonte të gjithëve; ai merte fjalën si ndonjë i madh dhe fillonte:

— Që thoni ju de, tani nuk ka kusarë nga anët tona, por siç më tregon babagjyshi, qëmoti këtu ka pasur kusarë të tmershëm. I zinin njerzit në mes të udhës dhe në mes të ditës, or derë bardhë, dhe i xhvishnin, u merrnin rrobat e trupit, paratë dhe shpesh edhe i vrisnin! Po a e dini se cilët ishin kusarët?!

— Njerëzit e liq! — i përgjigjeshim ne me një zë që të gjithë.

Por ay prapë si ndonjë i madh shtonte:

— Kusarët ishin Turqit, pse ahtere ne ishim nën zgjedhën e Turqisë.

— È, è, turqit? — thoshte me zërin e hollë Kasëmi i Shemos, — babai i quan ata anadollakë! Me të vërtetë të tmershëm kanë qënë! Ata kanë vrarë gjyshin tonë, pse mburrej që ishte shqiptar!

Por vinte nga vinte fjala dhe prapë do të zinim në gojë edhe çështjen e futbollit. Ne kishim formuar shoqërinë tonë, një skuadër, por top nuk kishim. Dhe për natë me këtë i mbyllnim bisedimet tona pa ktheheshim nëpër shtëpitë të pikëlluar.

Teze Aisheja më pa që isha i merakosur, dhe një ditë më pyeti:

— Mentor, ç'ke të keqen tezja, që rri i mejtuar sikur të janë mbytur gjemité?!

— S'kam gjë iu përgjigja unë dhe ndënja pranë saj.

Ajo më vuri kokën në prehër dhe, duke më përkëdhelur më thoshte:

— Thuaj tezes, Mentor, ti e di që tezja për ty kokën bën kurban!

Dhe unë e çfaqa atë që më rëndonte në zemër:

— Teze, i thashë unë, — dua të më blesh një futboll!

Teze Aisheja më shikoi një herë në sy me një shikim të ëmbël dhe të trondit. Pastaj më mori në duar, më pushtoi me të dy krahët dhe m'u përgjigj:

— Futboll të vërtetë nuk do të blej dot, të keqen tezja, po do të të bëj një me lecka. Lecka kemi plot!

Të nesërmen midis fëmijëve të mëhallës nuk kish lajm më të çudiçëm. Ahere zgjodhëm dhe emrin e shqërisë dhe e quajtëm «Skënderbeu».

Pas dy ditë futbolli qe gati, një top i madh i rrumbullaktë, lara-lara nga stofat që i kishin mbetur teze Aishesë nga myshterinjtë. Unë e mbaja nën sqetull dhe të tjerët më vinin pas, si suitë e ndonjë mbreti indian që ecën me saltanet dhe hijerëndë. U nisëm për në fushë. Për fushë kishim zgjedhur një rrugë prapa shtëpisë sonë, që ishte inë e gjërë dhe më e volitëshme për të lojtur, por ku aty-këtu kalonin automobila.

Me të arrirë, u ndamë dhe zgjodhëm portat. Filluam. Topi ishte mjaft i rëndë dhe, kur i binim, nxirte një zhurmë si ndonjë thes i mbushur me kashtë. Suleshim dhe rendnim andej këtej të gjithë tok, si tufë mizash mbi ndonjë pikë mjaltë. Re pluhuri ngrivej përpjetë dhe ne humbisnim nëpër të si hije në errësirën e natës. Dielli përvëlonte, djersët na vinin lumë. Herë pas here dëgjonim si nëpër gjumë borjen e ndonjë automobili dhe e linim për pak lojën gjersa të kalonte maqina dhe pastaj vazhdonim përsëri me zjarrin e parë.

Por për djall kamjonët si për inat kalonin njëri pas tjetrit. Akoma s'kish kaluar i pari, vinte i dyti. Ne rrëmbejim seftë futbollin dhe hidheshim mënjanë.

Kishim kohë që po losnim. Skuadra jonë kish pësuar një humbje të rëndë; na kishin bërë dy gole; ne,asnje, dhe nai vinte plasja. Si kaloi kamjoni i fundit, topin e kisha unë në këmbë; kisha gënjer Sotirin dhe po i afrohesha bekut. Një nga të skuadrës sonë më thërriste me sa zë që kishte:

— Këtu, Mentor! Mentor, këtu! Pasoje, mor, se jam vetëm!

Por unë doja ta bëja vetë golin. Për fat kalova dhe bekun. Përpara meje ishte vetëm portieri, i cili më pa me sy të çakarritur dhe bërtiti sa mundi:

— Mentor, ikë, një automobil!

Unë e dëgjova, por pandeha se do të kisha kohë t'i bija dhe të ikja, pastaj a lihej ky rast?! Mbanj mënd që ngrita këmbën t'i bie topit dhe se diçka më shtyri nga prapa dhe unë u përplasa mbi tokë, u rrukullisa dy tri herë, koka më buçti si daulle e çarë dhe pastaj e humba mëndjen.

Kur e mora pakë veten, koka më therte e më çante dhe gojën e kisha të hidhur farmak. Këmbën e djathtë nuk e luaja dot dhe më dukej sikur ma rrithnin si çekan. I hapa pakë sytë dhe si nëpër mjegull a në gjumë pashë fytyrën e brengosur të teze Aishesë që më kishte pushtuar më të dy duart dhe më mbante në prehër. U përpoqa të kuptoja se ku ndodhesha, po më kot. Ca tronditje që mezi i ndjeja, ca pamje të errëta më dilnin pér një hop përpara dhe prapë më zhdukeshin nga sytë dhe rashë në një klapi edhe më të rëndë se e para.

XI

TRE MUAJ NË SPITAL

Nga mesi i natës erdha në vete. Goja më ishte tharë. Desha të kaloja pështymën, por gjuha m'u ngjit pas qielzës dhe dhëmbjet më zunë përsëri, ca dhëmbje të padurueshme dhe zura të thérres:

— Ujë, ujë! Teze Aishe, ujë! — Dhe fillova të qaja.

Një vajzë e veshur në të bardha u vërsul drejt meje dhe më tha duke qeshur:

— Ç'qan kështu sikur je fëmijë? Ti je burrë tani!

Por fjalët e saj, në vënd që të më qetësonin, më tronditën akoma më shumë. Dhëmbjet, etja dhe të nxeh-tët sikur m'u shtuan dhe ja dhashë të qarit akoma më me forcë.

— Ujë! Amani, ujë! — thërrisja unë.

Ajo më vuri një leckë të lagur në gojë dhe unë përpiqesha t'i ndjell ujët, ta gëlltit të tërë leckën e të shuaj etjen që po më përvëlonte të gjithë qënien time, por dora e saj e mbante nga njëra anë dhe me dorën tjetër më fshinte djersët që më vinin si lumë. Ajo më thoshte:

— Pusho, mos qaj! Do të të jap dhe ujë, dhe bukë dhe historira do të të tregonj...

Si shova pakë etjen, e kuptova që nuk ndodhesha në kasollen tonë, që vajza nuk ish teze Aisheja dhe fillova prapë të thérres duke qarë:

— Teze Aishe! Teze Aishe!

— Mos qaj se dhe teze Aisheja do të vijë, — më tha ajo duke më fërkuar kokën.

— Ku jam? ku jam? — vazhdoja të thërrisja unë.

— Në spital je, por mos u trëmb. Çfarë shqiptari qënke ti! Kështu do ta mbrosh ti atdhenë?! Ti nuk je ahere stërnip i Skënderbeut?!

Fjalët e fundit më dogjën më shumë nga dhëmbja e madhe. Tërë frika që më kish zënë u zhduk. Kafshova buzën për të mos u turpruar dhe, duke kthyer kokën mënjanë në jastëk për të fshehur lotët, i thashë i tronditur:

— Jam...

— Ashtu de, — dëgjova si nëpër èndër dhe prapë e humba mëndjen.

Të nesërmen në mëngjes dhëmbjet sikur më kishin lënë pakë. Gjumi, pas mezit të natës e këtej, më kish-te bërë mirë. Por trupin e ndjeja të rëndë të rëndë dhe këmbët nuk i lëvizja dot. Kur hapa sytë vajza ishte prapë afër jastëkut tim.

— Shpëtove, Mentor, shpëtove! Tani je mirë dhe së shpejti do të dalësh prej këtej! Por herë tjetër nuk do të lozesh futboll trugëve të qytetit si këtë radhë!

Dhe i kuptova të gjitha. Më kish shtypur kamioni duke lojtur futboll. Kisha thyer fyellin e këmbës së djathëtë dhe doktorët e spitalit të K. që natën e parë ma kishin vënë në allçi dhe sipas fjalëve të infermierës, ajo do të zirëj aqë mirë, sa që do të bëhej më e fortë së tjetra. Ca nga ca u qetësova, por më vinte shumë keq që s'kisha pranë teze Aishenë.

Zonjushja Vangjeli — kështu e quanin infermierën, — e zëvëndësoi teze Aishenë dhe m'u bë aqë e afërt, aqë e dashur... Vinte nga vinte infermiereja Vangjeli dhe pastaj zinte vënd afër shtratit tim, më vinte termometrën nën sqetull dhe më thoshte:

— Nëmëro, Mentor, pesë herë nga njëqint dhe më thërrit pastaj.

Unë filloja të nëmëroj me kujdes, se mos bëja gabim, pse më dukej që më gabimin tim më të vogël mund të rrezikoja shërimin e këmbës. Si mbaroja i thërrisja infermierës:

— Zonjushe Vangjeli! Zonjushe Vangjeli!

Vinte ajo duke nxituar e duke qeshur, merte termometrin në dorë, e shikonte me kujdes dhe pastaj më thoshte:

— Tridhjetë shtatë, asgjë s'ke, Mentor!

Pastaj si e tundte termometrin dy-tri herë për poshtë, e fuste në një kuti dhe e vinte në xhepin e sipërmb të përparses së bardhë, rrinte pranë meje dhe fillonte të më tregonte historira të mrekullueshme.

Këmbën akoma nuk e lëvizja, por dhe dhëmbje nuk ndjeja. Dita me ditë bëhesha më mirë. Jeta e spitalit më kishte ecur; ushqimi më i mirë se ay i shtëpisë më kishte ndrequr. Një të djelë erdhi të më shikonte dhe teze Aisheja. Vangjelija e solli në dhomën time. Unë flia. Ajo s'guxonte të më zgjonte, por rrinte e menduar, e zhytur në mendimet e saja dhe me njerën dorë fërkonte çarçafin e bardhë të shtratit. Kur i hapa sytë, ajo më pa e mallëngjyer, dhe më tha:

— Si je, Mentor i tezes? — Dhe, pa pritur përgjigje, shtoi: — A të mori malli për tezen?

Unë padashur ja dhashë të qarit, gulçoja, doja të pushoja dhe s'pushoja dot.

— Pusho, pusho, xhan'i tezes, — më thoshte teze Aisheja. — Pusho, të keqen tezja, pa të kam sjellë dhe kabuni, dhe hallvë, nga të tëra të kam sjellë. Nuk më linin të hyja, pa gjer tanë dhjetë herë do të kisha ardhur. Kaq më mori malli, sa nuk e di! Ke të fala shumë nga Merushja, Sotiri, nga Kasëmi, nga të gjithë djemtë e mëhallës. Të gjithë donin të vinin, por filluan shkollën, të keqen tezja!

— Filluan shkollën! — përsërita unë duke qarë.

Teze Aisheja e pa që unë u trondita shumë nga këto fjalë dhe shtoi:

— Ti prapë do t'i arrish, xhan' i tezes. Do t'i arrish dhe në baltë do t'i lesh!

— Të më marrësh, të më marrësh që këtej, — thërrisja unë.

— Mirë, mirë, do të të marr, po thuam si e ke këmbën?

— Ku ta di unë, për të dhëmbur s'më dhëmb, ja, në allçi e kam, — dhe hoqa çarçafin.

Allcia e bardhë i zuri sytë teze Aishesë, këmba e vojtur dhe e verdhë e trëmbi dhe ja bëri:

— Bubu ç'na gjeti, mor bir!

Gjer ahene ajo mendonte se rreziku nuk ishte aq i madh, por kur pa hekurat dhe allçinë e bardhë, misht të venitur, u lebetit. Zuri kokën me duar, ra përmbysh pastaj përmbi këmbën e thyer dhe zuri ta fërkonte.

— Bubu ç'të bëra unë, mor bir! Unë korba e kam fajnë, ç'më lipsej mua të të bëja futboll! Ç'më lipsej mua! — thoshte ajo si më të qarë.

Kur erdhi infermiereja, Vangjelija, për ta lajmëruar teze Aishenë se ora e vizitës kish mbaruar, na gjeti të getësuar. Teze Aisheja më tregoi andrallat e shtëpisë. Unë i thashë të mijat, i fola dhe për infermieren që sillej si nënë e vërtetë:

Teze Aisheja, para se të ndahej, e falnderoi Vangjelinë nga ana e saj duke i thënë:

— Perëndia do të të ndihij për të mirën që ke bërë, moj çupë, se Mentor i është jetim dhe kur i ke bërë të mirë një jetimi, është njësoj sikur ja ke bërë zotit vetë. Dhe të bëj rixha ta shikosh mirë se dhe mua më ka mbetur si peng, më duket sikur ja bëra vetë djalit, unë e zeza, unë kórba! Ç'më lipsej t'i bëja futboll, ç'më lipsej mua! I kam sjellë këtu ca gjëra; ja, merri — pakë kabuni, hallvë dhe ca mollë, i bleva në pazar. me atë takat që kam, merri! Jepi Mentorit, po mer dhe për vete, moj çupë, se e ke hak. Sa mirë që më foli Mentor për ty, Mentor i tezes, ç'i bëri teze kërcureja! — Dhe lotët i rriddhmin çurkë nga sytë.

— Mos ki merak, teto. Mentor tani është mirë, pas ca ditë do të fillojë të ngrihet, pastaj do t'i thyejmë dhe gjipsin e do të ecij më mirë se më parë, — i thosh Vangjelia tezes.

— Nga goja jote në vesh të perëndisë, — ja ktheu tezja, dhe, duke i dhënë gjërat, shtoi: — Po ti e martuar je, moj bijë?

— Jo, — iu përgjigj Vangjelija.

— Ahere zoti ta çpérbleftë me një burrë të mirë! — e uroi teze Aisheja.

Pas kësaj vizite, infermiereja më thoshte gjithnjë:

— Çfarë teze të mirë që ke, o Mentor! Duhet ta duash dhe ta nderosh!

Tre muaj kalova në spital me allçi në këmbë.

Një mëngjez erdhi doktori bashkë me Vangjelinë dhe shërbëtorin e spitalit; xha Panon. Ishte një ditë me diell, por me erë. Jashtë në kopshtin e spitalit tundeshin degët e pemëve, që kishin mbetur lakuriq, si një-rëz të varfër. Ishte vjeshtë e dytë. I qeshur, doktori erdhi pranë meje, më zuri pulsin, u mendua pakë dhe më tha duke tundur kokën:

— Mentor, sot do të të heqim gjipsin! — Pastaj më shpunë në një dhomë të madhe, plot dritare; më vunë në një shtrat mu në mes të dhomës dhe doktori me një çekiç e me një dalte më hoqi gjipsin.

— Tani ngrijeni lehtë më këmbë! — i tha ay infermieres dhe xha Panos.

Infermiereja më zuri nga ana e këmbës së thyer, xha Panoja nga ana tjetër. Unë mblodhë të gjitha fuqitë e mia duke u shtrëmbëruar në fytyrë. Këmba më rëndonte si ndonjë gur i rëndë dhe nuk güxoja të shkelnja me të.

Infermiereja më thoshte:

— Hajde, Mentor, mbaju pas meje dhe përpiku të shkelësh me këtë, me këtë këmbë! — sepse unë zura të rëndoja mbi këmbën e majtë; dhe shtoi: — Mos u trëmb, mos u trëmb!

Xha Panoja nga ana tjetër më shtrëngonte mirë dhe më siguronte me shikimin e tij se nuk do të më dhëmbte.

Doktori që kish ndënjur në një fron për karshi, më thoshte:

— Eja nga unë, eja ngadalë!

— Unë u vara në krahët e xha Panos dhe zura të kërceja, duke çaluar me këmbën e mëngjér dhe duke he-qur zvarrë këmbën e djathët, e cila më kolovatej si ndonjë degë e thyer prej erës.

— Shkel, shkel nga pakë, — më thërriste doktori.

— Shkel, shkel, — dégjohej dhe zëri i Vangjelisë.

Gjersa arrita te doktori u bëra qull në djersë. Isha munduar ta vë këmbën në dhe dy tri herë, por dhëmbja e fortë nuk më kish lënë.

Më vunë në një fron. Doktori u ngrit dhe iku duke thënë:

— Për sot, mjaft! Shpjereni në shtrat!

Si u çlodha pakë, Vangjelija më fshiu djersët dhe më tha me zë të butë:

— Hajde, Mentor, tani të të vëmë në shtrat!

Më zunë prapë pér krahu. Unë zura të çaloja.

— Jo, jo kështu, — më thosh infermiereja, duhet të shkelësh nga pakë.

— Po më dhëmb, — i përgjigjesha unë.

— Këtë radhë nuk do të të dhëmbij, — ja bënte ajo. Dhe unë e lëshoja trupin përmbi këmbën e thyer.

Xha Panoja më nxiste:

— Të lumtë, të lumtë! E bëre si burrat; të lumtë!

Dhémbja sikur u mpi dhe unë çalë çalë, herë duke shkelur mbi këmbën e thyer dhe herë jo, arrita gjer në shtrat.

Kur më vunë në rrobat, infermiereja më t'a:

— Prova e parë dolli shumë mirë!

Pas një javë i vija vërdallë çalë çalë vetë dhomës. Këmba më kishte shkuar.

Erdhi dhe dita e fundit. Teze Aisheja më priste me padurim në oborr. Unë, i mallëngyer, u lashë shëndet të gjithëve me radhë. Infermiereja, Vangjelija, më përçollti gjer te porta. Kur u ndamë, më puthi dhe më porositi duke tundur gishtin:

— Dhe herë tjetër u ruaj, Mentor!

Sa të afërm që më qenë bërë këta njerëz, të cilët më ndihmuin në një nga çastet më të vështira të jetës sime. U largova prej tyre me një dhëmbje dhe një admirim pér të gjithë njerzit që u ndihmojnë atyre që kanë nevojë.

XII

SI IKA EDHE UNË NGA K...

«Më mirë bukë e hi e në shtëpi!» — thotë një fjalë e urtë, por mua më dolli ndryshe. Në shtëpi gjeta përsëri atë urinë e përjetëshme që na ishte qepur që kur qemë lindur. Merushja s'u duk më e rritur, por akoma më e dobët. Ajo ishte hequr e zgjatur si litar i hollë. Sa u gëzua kur më pa në shtëpi! S'dinte ç'të më jepte më parë, për të më bërë qejfin, por mua asgjë nuk më hynte në sy.

Që ditën e parë dërgova teze Aishenë në shkollë të më regjistronte, por drejtori nuk ishte në K., kishte shkuar në një konferencë dhe do të kthehej pas një javë. Sekretarja i kishte thënë se ishte vonë, regjistrimin kishin kohë që e kishin mbyllur! Teze Aisheja u kthye shumë e dëshpëruar në shtëpi pa përgjigje të saktë. Pritëm dhe një javë. Pastaj një mëngjes u nisëm bashkë me teze Aishen dhe vamë drejt e të drejtori. E gjetëm në dhomën e tij përpara një tryeze të mbushur plot me libra e shkresa. Ay na njoihu dhe, pa pritur ta përhëndesim, na tha:

— Vonë, shumë vonë ke ardhur! Ma shpjegoi çështjen tënde sekretarja. Pusho këtë vit. Shokët e tu tani kanë dy muaj që po mësojnë!

— Do t'i arrij! — i thashë unë si me drojtje.

— Regjistroje djalën, — i tha teze Aisheja, — se ka shumë merak për të mësuar.

— Ju do të më mësoni se si të bëj?! — u përgjigj ay si i fyter. — Ne kemi ligje dhe në bazë të tyre veprojmë. — Pastaj zuri, të cflëtësonë disa shkresa i nevrikosur.

Teze Aisheja nuk bindej lehtë dhe ja ktheu:

— Zoti drejtor, regjistroje djalën që të mos mbetet udhëve. Gjynah, jetim është!

Ay u ngrit nga froni, e zuri teze Aishenë për krahut duke i thënë:

— Mot, mot, tani ka kaluar koha, — dhe që të dyve n.a nxori jashtë.

Ora që ishte varur përmbi dhomën e drejtorit ra dhjetë. Ne sikur u zgjuam nga ndonjë gjumë i rëndë dhe u nisëm për në shtëpi, pa çkëmbyer as edhe një fjalë.

Filluan pastaj ditë të plogta dhe pa shpresë. Jeta e mërzitshme e spitalit më dukej shumë më e këndshme. Shirat që kishin zënë të binin ditë për ditë më mbyllën brënda dhe ky burg i detyruar, më ndrydhi fare shpirtin. Ngandonjëherë dilja nëpër shi, rendja gjer nga shkolla, i veja dy tri herë rrötull, pastaj kthehesha përséri në shtëpi, i lagur qull, por në kokë më buçiste zhurma që bënин shokët e klasës. Po, shokët e mi mësonin, kurse unë bridhja udhëve!...

Dhe teze Aisheja ishte shumë e shqetësuar. Me të më parë të lagur, më ndrronte menjëherë dhe zinte të më qërtonte me të mirë:

— Mor Mentor, mor xhan' i tezes, ku del nëpër shi! Pse nuk rri këtu me ne!

Në zërin e saj ndjehej një dhëmbje. Ishte pendimi për ato që më kish thënë, dhe akoma më shumë i rëndonte përgjegjia ime:

— Ç'të bëj këtu?!

— E po ja kështu goditi, mor bir, se mos deshëm vetë, zot i na e solli. — Dhe kokë ulur tezja binte në mendime. Një ditë më tha:

— Duhet të të gjem më ndonjë pünë!

Të nesërmen qëménatë duallém në qytet. E ku nuk vamë?! Hymë nëpër këpucëbérës, robaqepës, tregëtarë, por kudo i gjetëm dyert të mbyllura. Kur u kthyem në shtëpi nga drekëhera gjetëm postjerin përparrë portës.

— Një letër, — tha ay, — për Aishe Dalipin.

— Unë jam, — i tha tezë Aisheja, dhe e tronditur e mori letrën në dorë. Pastaj ma dha mua dhe, megjithë ajo ishte e sigurtë se letra do të qe nga babai Hyseni, më tha: — Pa shiko nga kush e kemi?

Unë e rrëmbeva letrën dhe lexova adresën: Mete Lame, mullixhi, në fshatin Thikës — Kolonjë.

Gëzimi i tezes u zhduk, dhe ajo e dëshpëruar më tha:

— Një kushëriri ynë i parë, ka vjete që s'e kam parë. Dhe ay i gjori s'ka as grua, as fëmijë! Ashtu i shkoijeta me komitaxhillëke!

Hymë brënda, ndënjam anës zjarrit dhe unë zura të lexoja letrën e xha Metes. Dhe ja se ç'shkruante:

«E dashura Aishe,

«Kaloi shumë kohë që s'jemi parë, qëkur u martua Hyseni. Unë jam mirë me shëndet; dëshëronj që kjo letër dhe juve t'ju gjejë mirë. Nga një shofer nga K. mësovë që ti ke mbetur e ve dhe je mbledhur ne Hyseni! Më erdhi shumë keq edhe përvdekjen e Nadiresë. Shkoi e re e gjora dhe nuk iu gëzua dot as fëmijëve, por e thëna është e thënë dhe ne s'kemi se ç'bëjmë! Shoferi më tha se Hyseni s'është në K. Shkruamë ku është. Me Hysenë jemi vërsnikë dhe jemi dashur që fëmijë.

«Mullinjtë ku punoj janë nj'a një orë larg nga fshati dhe më duket sikur jam në ndonjë shkretëtirë. Tani fshatarët e kanë bluar misrin dhe pakë grurë përdimër dhe këtu në mulli jam fare vetëm. E di që ty të kanë zënë fëmija dhe je keq. Po të duash dërgomë ndonjë djalë nga të Hysenit. Këtu ne mua do të mësojë zanat, pa dhe unë ja po plakem tani, ç'nxjer e ç'kam nxjerë përtë do të jenë. Ja ku po të dërgoj edhe dyzet franga. Në mos më dërgofsh njeri, paratë mbaji dhe bleju gjë-kafshë fëmijëve nga ana ime.

«Me kaq i jap fund dhe pres përgjigje me padurim;

«Kushëriri yt: — Mete Lame»

Pas një javë unë kisha zënë vënd në një kamion që vente për në Kolonjë, futur prapa në mes të thasëve të misrit, si ndonjë kërpudhë fshehur në mes të barit. Teze Aisheja bashkë me Merushën, që kishin dalë të më përcillnin, më tundnin duart me lot në sy. Kamioni u nis por ngriti aqë shumë pluhur sa na mbështolli të gjithëve si në ndonjë rrjetë dhe nuk u pamë më me njëri tjetrin. Unë mora udhën përtë xha Meteja, në mullinjtë e fshatit Thikës.

XIII

NJË UDHËTAR I PANJOHUR

Kamioni pō i afrohej një tē përpjete. Unë kisha nxjerrë kryet pérjashta dhe shikoja rreth e pérqark. Numéroja drurët që dukeshin sikur ecnin bashkë me ne, direkët e telefonit, vështroja ndonjë zog tē murrmë e tē shpupurisur, me kokën futur thellë nē qafë dhe me kembët kopsitur pas telit tē hollë. Ay përnjéherësh trëmbej nga buçitja e automobilit dhe fluturonte tutje. Unë e ndiqja me sy gjersa humbiste nē kaltërsirën e qiellit. Larg zbardhnin malet e lartë, kaltëronin pyjet dhe tek tuk, çquhëshin fshatra tē kruspullosur gjékundi nē ndonjë gropë ose mbi ndonjë pllajë. Ngandonjéherë e hidhja shikimin pérpara, ku zbardhët dhe gjarpéronte xhadeja. Po i afroheshim një ure. Që larg dallohej paş murit tē saj një gjë e zezë, e cila sa më shumë i venim pranë, merte pamjen e një njeriu. M'u duk interesante ta vëshgoja nga larg këtë njeri që ngrinte dorën pérpjete e tundte, bënte shënja që tregonin fare qartë se donte tē ndalonte kamionin. Dhe kamioni me tē vërtet qëndroi. Shoferi zbriti më një teneqe nē dorë dhe bëri pér nga pérroi që kalonte nën urë. I panjohuri e ndiqte prapa dhe i thoshte:

— Zoti shofer, mermë gjer nē Prrënjes! Gjer këtu erdhë më kembë, po tē pérpjetën s'e ngjit dot, u lodha dhe s'më bëjnë kembët! Thuaj, sa do?

Shoferi i hodhi një shikim tē dyshimtë dhe i tha:

— Dy lekë!

— Sa pér dy lekë, ja ku i kam, — iu përgjigj ay, dhe nxori me nxitim nga xhepi një shami, ku kish lidhur ca para tē holla, mori dy lekë dhe ja dha shoferit,

i cili posa kish mbaruar, t'i hedhë ujë maqinës dhe po fshinte duart me një leckë.

— Hipë prapa, — i tha ay. — Barra është e rëndë dhe kamioni nuk trondit fare.

I panjohuri as që ua vuri veshin fjalëve të shoferit, u kap pas kapakut, pastaj vuri me kujdes njerën këmbë përmbi rrotën e kamionit dhe kërceu brënda. Ndënji në mes të dy thasëve duke psherëtitur dhe si i çkujdesur, pastaj pa e pyetur unë, me një zë të mekuq filloj të fliste:

— Kam tërë ditën që po ecij, kisha vendosur të veja në këmbë gjer në shtëpi, por u lodha, m'u vranë dhe këmbët. — Dhe më tregoi opingat, që i qenë grisur fare nga poshtë dhe gishtrinjtë i dilnin përjashta si kokë breshke. — M'u mbarua dhe buka, — shtoi ay, — kur u nisa bleva një bukë; thashë se do të më arrinte gjer në Prrënjes, por udha ha dhe gurë; e hëngra që ne kroi i parë. Kam punuar tërë beharë nëpër godinat e K., si mjeshtër, herë herë mbarja dhe gjelqere, tjegulla, gurë, por tani në dimër nuk ka punë dhe thashë, në vënd që të rri e t'i ha paratë nëpër hanet, më mirë vete në shtëpi, pranë fëmijës, pa nga pranvera kthehem përsëri. Dhe vëndosa të veja më këmbë. Plaçka s'kam, punë s'kam, pse t'i jap dhjetë lekë për automobil, thashë me vete, dhe u nisa.

Kamioni po ngjitej përpjetë me ngadalë dhe buçiste sikur qindra ujqër ulérinin sëbashku. I panjohuri vazhdonte të fliste me zë të lartë se nuk dëgjohej nga zhurma e maqinës:

— Gjene qëlloi shofer i mirë, se ka nga ata që, kur të shikojnë në rrezik, duan të të rjepin, ashtu si ata afendikonjtë dhe bejlerët e K., të cilëve u punojmë sa për bukën e gojës. Janë shushunja ata, na pinë gjakun. I shikon të sjellshëm, të veshur mirë, të kuq e të bardhë, kurse ne... keq e më keq!

Ahere i vura re fytyrën e tij dhe rrrobat që kishte veshur. Ishte i zbetë, më mijékér të parruar, të zezë e të pluhrosur. Sytë, megjithëqë i ndrinin, kishin një shikim që tregonin një njeri të vojtur. Në kokë kishte një

shapkë ushtarake të grisur; ngjyra e vërtetë e së cilës nuk mund të çquhej nga pluhuri dhe nga zgjyra. Në supjet i varej një pallto e leshtë prej shajaku, andre përmbi andre. Një palë qillota të gjera, që dukeshin fare mirë se nuk qenë bërë sipas masës së tij, i tundeshin nëpër kofshë. I panjohuri vazhdonte:

— Mbamë mënd mirë, ore djale, as të di cili je dhe i kujt je, por mbamë mënd mirë, dhe ta dish nga unë se njerzit janë si ujqrit; ata që kanë marrë kockën në gojë nuk ua lenë të tjerëve. Ne njerzit jemi edhe më keq se ujqrit, pse për ujqrit gjene ka zot, jemi prapë ne njerzit — i ndjekim me pushkë, i përzémë, i vrasim! Mbi ne s'ka asgjë, se as perëndi besoj unë tani, as allah. Por të të them të drejtën nuk di si t'i shpjegoj këto gjëra. Po më është mbushur mëndja që dhe këto njerzit i kan shpikur, prapë për ndonjë shejtanllék!

Fjalët i dilnin njëra pas tjetrës, si përrua i rrëmbyer kur vjen pas ndonjë shiu të madh dhe sjell me vete gurë dhe kërcunj me një buçitje që të kall datën.

— Ja më thuaj ti: ku është e drejta?! Karshi dhomës së hanit, ku kemi konakun katër veta, ka shtëpinë një bej, një farë Selman bej! Ç'punon e ç'bën as që e di, por ta kam këtu fjalën; ay ka një shtëpi të madhe si pallat, e me një oborr të gjerë me pemë e me lule, dhe është vetëm vetë i dytë. Vete e vjen me automobil. Ka dhe një kalë me shalë dhe pasdrekeve kapardiset e del shëtitje, kurse ne kthehem i të lodhur e të kapitun në vrimën e hanit dhe zjejmë e nuk pëlcasim karshi shtëpisë së beut. Por do të vijë një ditë ama që të gjitha do t'u dalin nga hundët. Ti mbaji mënd mirë fjalët e mia se një ditë, ta dish, do t'u dalin.

Sa besim kishte në fjalët e tij, ky njeri i vojtur dhe i dobët, por që m'u duk i fortë si çelnik.

— Hekuran ma thonë emrin, — shtoi ay, — dhe si hekuri jemi ne të fortë, se jemi të rrahur nga shiu dhe nga breshëri. Pastaj, ne punëtorët jemi shumë, të panumurt, dhe kemi edhe një shtet tonin!

Këtu Hekurani qëndroi dhe mori frymë thellë, pastaj vazhdoi:

— A ke të më japësh pakë bukë, se më ka marrë uria?

Rrëmbeva nga torba një copë kulaçe, që më kish bërë tezja për udhë, i vura dhe një dorë gjizë përsipër dhe ja dhashë. E mori dhe filloi të hante me uri; hem hante, hem fliste:

— Por ka edhe njerëz të mirë, por njerzit e mirë i kanë shtypur njerzit e liq, ujqrit. Po ne duhet të përpinqemi t'ua hamë kokën, se jemi më shumë dhe më të fortë dhe do t'ua hamë!

Kishim arritur vëndin ku Hekurani do të zbriste dhe makina qëndroi. Duke më shtrënguar dorën ay më thoshte:

— Dhe ti, djalë i mbarë, i mbaj mënd fjalët tonë. Hajde, rri me shëndet tanë dhe të faleminderit për kulaçen. Shumë e shijshme ishte. I lumçin duart asaj që e ka bërë. Dhe mos ki qeder: do të ta çpérblenj unë një ditë, pse mali me mal nuk piqet pa njeriu me njerinë do të piqet. — Dhe u hodh mbi xhade.

Makina u nis përsëri. Unë e shikoja i habitur këtë njeri të çudiçëm, i cili vazhdonte të më tundte dorën gjersa makina u zhduk në një kthesë dhe pastaj të gjitha m'u dukën si në ëndërr. U kruspullosa përsëri në mes të thasëve i menduar, duke përfytyruar Hekuranin, që nuk më la të nxirja asnjë fjalë nga goja, e që e dinte se për së shpejti do të zbriste dhe sikur donte të m'i thoshte të gjitha, pa lënë asnjë fjalë nga ato që i rëndonin në zemër.

XIV

MITI, TASI DHE NURÇE BEU

Papritur kamioni qëndroi. Zéri i ashpër i shoferit arriu gjer në veshët e mi, ku isha kruspullosur në mes të thasëve dhe më zgjoi nga ajo dremitje e pashmangëshme që plakos qdo udhëtar në udhëtimet e gjata.

— Djal-o! Djal-o! — po më thërriste shoferi, me kokën nxjerrë jasht dritares së kamionit.

Unë u ngrita më këmbë me gjymtyrë të vrara dhe si i mpirë, iu afrova kapakut dhe u përgjigja:

— Q'do, zoti shofer?

— Do të zbresësh këtu apo do vish gjer Kolonjë? Ja, ay atje është fshati Thikës! — më tha, duke ma treguar me gisht.

Hodha shikimin drejt dorës së shoferit, por menjëherë vura pëllëmbën si strehë mbi ballë, pse dielli më binte drejt e në sytë, feksohej mbi shtresën e hollë të dëborës që kishte rënë gjatë natës dhe nuk më linte të shikoja qartë. Hodha sytë dhe pashë mjaft larg, shtrirë në një pllajë, në formë gjysmë rrëthi, një fshat të vogël.

— Ja, ay atje është fshati Thikës! — tha përsëri shoferi. — Po të duash, zbrit këtu. Do të marrësh këtë udhë dhe do të të nxjerrë drejt e në fshat.

Udha ish e mbuluar me dëborë, por çquheshin fare mirë gjurmat e kuajve dhe gjurma njerzish që kishin lënë vazhdë mbi dëborën e shkriftë.

— Dhe mos ki frikë se sot është ditë pazari, — vazhdoi shoferi — do të takosh njerëz gjatë rrugës sa të duash! — Dhe pa mbaruar fjalën mirë, duallën përparrë nesh dy burra, të mbështjellë me guna të dhira, hipur në kuaj, të cilët i ngisnin me revan.

— O shoko! O shoko! — u thirri ay, e iu fishkëlleu edhe një herë duke futur dy gishta në gojë.

Që të dy kalorësit deshën të qëndronin, por kali i njërit u trëmb nga makina dhe rendi përpara. Tjetri na u afrua pranë, na përshëndeti me kokë dhe si me drojtje na tha:

- Mirë mbrëma. Mos thërritët gjëkafsh?
- Nga ç'fshat jini? — e pyeti shoferi.
- Nga Thikësi, — u përgjigj fshatari.
- Ja dhe ky djali vete për në Thikës; merreni me vete se nuk di udhën! — i tha shoferi.
- Po le të vijë, — ia ktheu ay.

Mora torbën dhe kërceva nga kamioni. Këmbët m'u vranë nëpër gurët e xhadesë, që kishin dalë në vijat e rrotave të automobilit. Çalë çalë, me këmbë të impira dhe të ftohta iu afrova shoferit, u përshëndeta me të dhe bashkë me fshatarin u hodhëm matanë xhadesë.

Shoferi i dha gaz motorit. Makina buçiti dhe u nis. Pas pak u zhduk mbi dëborën e bardhë si ndonjë iriq i zi, duke u rrukullisur për tutje.

Fshatari zbriti nga kali. Ishte një burrë nj'a dyzet e pesë vjeç, i gjatë, me tipare të ashpra, por kishtë shikim të butë dhe têrheqës. Nxori nga hibetë gjysmë të zbrazura një thes të leshtë me vija të bardha dhe të zeza, e bëri si gunë duke i futur njërin çip për brënda dhe më tha:

— Me këtë setrenë tënde të hollë prej pambuku do të ftohesh. Dielli eshtë më të hyrë dhe të ftohtët shtohet tanë mbrëmave këtej nga anët tona. — Dhe më hodhi thesin mbi kokë si çajkë. Pastaj më mori torbën nga duart dhe e futi në hibetë nga ku kishtë nxjerë thesin dhe shtoi: — Hajde tanë të të hipij. në vithet, dhe më rrëmbeu me të dy duart e tij të forta dhe më hodhi mbi kalin, i cili tundte kokën dhe puliste veshët. Nga goja dhe nga hundët i delte një avull i ngrohtë. Pastaj vuri kalin nga ana e tij e mëngjér, shkeli në ca gurë, hodhi këmbën në një litar që varej poshtë si yzengji dhe kërceu i shkathët si ndonjë djale i ri mbi samar. Kali u nis për udhë. Ay u mbështuall vëtë, mirë me gunën, më mbuloi dhe mua këmbët dhe pastaj më tha:

— Nga tē kemi, mor djalë? — E pa pritur përgjigje shtoi: — Ne kush vete?

— Nga K. jam, — iu përgjigja unë, — kam një xha^xhanë tim millona këtu në Thikës. Ne ay po vete.

— Qënke i nipi i Metes! — tha fshatari. — I ka fjalët tē pakta Metja, por është burrë i mirë! Sa do tē gëzohet, se është vetëm, i gjori, në një gropë dhe në mes tē pyllit... por si ta thonë emrin? — pyeti ay pas këtyre arësyetimeve.

— Mentor, — iu përgjigja unë.

— Të rrosh sa malet, o Mentor, — më uroi me gjithë zemër.

Sa çkëmbyem këto fjalë, e arritëm edhe fshatarin tjetër. Ay kishte qëndruar pakë më tutje dhe po priste. Me tē parë bashkëfshatarin e tij që iu afrua dhe e pyeti:

— C'kërkonte ay, o Miti?

Por kali ynë në këto fjalë kaloi përpëra dhe, kur më pa mua fshatari në vithet, shtoi: — I kujt është ky djalë?

— I nipi i Metes, — iu përgjigj Miti.

— T'i rrojë, t'i rrojë, — shtoi fshatari i dytë, një bùrrë zeshkan dhe më pyeti mua:

— Ti për herë tē parë vjen në fshat tënë?

— Po, — iu përgjigja unë.

— Do tē kënaqesh, — shtoi ay. — Fshat për kokë tē fshatit kemi! Kush vjen ndër ne nuk ikën më. Kështu erdhë njëviti ca çobenj dhe mbetën. Edhe Metja kështu erdhë dhe zuri rrënje ndër ne.

Kuajt kishin bërë mjaft udhë. Fshatarët më harruan mua dhe filluan bisedimin e tyre që ndofta e kishin lënë përgjysmë:

— Mor po le që ta rrëmben bereqetin nga duart, por tē detyron t'ja shpriesh edhe gjer Ersekë! — i thoshte Miti.

— Sivjet gjene mirë, — ja ktheu tjetri, me tē qeshur, — se vjet a e mban mënd? ja shpumë gjer Korçë!

— Si nuk e mbaj mënd; vjet tē lashat i kisha shurmë tē mbara dhe unë vajta dy herë.

— Kjo puna e dhjetarit, o Miti, më duket më e rëndë bile dhe nga angaria. Kur punon angari, e di që punon me tē dy krahët, vetëm, kurse për bereqetin punon tërë vëtin e vitit me gra e me fëmijë dhe me tërë gjënë e gjallë.

— Më e rëndë, më e rëndë është o Tasi, se jep bukën e gojës, djersën e gjithë vitit.

Dielli kishte arritur buzë malit, i kuq si flakë. Rrezet e tij shkëlqenin, por nuk ngrohnin. Më të djathtë ngriheshin gjigandë një varg malesh të xhveshur dhe nëpër pllajet e tyre nxinin shtëpitë e dy tre fshatrave, varur nëpër ckërkat si fole zogjsh. Tym i zi që dilte prej oxhaqeve, ngrihej përpjetë dhe pastaj zhdukej, duke u bërë një me qiellin e kaltërt. Ishte ditë dimri, por e kthjellët. Në këto ditë, të ftohtët bie me të perënduar të diellit dhe thëllimi pastaj të than më këmbë. Dëbora kërciste nën çapet e kuajve dhe të ftohët sikur shtohej edhe më tepër. Unë, zënë pas koçaqeve të samarit, i mblojdhë këmbët për më lart dhe u mbështolla më ngjeshur pas gunës. Miti më ndjeu, u kthyte prapa dhe më pyeti:

— Ti, kolopuc, si vete? Mirë je apo ke të ftohtë?

— Mirë, mirë jam, — u përgjigja unë.

— C'bleve në Ersekë? — i tha Miti Tasit.

— Gjysmë oke gaz dhe dy okë kripë. Këtë të shkretë kripë qull e bën ay Peti sikur tanë e ka nxjerrë nga deti. Nj'a dy javë më parë, kisha blerë prapë dy okë, e vuri gruaja në oxhak të thahej dhe një grusht mbeti pastaj. Tërë djallzillëke e kanë. Desha t'i bleja edhe Lirisë një fustan tanë për dimër, por nuk më arrinë paratë.

— Ti sikur kishe nxjerrë një killë misër për të shi-
tur? — ja bëri Miti.

— E mirë de, sa mora nga një killë misër? Gjith-
sej tridhjet e dy lekë. Dy lekë dhashë për gazarin, katër
lekë dhashë për kripën; u bënë gjashtë lekë, njëzet lekë
ja kisha marrë borxh Dhimovicës. Më imbenë vetëm gja-
شتë lekë. Me to ç'të blesh më parë?!

— More ti gjene mirë. Mua më hëngri ay borxhi që
ngrita vjet kur u sëmura. Tani u shërova nga sëmundja,
por do të më zërë veremi, ore! Ta dish, Tasi, s'ka gjë më
të ligë nga borxhi. Vjen dita të paguash fajdenë, dhe të
zënë ethet, ku të futesh, o vëlla. Kam shitur kaq bagëti
dhe s'e laj dot. Kam vendosur sivjet të shes një arë, e ta
laj një herë e mirë. Apo s'është ay Markoja një i pang-
njur, sikur edhe shpirtin të të marrë prapë nuk do të
ngopet. Për pesë napolona ore, po më digjet shtëpia.

Kisha arritur afér një lumi. Kuajt i hynë përmesi dhe po lëftonin me valët e rrëmbyera dhe të shkumbëzuara të ujit. Kali ynë qëndroi të pijë ujë. Miti, si i shastisur gjetkë, sigurisht te borxhi i Markos, e la kalin të shuante etjen. Po zëri i Tasit e zgjoi si nga ndonjë gjumë i rëndë:

— O Miti, g'ë le kalën të pijë ujë? do të ftohet!

Miti i ngriti menjëherë kapistallin dhe i ra me thundrat e llastikave. Kali eci përpara duke lëshuar pika uji nga buzët, që binin si sumbulla në lumë dhe pastaj zhdukeshin.

Përpara nesh na dolli një e përpjetë. Të dy fshatarët si me urdhër, këtu u zbritën kuajve. Desha të zgres edhe unë, por Miti nuk më la, vetëm se më mbështollti akoma më mirë në samar. Kuajt, megjithëqë nuk kishin barrë të rëndë i hidhnin çapet me zor dhe aty këtu shkisnin. Ahere dëgjoheshin zérat e fshatarëve nga prapa:

— Mbaju, Balash, mbaju të keqen, mbaju.

— Hajde, Dori, hajde, bir!

Nga mezi i së përpjetës na arriu një kalorës. Ay ishte i veshur me një brrucë të zezë me thekë dhe me një shapkë të verdhë prej lëkure në kokë. Vetëm sytë i dukeshin, si dy shkëndija në mugëtirën që kishte filluar të binte. Kalorësi e kishte lëshuar kalin me të katra dhe sikur fluturonte si erë e marrë. Ati i tij me shalë, një kalë i zi si korb, e i lartë, shkau, kur kaloi anës kuajve tanë, shpërndau dëborën atje tutje, spërkati kuajt dhe fshatarët, pastaj kthehu kokën të kafshonte doriun e Mitit, i cili u hoq mënjanë dhe u kthyte t'i binte me shqemë. Por ati e mori veten menjëherë dhe, si hëngri një kamzhik vitheve, u nis përsëri me revanin e parë. Kalorësi as nuk i përshëndeti dhe as u foli fshatarëve. Nga shkëndijat që i lëshuan sytë u duk sheshit një lloj mërie e egër.

— U tërbua fare ky Nurge beu, — tha Miti i inatosur. Burri zeshkan u shkund prej dëborës dhe iu përgjigj me një të sharë të rëndë.

— Mor po g'ë ka këtë kalën sikur e pi me verë, — ia bëri prapë Miti.

— Me verë nuk e pi, jo, o Miti — ja ktheu këtë radhë Tasi, — por më djersën tënë. Na rrëmbeu malë, ua

shet çobenjve dhe gjëja jonë le të ngordhnë për të ngrënë ckërkave të Osanjit. Një dru s'kemi ku të bëjmë!

Atje sipër udha ndahej më dysh. Kalorësi mori më të djathtë. Fshatarët vazhdonin:

— Unë them t'i hedhim në gjyq — i tha Tasi dhe shtoi: — Edhe kështu nuk dilet ama! Këta bejlerët e Xhufkës na u futën fare në oborr!

— Duhet të bëhet ndonjë kijamet që t'i zhduknë këta të paudhë, — ja bëri Miti, — me gjyq hic gjë s'do t'u bëjmë! Nurçe beu është bythë e brekë me gjykatësin e Ersekës. Veç një kijamet do t'i gërryenjë këta qënër!

Nata sikur ra përnjëheresh. Yjtë zunë të xixëllojnë në qiell një këtu, një atje, sa e mbushën tërë qiellin si plot me sy fëmijësh që shëndritnin me mijë llamburitje. Kur arrimë në krye të së përpjetës atje ku udha ndahej, fshatarët u ranë kuajve për poshtë. Dhe aty e kuptova se Nurçe beu ishte prej fshati tjetër. Një lehtësi ndjeva në vetvete.

Pas pak u gjendëm përpëra shtëpive të Thikësit. Zhurma arrinte gjer në veshët tanë. Lehnin qëntë, dhëntë blegérinin dhe aty këtu dëgjohej pëllitja e ndonjë gomari. Nga dritaret dalloheshin hije njerzish që venin dhe vinin nëpër të ndarat e shtëpive.

Tasi këtu zuri kalin për kapistalli dhe u ndamë. Hymë nëpër rrugët e fshatit. Një plakë e njobu Mitin dhe e pyeti:

— Nga kështu, o Miti?

— Nga Erseka; kisha vajtur t'i shpie misrin e ko-sheres dhjetarit.

— Hë, ne ja shpumë njëditëzaj, — dhe pastaj me zë të ngashëryer ja bëri: — Mos kishim ndonjë letër nga Sotiri, mor bir?

— S'kishit, teto Lena, s'kishit!

— O zot o perëndi, na humbi Sotiraq ynë andej nga Amerika, na humbi! — dhe u zhduk teto Lena duke pshe-rëtitur nëpër errësirë.

XV

NJË NATE TE MITI

Kali qëndroi përpara një porte të mbyllur. Miti i hoqi pengoren dhe i hapi të dyja kanatet me tërsëllim, pastaj më tha mua:

— Ul kokën! — dhe hymë brënda në oborr. — Me të hyrë kali zuri të hingëllinte.

— Moj grua, Limbi! — thirri Miti.

Limbia dolli sakaq në oborr me një kandil të ndezur në dorë.

— Pse u vonove kaqë, — i thosh ajo duke u afruar me ngadalë që të mos i shuhej kandili prej erës.

Miti nuk iu përgjigji, por më zbriti mua nga kali dhe i tha:

— Po të sjell miq, oj grua!

— Mirë se të na vijë, — ja ktheu ajo, akoma pa më parë.

Unë ahene sikur u zgjova nga ndonjë gjumë i rëndë e i thashë Mitit:

— Zoti Miti, më tre goxha larg, — tha Miti duke shkarkuar kalin, — dhe tanë dimrit eshtë edhe rrezik nga egër-sirat. Sonte do të flesh ndër ne. Nesër menatë do të të shpie vetë, pse nuk kam bluar as misrin e dimrit.

— Si do të të lemë në këtë kohë e në këtë të ftohtë të nisesh për në mulli! — ja bëri edhe Limbia, duke u afruar pranë meje me kandilin në dorë.

Nën dritën e zbehtë të kandilit munda të dalloja një grua të pakë nga trupi, por të ngjeshur. Ishte veshur me cibune të leshtë. Kishte çorape të trasha dhe opinga të

llastikta. Kur u ul tē marrë hibetë, pashë, se çorapet e saj ishin ngjyra-ngjyra, e tē bukura. Ahere shqova dhe fytyrën e saj. Do tē ishte nj'a tridhjet e pesë a dyzet vjeç grua, me tipare pakë tē venitura.

Si shkarkoi barrën, Miti i tha së shoqes.

— Hyni brënda me Mentorin, sa tē rregulloj kalën.

Limbia me hibetë nē dorë shkoi përpara. Unë, i mardhur e i mpirë, mezi hidhnja çapet. Hymë nē një sobë ku brumbulliste një zjarr i madh me dy kërcunj nē vatër. Flaka me gjuhët e saja tē zjarrta hidhej e përdridhej e zhdërvjelltë përpjetë dhe ndrinte tèrë sobën. Të kërciturit e kërcunjve sikur i jepte jetë kësaj dhoma pa njerëz. Dy dyshekë tē linactë shquheshin nga tē dy anët e gllanikut. Limbia i la hibetë prapa derës dhe më tha:

— Hajde, hajde, djalë, — dhe shtoi: — Si ta thonë emrin?

— Mentor, — iu përgjigja unë.

— Hajde, Mentor, rri pranë zjarrit tē ngrohesh.

Si më vuri pranë zjarrit, më solli një jastëk tē mbushur me bar dhe ma mbështeti pas krahëve, pastaj më nxori llistikat nga këmbët duke më thënë:

— Këto llistikat e shkreta mbajnë shumë ftohtë dhe Mandi ynë na qahet shumë prej tyre, — dhe më shtrëngoi gishtrinjtë e këmbës që tē shikonte se mos më kishin ngrirë.

— Po këta tē janë bërë koçan, mor bir! Theki, theki pas zjarrit. Sa vjeç je? — më tha ajo pastaj.

— Dymbëdhjet, — iu përgjigja unë.

— Hë, aq èshtë dhe Mandi ynë. E kam lindur dy javë përpara pashkëve tē mëdha. Atë mot bëri një dimër i madh, që kurrë s'kam pér ta harruar, pse mezi e shpumë nē kishë pér ta pagëzuar.

Në këto e sipër erdhi dhe Miti. Ndënji nga ana tjetër e vatrës dhe i tha së shoqes:

— Ku èshtë Mandi? Akoma s'ka ardhur?

— S'ka ardhur! — ja ktheu e shoqja si fajtore.

— Ç'bëri sot? — e pyeti prapë ay.

— Ç'të bëjë, në këto ditë dimri çmund tē bëjë?

— A grazhdoi? A u dha ujë hajvanëve? A i kreu qetë nē mëngjerez?

— I bëri, i bëri tē gjitha, — tu përgjigj Limbia si e shkarkuar nga ndonjë barrë e rendë.

— Po pastaj ç'bëri?
— Pastaj erdhi Koli i Sotirit, erdhi Vangjeli i Mihalit e një tok djem të tjerë e muarr dhe vanë të shkarraviten.

— Dhe ti e le?

— Po ç'ti bëja, ta kyçim brënda thua ti?!

— Smë vjen keq për gjë, — tha Miti duke tundur kokën, — po do të ftohenet.

Pastaj Limbia dolli jashtë. Miti zuri të më shpjegonte:

— Këtu në fshat s'kemi shkollë, na e mbyllën që vjet dhe fëmija na mbetën udhëve. Dhe pse na e mbyllën? Nga koka jonë! Kishim vjet një mësues shumë të mirë; të zgjuar, por që thua ti... soj evgjiti. Pa u inatosën ca ngå fshati e zunë të llomotitin posht e lart: «Turp, more, për perëndi! evgjiti të na mësojë fëmijët! Këngë do të na e nxjerin! Një korrozi, një i humbur, një shkurtabiq të mësojë fëmijët tanë!» Dhe shumë si këto. Edhe ay ama ishte një finok. Të gjithëve u nxori këngë, që dhe sot e kësaj dite ua këndojnë djemtë. E për kë s'nxori, mor për Ligorë, kryeplakun, mor për Markon, që mban bakall-haniën këtu në fshatin tonë, mor për një Kolë, që kish ardhur nga Amerika dhe këpuste të trasha, për të tërë... Por edhe ata ja bënë benë. Vanë Ersekë, Korçë e u hodhën edhe gjer në Tiranë dhe e përzunë nga fshati. Por ja sivjet fëmija na mbetën udhëve, pa shkollë, dhe bëjnë ç'bëjnë e venë shkarraviten nëpër greminat. Le që grisin rrobat, por dhe do të ftohen!

Namëtë hyri dhe Mandi dhe qëndroi prapa derës këkulur, si fajtor.

Miti u kthyte prapa, e pa, nuk e qërtói, po me zë të butë i tha:

— Ç'u bëre, more bir! Hajde e bëj toka me këtë mikun tonë këtu.

Ay u afrua pranë meje, zgjati dorën e tij të ngrirë dhe me zërin e ngjirur lëshoi një:

— Mirëse na erdhe, — të trashë, por të përzemërt.

— Mirëse ju gjeta, — ja ktheva unë.

Miti na shikonte dhe si e pa që nuk u përqafuam si pas zakonit tonë, ja bëri me zërin e tij të ashpër:

— Përqafojuni, de, -përqafojuni!

Dhe ne u përqafuam si burra të mëdhenj, duke çikur seftë faqen e djathtë, pastaj të majtën.

— A i kë të lagura këmbët, — e pyeti pastaj Miti të birin.

— Tetja më dha çorape të tjera, — iu përgjigji Mandi.

— Ahere rri pranë Mentorit! — dhe Mandi u ul pranë meje.

Limbia na solli darkën. Shtroi në sofër një sahan salçë, sa gjizë e qepë dhe nga një copë pastëрма të pjekur. Buka e misërt avullonte.

— Urdhroni, — tha ajo dhe bëri kryq.

— Moj grua, — i tha Miti që sikur u kujtua për gjësendi, — në hibetë kam një bukë të bardhë, e bleva në Ersekë për djalën.

E shkathët, Limbia u ngrit, mori bukën e bardhë dhe ndënji prapë në sofër. Pastaj theu tri copë për ne të tre burrat dhe na e vuri përrpara. Miti ja bëri:

— C'më jep mua, moj grua, lere për fëmijët. — Dhe e la mënjanë copën e bukës së bardhë dhe rrëmbeu misérnikën në dorë duke thënë:

— Hajde, urdhroni! — duke më vështruar mua.

Dhe filluam të hamë.

Herë pas here Limbia më nxiste:

— Haj, bir, mos ki turp, haj! Me ç'kemi po të gosim, haj!

I lodhur, unë hëngra me oreks të madh, dhe megjithëqë kisha turp, zemërgjerësia e zonjës së shtëpisë dhe fjalët e Mitit e zhdukën drojtjen time.

Pas buke Limbia na solli një sahan dinga me lajthi. I vuri në mes të sofrës, na solli dhe nga një gur të treve dhe na tha:

— Çani nga dy tri lajthi tani! Këto na i ka mbledhur Mandi nga Osanji. Sivjet djemuria mbetën pa shkollë dhe na mblodhën nga ca çaj dhe nga ca lajthi, — dhe shtoi: — Po ti në ç'klasë je, Mentor?

— Në të katërtin, — iu përgjigja unë.

— Po tani si e ke lënë shkollën, apo kini pushime? — u hodh Mandi.

— Jo, s'kemi pushime, ja bëra unë dhe me pakë fjalë ua tregova historinë time.

— Njësoj si këtej qënka dhe andej, — tha Miti, duke tundur kokën e duke trazuar prushin e zjarrit. Pastaj si më inat i ra kërcurit me mashën atje ku dilte flaka më e madhe dhe me mijë shkëndija, si yj të vegjël u shpërndanë nëpër oxhak, fluturuan për lart dhe si me të qeshura u zhdukën. I zoti i shtëpisë u vrënjt në fytyrë, shikimi i tij mori pamje të ashpër.

— Ç'punon yt atë? — më pyeti ay.

— Babai nuk është këtu, iku në Australi për të larë një borxh dhe andej mbeti, nuk e dimë se ku është tanë.

Fjala borxh e tronditi aqë shumë Mitin sa që u drodh i téri dhe shfreu:

Këto borxhe do të na hanë!

Gurët të gjithë i mbanim në dorë, por asnjëri nuk kish filluar të çante lajthi. Muhabeti ynë ishte aqë therës, sa që lajthitë i kishim harruar fare. Dhe Limbia për ta ndrruar fjalën, më tha mua me zë të butë:

— Po si të la nëna, mor Mentor, të dalësh kaq i vogël nga shtëpia?

Kjo pyetje e papritur më preku shumë, buzët zunë të më dridhen nga mallëngjimi dhe iu përgjigja:

— Nuk kam nënë! Nëna më ka lënë të vogël kur ka vdekur!

Limbisë iu mbushën sytë me lot dhe si fajtore më mori kokën në prehër dhe zuri të më përkëdhelte.

Unë fillova të qaja me ngashërim.

Miti u ngrit nga sofa duke thënë:

— Unë po vete të shikoj hajvanët, t'u shtie dhe nga një dorë kashtë. Ti Limbi shtroju fëmijëve të flenë!

— Dhe me çape të rëndë që tronditën tërë dyshemenë prej balte të sobës, ay dolli me një fener në dorë jashtë.

Limbia vazhdonte të më ngushëllonte:

— Pusho, bir, pusho, Mentor, këto janë punët e perëndisë, me perëndinë s'hahemi dot!

Dhe megjithëqë nuk doja të qaja, s'i mbaja dot lotët dhe buzët më dridheshin papushim...

Na vunë të flemë të dy bashkë me Mandin. I lodhur e i tronditür, gjumi më zuri përnjëheresh, një gjumë i rëndë dhe me èndrra të llahtarshme.

Nga mesi i natës u zgjova duke u hedhur përpjetë dhe duke thirrur gjékafsh nëpër dhëmbë. U zgjua dhe Mandi.

— Për gjithnjë ke ardhur këtu? — më pyeti ay me ngadalë.

— Po të më mbajë xha Metja, — iu përgjigja unë.

— Do të të mbajë! Sigurisht do të të mbajë. Xha Metia është shumë i mirë, pastaj ka edhe nevojë. Ehu sa herë i kam blerë cigare e duhan e ja kam shpënë gjer në mulli! I dërgon paratë me ndonjë që ka bluar miell dhe unë ja blej cigaret te Markoja dhe ua mbath këmbëve dhe për një orë vete dhe vij.

Nga ana tjetër e sobës dëgjoheshin të gërriturat e Mitit dhe të Limbisë. Degët e drurëve të oborit tundeshin prej erës dhe hijet e tyre, nën dritën e zbetë të hënës që futej prej dritareve pa perde; pasqyroheshin pas murit të bardhë dhe ndiqeshin njëra me tjetrën pa u arrirë. Qentë lehnin aty këtu dhe një këndez gollash ja dha këngës. Këndesi ishte afër sa që u dëgjuan dhe të rrahuat e krahëve të tij.

— Ky është këndesi ynë, — tha Mandi, duke e njojur nga zëri.

Muhabeti ynë, megjithëqë bëhej mengadalë, e zgjoi Mitin nga gjumi i cili u ngrit gjer në brez nga rrrobat dhe na tha me zë të pakët:

— Pushoni tani, nesër, pasnesër... kini kur të flisni! Mbulojuni dhe flini!

Nuk folëm më, mbyllëm sytë dhe pas pakë na zuri përsëri gjumi.

XVI

MULLINJTE E-THIKESIT DHE XHA METJA

Mullinjtë e Thikësit janë në një gropë. Sefte mer një të përpjetë dhe, si kalon përmes fshatit, zbret pastaj në një të tatëpjetë. Më të mëngjér të dalin përpara syve disa kodra dhe tutje, shumë më tutje, zbardhojnë dhe kaltërojnë male, kurse më të djathtë bregu i udhës si ndonjë pirg i lartë nuk të lë të shohësh q'ka më tej. Përpara teje udha ulet poshtë e më poshtë dhe humbet fare në një hon, pastaj e shikon se ngjitet porsi ndonjë gjarpër nëpër një breg tjeter ose më mirë mbi një mal të vogël e të xhveshur. Aty këtu shquhen lisa të rrallë dhe shkëmbenj. Vetëm kur arrin përmbi mullinjtë vetë mund të zbulosh njërin prej tyre si ndonjë kërpudhë e madhe e kalbur prej myshkut që ka zënë përsipër, nën këmbët e tua dhe është aqë i ulët nga ana e sipërme, sa që mund të kalosh në çati ashtu si ecën udhës. Tjetri as që duket, me gjithëqë është fare afër. Duket vetëm jazi me ujët e shkumbëzuar që kalon i rrëmbyer përmes drurësh dhe drizash dhe përnjëheresh zhduket nga syri. Gropa bëhet më e thellë e më e thellë dhe më në fund dallohet përsëri rryma e lumit që shkon për poshtë, duke u rrahur e shkumbëzuar pas shkëmbënjeve. Shikimi sa vjen kufizohet, kufizohet dhe kur arrin përparë derës së mullirit. Nga tri anë të dalin pirgje të lartë malesh dhe nga perëndimi gryka e ngushtë e lumit. Kupa e qiellit vogëlsohet dhe një njeriu që ka jetuar në fushë e në qytet ajo i duket si ndonjë mangërrë e madhe që në çdo hop është gati të të bjerë mbi kokë.

Kështu arritëm bashkë me Mitin dhe me dorin e tij përpara të ngarkuar me dy thasë misër gjer te dera e mullirit, një derë e trashë lisi, si ndonjë kërcu. Përpara

mullirit qe një shesh i vogël ku dhe një gomar mezi mund të shkryhet. Dritare kishte vetëm një, prej së cilës hynte një dritë e zbetë, dhe ajo si një frëngji e vogël, e thellë në mur, ku dora me zor mund të të kalojë. Zhurma e madhe e pëndës dhe e mokrave të mullirit të shurdhojnë veshët. Fjalët duhet t'i thuash me zë të lartë që të kup-tohen. Të gjitha këto ma ndrydhën shpirtin dhe më vinte t'ua mbathja këmbëve e të kthehem andej nga kisha ardhur. Por qe e pamundur. M'u duk sikur kisha rënë në një kurth. Hekura ishin malet e lartë dhe çati qielli i vogël, por derë nuk kishte as nga një anë.

Kishim ardhur menatë dhe dera e mullirit ishte akoma e mbyllur. Miti zuri të trokasë e të thërresë:

— O Mete! O Mete!

U dëgjuan të lehurat e një qëni, pastaj një e kollitur dhe çape të rëndë. Me zhurmë të madhe u hoq një lloz dhe xha Metja u dha te dera si ndonjë ari.

Seftë më kaloi një e dredhur nëpër trup dhe sikur ngriva në vënd kur pashë atë fytyrë, si të skalitur prej guri të zi. Xha Metja ishte i parruar dhe mjekrën e tij të zezë e kish mbuluar një pah i brylltë. Kish dy sy, si dy thëngjij të përshkënditur me hi, po që herë pas here fapëtitnin; ballë të lartë, hundën pakë të krrusur, buzë të holla dhe me mustaqe të gjata. Por ajo që e bënte xha Meten më hijerëndë ishte trupi i tij i gjatë, pakë i krrusur nga vjetët dhe nga hallet, por i pamposhtur. Gjishtrinjtë e duarve i kishte me noçka të këcyera, si gdhënj pishe, me pëlliembë të ashpra dhe aty këtu të cara. Të çarat e gish-trinjve i kishte lidhur me spango të trashë, si unaza. Ishte veshur me rroba të shajakta të murrme, të fërkuara dhe një pah i lehtë i bardhë shquhej mbi to, si pluhur i hollë. Padurimi im pér të shikuar xha Meten sa më parë, m'u kthye në një shtypje të brëndëshme të pashpjeguarshme. Këtë e shtoi akoma më tepër mospërfillja që tregoi ay karshi meje. Ay s'më vuri re fare mua, por si e bëri toka me Mitin, i tha me zérin e tij të trashë:

— Paske mënuar sot o Miti!

— Eshtë dita e vogël tanë në dimër dhe ja, sa të hapësh sytë, sikur eshtë ngrysur, — ja ktheu Miti dhe shtoi:

— Po të sjell një mik të vogël, o Mete.

Ahere xha Metja hodhi shikimin e tij të përshkënditur mbi mua dhe më pyeti:

— I kujt je, mor djalë?

— Unë jam Mentor i Hysenit, — iu përgjigja unë.

— S'të prisja të vish kaqë shpejt, more djalë, — tha ay, — por tani shyqyr që na erdhe shëndoshë!

Më pushtoi me të dy duart dhe më puthi. Pastaj më zuri për dore dhe paforur më shpuri brënda.

— Rri këtu pranë zjarrit të ngrohesh, — më tha ay përsëri, — sa të shkarkojmë barrën, — dhe, duke u tundur me trupin e tij të gjatë e të krrusur, u kthyesh prapa.

Unë mbeta vetëm anës vatrés së mullirit që ndodhej kundrejt derës dhe që tani ishte e hapur. As që më vinte ndër mënd të ngrohem, por të ngrohtët më erdhi vetë nga një kërcu i madh që brumbulliste në vatër. Ca nga ca sytë m'u mësuan me errësirën dhe zura të dalloja gjërat që më rrëthonin. Afër meje, shtritur anës gllanikut, gérhiste një mace e murrme, me kokën mbështjellë nën vete dhe bishtin futur ndër shalë si ndonjë gjarpër. Në një kamare të madhe nga ana e djathtë e vatrés dukej një xhezve e bakërtë dhe një kuti e teneqenjtë me lule. Nga ana tjetër kishte një dyshek të mbuluar me një plaf dhe një jastëk të leshtë. Tre frona të vegjël me nga tri këmbë, të treshë, të punuar vetë dhe të pagdhëndur ishin vendosur një këtu, një atje rrëth vatrés. Më tutje, afër derës, nj'a katër a pesë thasë të mbushur dinga me miell. Ktheva kokën prapa nga vinte një zhurmë e madhe; ishin mokrat e mullirit, dy rrota të bardha njëra përbëti tjetrën, ku më mbetën sytë për një çast nga lëvizjet e shpejta të tyre. Trokashka që lëshonte misrin në sëndyq këndonte: trak, trak! trak, trak! Trak trak! dhe përposh dilte një miell i verdhë e i shkriftë, si bie ngandonjëherë dëbora flokë flokë, si zogj,

Nga jashtë mezi dëgjohej zëri i Mitit që i tregonte xha Metes se si më kishte takuar bashkë me Tasin dhe pastaj më kishte sjellë në mulli.

Merreni me mënd gjëndjen time... i rritur në fushë e në qytet! Çatia e ulët e mullirit me trarët e treshë e të zinj më dhanë akoma më tepër llahtarinenë. Prapa tyre sikur ishin fshehur djaj dhe nëpër vrimat, që dukeshin

aty këtu, sikur ata hapnin gojrat e tyre të më gllabëronin. Kisha dëgjuar përralla pér xhinde edhe pér hije nga hallë Fatimeja dhe përnjéherësh më shkoi ndërmënd që nëpër këto vënde të shkreta e nëpër këto shpella doemos duhej të kishte xhinde. Hyrja e qënët brënda më zgjoi nga këto mendime. Ay më pa me syt e tij të gjelbër e të njomë si me lot dhe tundi bishtin sikur donte të më thoshtë: «Ato që mendon ti s'janë të vërteta. Unë kam vjete që rroj këtu dhe asgjë s'kam parë!» Por a mund të ma largonte frikën një kone? Vetëm hyrja e xha Metes me çapin e tij të rëndë dhe më barën e misrit në krahë më dhanë zemër. Pas tij hyri dhe Miti me thesin tjetër. I zgjasën, pastaj Miti na la shëndet dhe iku. Ne mbetëm vetëm. Xha Metja mori një fron dhe ndënji pranë meje. Afër tij u shtrua edhe qëni, pa i hequr sytë nga xha Metja. Edhe macja, duke gjerrhitur, shikonte pér andej. Edhe unë gjithashtu po shikoja atë fytyrë me tipare të skalitura si me çekan.

Xha Metja më pyeti shkurt:

— Si e kalove udhën, Mentor?

— Po, mirë, — iu përgjigja unë.

Pastaj ay shtoi:

— Si është Aisheja me fëmijët? Si shkojnë?

— Shëndoshë e mirë, me fukarallëk. Teze Aisheja të dërgon shumë të fala!

— Po Hyseni ku është?

— Babai iku në Australi dhe ka qesa vjet që s'ka dërguar letër.

Xha Metja tundi kryet dhe më pyeti prapë:

— Sa fëmijë jini?

— Ishim katër, — iu përgjigja unë. — Shabani na vdiq nga tifoja, dy të tjerët, më të mëdhenjtë, Suloja dhe Sala ikën nga shtëpia, kanë dy vjet, pér të gjetur punë gjë-kundi dhe s'u bënë të gjallë. Dhe në K. mbeti vetëm teze Aisheja me të bijën, Merushen.

— Jetë jallane është kjo, — bëri ay dhe u ngrit duke thënë: — Sivjet do të kemi dimër të madh. Duhen bërë ca pyka pér të mbajtur koritën e jazit nga metalet. Ti ngrohu pas zjarrit, — shtoi xha Metja dhë mori një sqepar e zuri t'u bënte majë ca hunjve të gjetë prej lisi që i kish radhitur pas murit.

Sqepari i xha Metes kërciste përmbi hunjtë dhe cefla rrükulliseshin nëpër vatrën e mullirit. Unë u hutova përnjë hop pas punës së xha Metes, i cili i çkathët, si mbaronte njerin hu, rrëmbente tjetrin, por sytë m'u lodhën dhe ranë gjetkë dhe prapë gjetkë, po asgjékundi s'jenin prehje. Dhe përnjëheresh e ndjeva veten vetëm, fare vetëm.

Herë pas here xha Metja e linte të gdhëndurit dhe me trupin e tij të gjatë e të krrusur i afrohej sëndyqit, mirte pakë miell me të dy gishtrinjtë e dorës së djathtë dhe e fërkonte butë butë, pastaj e lëpinte me gjuhë i menduar. Si rrinte përsëri, më thoshte:

— Sivjet këtej bëri thatësirë dhe buka është shumë e ëmbël, por do të kemi dimër të madh.

Ishte një ditë dimri e murrme. Jashtë dukeshin drurët që tundeshin prej erës së fortë dhe një fiu fiu bashkohej me fraktakun e mullirit dhe koka m'u bë si daulle. Çdo e trokitur e trokashkës më binte në trutë si peronë. I mërzitur unë e pyeta xha Meten:

— Xha Mete, — i thashë unë duke ngritur zërin, — si të ka goditur që ke ardhur gjer këtu?

Xha Metja e la punën dhe i trondit dherë nga pyetja ime e papritur, ja bëri:

— Jeta, mor bir, i ka këto! Dhe ti do të mësohesh!

Dhe filloj përsëri të gdhëndëte duke i rënë sqeparit akoma më me forcë dhe ceflat dilnin më të mëdha dhe fluturonin si zogj më të mëngjér e më të djathtë. Tani më erdhën ndërmënd fjalët e Mitit, i cili më tha posa u njojtëm: «I ka fjalët të pakta Metja, por është burrë i mirë!» Këtë e pashë me sytë e mi dhe çuditesha me veten time se si do ta bënja xha Meten të flasë më tepër. Por si e qysh nuk mundja ta gjeja.

Drekën e hëngrem vonë, si mbaroi xha Metja së gdhënduri hunjtë. Pooi ca pastëрма mbi prushin e vatrës, pastaj shtroi një sofër të rrumbullaktë përpara. Thellë nga kamarja nxori një kulaçë të grynjë të ndorme, vuri dhe dy presh në sofër dhe më tha:

— Urdhëro të hamë tanë, Mentor!

Xha Metja filloj dhe hante me oreks të madh. Xhvastë më dhëmbë pastërmancë, pastaj kafshonte pre-

shin duke e ngyer me kripë. Herë pas here xha Metja i hidhte nga një copë bukë ose ndonjë kockë që rrinte sus mbi këmbët e prasme dhe priste me padurim pjesën e tij. Maces i hodhi në një kuti veçan. Qëni i vente nga donjëherë pranë, por ajo e krekosur i ngrinte këmbët e para dhe i ckermiste dhëmbët. Xha Metja u fliste me zërin e tij të trashë dhe ata menjëherë heshtnin. Qëni prapë i afrohej sofrës dhe priste duke tundur bishstin, dhe duke ndjekur me sy lëvizjet e dorës së xha Metes, që merte pastërmanë nga sofra dhe me shijë e kafshonte dhe e përtyppte nëpër gojë.

Si hëngrem drekë, xha Metja më tha:

— Këtë punë tani e tutje do ta bësh ti! — Dhe ngri-
ti sofrën. Pastaj vuri një kërcu tjetër në gllanik, vësh-
troi nga sëndyqi i miellit, që ishte mbushur plot, mori
një thes, i përveshi qafën dhe si ndënji në një fron
pranë tij, me një lopatë të vogël zuri ta mbushte.

Qëni dhe macja u shtruan anës vatrës dhe ranë në gjumë. Pas pak filluan të gjerrhasin dhe unë, duke i vëz-
guar të tërë me radhë: xha Meten, qënin, macen, e ndje-
va veten prapë të vetëm, të vetëm dhe një mall më zuri
për teze Aishenë. Sa e dashur më dukej ajo tani! Ajo
vetëm me fjalë mund të të ushqente! Dhe m'u dukën më
të embla fjalët e saj se sa pastërmaja e xha Metes. U
ngrita dhe mengadale si i trëmbur, iu afrova xha Me-
tes. Ay mbushte lopatën, e hidhte në thes dhe pastaj një
pah i hollë sillej poshtë e lartë. Trokashka vazhdonte
këngën e saj monotone — trak, trak! trak, trak! trak,
trak! Guri i mullirit të rrëmbente shikimin me vërtitjet
e shpejta dhe të shastiste. Të gjitha këto pér mua ishin
të huaja dhe të mërzitshme.

Si mbushi thesin, xha Metja u shkund nga pahu i
miellit, hodhi një thes tjetër mbi trokashkë dhe më tha:

— Unë do të dal të ngul hunjtë. Ti, Mentor, rri këtu
se përjashta eshtë ftohtë.

— Jo, jo, do të vij dhe unë, xha Mete, — ja ktheva
unë. As që më rrihej vetëm, dhe në këtë zhurmë!...

— Hajde, po mos ftohesh! Mer ahere ndonjë thes mbi kokë!

Rrëmbeva një thes, xha Metja i hodhi hunjtë mbi sup dhe duallëm.

Jashtë me të vërtet ishte ftohtë. Re të zeza e të trasha kishin mbuluar qielin dhe rëndë-rëndë si pata, mezi lëviznin. Një thëllim i ngrirë të priste si me brisk. Dëbora e shkriftë ngruhej përpjetë dhe si hi përplasej e ngjitej pas fytyrës.

Xha Metja ekte përpara, unë rendja pas tij, herëherë shkisja dhe bija, por shpejt-shpejt ngrimesha i trëmbur se mos e humbisja nga sytë.

Kur u kthyem ishte ngrysur. Të mardhur, ne ndënjam pranë zjarrit që brumbullinte dhe llamburiste gjithë vatrën e mullirit. Si e mori pakë veten, xha Metja u ngrit e më tha:

— Mentor, unë do derdhem t'i hedh një dorë kashtë gomarit, ne mulliri i poshtëm, se tërë ditën e ditës s'e kam parë ç'bën! — Dhe dolli. Qëni rendi pas tij. Macja ngriti kryet, pa një herë nga dera, pastaj më shikoi dhe mua dhe ra prapë në gjumë duke gjerrhitur. Bëra dhe unë të ngrihem e ta ndjek xha Meten, por këmbët e ftohura koçan nuk më lanë. Mbeta vetëm. Për një hop u shastisa pas shkëndijave të zjarrit. Mëndja më fluturoi në K., te teze Aisheja, te Merushja, Sotiri, edhe trokashka, si për inat, pushoi: mielli ishte mbaruar. Ktheva kokën prapa, por çdo gjë kishte rënë në errësirë; padashur hodha sytë për nga trarët dhe i llahtarisor pashë hije të venë e të vinë, pastaj një prej tyre sikur u nda dhe bëri për nga mua duke u ckërmitur. Unë u ngrita nga vëndi i lebetitur dhe renda jashtë duke thirrur:

— Xha Mete! Xha Mete! Xha Mete! — Zëri im humbi gjékundi dhe s'u kthyë më prapa. Nata ishte e ngrirë dhe e errët. U pengova e rashë mbi dëborën e hupët. Atje ku rashë dhe atje mbeta, më kish rënë zali.

XVII

SI U NDRYSHUA XHA METJA

Kur hapa sytë, u gjenda prapë brënda në mulli, pranë zjarrit, përmbi plafin e dhirtë. Xha Metja kish ndënjur pranë meje, më kishte yenë dorën mbi ballë dhe dukej shumë i merakosur.

— Mentor; Mentor! — më thirri ay, por unë nuk kisha fuqi t'i përgjigjesha dhe rashë përsëri në gjumë. Digjesha si zjarr. Vetëm pér një hop përfytyrova teze Aishenë, e cila me netë e me ditë të tëra na rrinte pranë shtratit kur sëmureshim dhe na jepete zemër me fjalë të ëmbla.

Kur erdha pas pakë në vete e pashë fare shkoqur xha Meten nga drita e pishtarit ku digjeshin një tufë pishë, me një copë leckë në dörë, që e injomte në një sahan me ujë dhe ma vinte pastaj me kujdes mbi ballë.

— Xha Mete! — ja bëra unë duke qarë.

— Mos u trëmb, mos u trëmb! Dhe mos qaj! — më tha ay me një zë të butë e të trondititur.

Xha Metja m'u duk tjetër, sikur s'ishte më ay burri i ashpër që kisha parë pak çaste më parë. Sytë i kishte të mbushur dhe fjalët nuk i dilnin të ashpra, por ndryshe, fare ndryshe dhe ne të vërtetë fillova sikur të mos kisha frikë, megjithëqë kur i hidhja sytë pér nga trarët e mullirit, prapë shikoja hije të ndryshme që më trëmbnin. Por ndodhja e xha Metes pranë meje më jep-te guxim. Dhe qëni rrinte zgjuar, kurse macja gërrhiste futur gjékundi nën plaf.

— Pi një çikë ujë, — më tha xha Metja dhe më vuri lyfttin e shtëmbës në buzë.

Piva nja dy gllënjqka dhe sikur më freskuan pakë.

Tërë natën xha Metja nuk mbylli sy. Më jepte garjet me fjalë, më vinte leckën e njomur me uthull në ballë, që të më binte të nxehjtët, më fërkonte me dorën e ashpër faqet dhe më shikonte butë butë dhe si me faj për të gjitha ç'kishin ngjarë.

Të nxehjtët si për inat nuk donte të më binte, por aty nga mëngjezi sikur më zuri ca gjumi, një gjumë i lehtë, si me sy të hapur, kur hem fle hëm i dëgjon të gjitha. Xha Metja herë pas here shkoqte kërcurin dhe hidhte nga ndonjë copë pishë në pishtar. Trokashka prapë e kish filluar këngën e saj monotone dhe unë me gjithëqë mundohesha t'i mbyllja sytë e t'i harroja të téra, nuk mundnja. Mëndja më hidhej në K. dhe më dilnin përpara Merushja, Suloja, Sala dhe më në fund babai, në atë ditën e fundit kur e nisëm për në kurbet. Shikoja shtëpinë tonë përdhese dhe teze Aishenë, por të gjitha këto për një hop, pse përnjëheresh kërceja përpjjetë i trëmbur, sikur më shponte njeri me fëndyell. Ahere xha Metja më thoshte:

— Mos u trëmb, bir, mos u trëmb! — dhe më vinte leckën mbi ballë.

Të nesërmen u bëra më mirë. Të nxehjtët më ra, por nuk kisha fuqi të ngrihem. Xha Metja nuk më ndahej nga shtrati. Edhe ahore kur vinte të shikonte sëndyqin e miellit, sytë i kishte nga unë dhe më fliste me zë të lartë herë pas here që të mos trëmbem dhe ta di se nuk jam vetëm. Gomarin atë ditë nuk e pa pse nuk donte të më linte vetëm. Vajti i hodhi të nesërmen kur erdhi Miti të marrë miellin.

Si çkëmbyen dy tri fjalë me Mitin për shëndetin dhe për miellin, xha Metja i tha:

— Miti, rri këtu pakë me këtë nipçen, se nuk është mirë, sa të vete t'i hedh ca kashtë gomarit!

Miti u afrua pranë meje si i njohur i vjetër. Më dha dorën dhe më përshëndeti nga ana e Limbisë dhe e Mandit. Ajo më kish dërguar peshqesh dhe një kulaçë. Mandi i kish thënë se donte të më shikonte. Këto fjalë sikur më dhanë zemër, se ishin nga miqt e parë që kisha zënë nga këto anë. Pastaj Miti filloi të më fliste për hallet e tia. Kur u kthyë xha Metja na gjeti në muhabet e sipër. Atij i erdhi mirë pse qeshi dhe tha:

— E kam nipçen si burrë, citë mënd!

Miti iu përgjigj:

— Tani djemuria dinë më shumë se ne! Ja, kam Mandin unë, dymbëdhjetë vjeç është, por dhe priftit ja shkon si nga shkrimi, ashtu dhe nga këndimi!

— Ne ja thoshim dyfegut, — ja ktheu xha Metja si i dogëndisur.

— Ndryshe ishte puna e dyfegut, — ja bëri Miti.

Xha Metja këtë radhë i tha Mitit si me inat:

— Po mos ja kishim thënë në dyfegut, edhe këta do të ishin si ne të dyfegut! Tani le të jenë të gramëve. Të hapin sytë.

— Mor, të zgjuar i kemi fëmijën, por ja, s'kemi shkollë! — ja bëri Miti duke tundur kokën. — Ja u mbush moti që kur na e mbyllën këtu në fshat dhe tani djemuria s'dinë ç'të bëjnë! Ca u bënë çobenj, ca duallën me baballarët mjeshtër, të tjerët muarrën parmëndën. Por një s'dolli mor të shkretën nga fshati pa në djall të vejë! Të gjitha punjt e mira i marrin ata birçet, fshatarë po fshatar, kokëtrashë! — dhe shtoi prapë vetë duke tundur kokën: — Mor jepi shkollë ti fshatarit, pa ta shluikosh ti po s'dolli më i zoti! Úa kanë për të ngrënë kokën atyre të mamave, por ç'të bëjnë! — dhe kërciti dhëmbët i zemëruar, dhe prapë shtoi, tani, si me të qeshur: — bukë s'kemi të hamë, po qibrat i kemi të mëdha. Hajde të zgjasim miellin, o Mete, se erdhi dreka!

Si iku Miti, xha Metja ndënji prapë anës gjllanikut dhe zuri të më thoshte:

— Burrë i mirë është ky Miti, por s'ka i gjori. Edhe djalin e ka të zgjuar. I pari ishte në shkollë, vetë dhas-kali ma tha njëviti. I kishte nxjerrë fëmijët shëtitje këtej nga mulliri. Erdhën pastaj të më shikojnë dhe mua. Një burrë i shkurtër, i shkurtër, sa ajo mostro ngarka që shikon prapa dërés ishte ay dhaskali, por kish te një fjalë të ëmbël mjaltë. E pyeta unë si venë djemtë «Mirë» më tha ay, «të gjithë venë mirë, por Mandi i Mitit është i pari dhe gjynah që do të mbetet me kaqë; ky djale, do të shkonte shumë përpara. Gjynah, gjynah» përsëriti ay duke tundur kokën.» Që të ta thotë dhaskali këtë, ore djale, diç ka kuptuar... Mua më kish qëlluar gjumi. Ndjeva vetëm dorën e xha Metes që po më hidh-te plafin duke më thënë:

— Fli, fli, bir, se sëmundja me gjumë hiqet!

Si u ndryshua xha Metja dhe pse, as unë nuk e di, por dita me ditë bëhej më i butë e më i sjellshëm, më i dashur. Zuri të më vinte pas volles, të më pyeste se ç'më hahej. Një ditë, si grua, hyri në magje dhe bëri lakruar me presh e me gjizë. Ta shikoje xha Meten më llërët e përveshura dhe plot qime, me magjen përpara dhe me ibrikun me ujë në dorë, të dukej sikur qesëndiste me punën dhe të merrte të qeshurit, por ay e shtypte brumët me aq mjeshtëri dhe kujdes që të bënte nga ana tjetër ta shikoje me gojë hapur. Pastaj qëroi preshët, të holla fije-fije e i përzjeu me gjizën në tigan, hodhi dhe dy vezë brënda dhe i vuri të ziejnë në zjarr mbi një perusti. Brumët e mbuloi në magjet me një mësallë dhe e afroi pranë gllanikut që të vinte. Herë pas here më thoshte mua duke qeshur:

— Lakruar të tillë edhe teze Aisheja s'besoj të të ketë bërë! Gishtrinjtë do të lëpish!

— Pastaj zuri të tëhollte petët. «O zot, thosha unë me vete time», ky xha Metja paska duar të arta. Dhe bukë dinë të bëjnë, dhe lakruar dinë të tëhollin, apo s'e bëjnë miellin të butë, të butë si pambuk!»

Atë ditë, pas sëmundjes, për herë të parë hëngra me shijë, një ngastër të tërë. Kurse xha Metja hëngri të tri copët e tjera. Hëngri vënçe, ashtu siç kishte punuar. Si mbaroi së ngrëni, fshiu mustaqet mirë mirë dhe më tha:

— A u kënaqe, mor bir? Se unë të të them të drejtë, u kënaqa! — Dhe papritur përgjigje ngriti lagjinin me ujë dhe e zbrazi të tërë. — Ujë mundobare na ka dhënë zoti sa të duash. Pi dhe mos ki qeder se do të mbarohet; hë, sikur të ish mielli kështu, nuk do të kishte fukarallék në botë; — dhe prapë më pyeti mua:

— Thuaj, Mentor, të pëlqeu, apo jo?

— Kush e di që kur s'kam ngrënë lakruar, — iu përgjigja unë; — dhe më pëlqeu shumë! Pastaj edhe teze Aisheja rrallë na bënte lâkrorë; s'kishim as miell, as gjalpjë; dhe shumë veta ishin; kush të hante më parë!

Xha Metja u menđua pakë dhe pastaj m'u përgjigj:

— Javën që vjen do të nxjerim në pazar ca grurë nga të hakës sime, dhe paratë do t'ja dërgojmë Aishesë. Të gëzohet dhe ajo fukaraja një cikë!

— Sa mirë që do të bësh, o xha Mete! — ja bëra unë i gëzuar.

Xha Metja më përkëdheli dhe më puthi këtë radhë duke më thënë:

— Ti i ke ngjarë Hysenit. Edhe yt atë, ja, kështu ishte, i dashur, zemërmirë, por s'pati kësмет!

XVIII

JETA NË MULLI

Si e mora veten, zura te dilja dhe perjashta. Koha ishte ndrequr dhe debora, si per cuudi, ishte zhdukur. Murxhoja nuk me ndahej; kudo qe veja, atet e kisha prapa si manar. S'lashje vend pa vajtur rreth e rrotull mullirit. Dolla Jart nga jazi, ku fshatarret kishin berie cfratin, hipa ne ca shkembjen te medhenj aty pranë dhe hcdha një sy drejt lumi, qe shkiste i rrëmbyer si ergjend e i shkumbezuar, perpiqej nepër gurët, anës shkembjenje, pastaj futej permes grykes karshi meje e zhdukej si ndonje gjarpër pa kokë e pa bisht. Mëllentat fluturonin permbi uje. Ndonjera qëndronte gjekundi duke tundur bishtin. Murxhoja i turrej qe tutje e i lehte dy tri herë. Zogu fluturonte duke ndjekur rrymen e lumi dhe futej ne ndonje drizë. Qeni, si i kenaqur, shtrihej perseri nen kembet e mia dhe tundte bishtin. Larg, andej nga korija pertej, ndihej sepata e ndonje druvari, kurse me poshtë mulliri i xha Metes, zhurmëmadh, vazhdonte te bluante misrin e fshatareve te vonuar.

— Këto ditë te mira janë te fundit, Mentor. Ky eshtë behar i evgjiteve, dhe sa pa na zënë dimri, duhet te nxitojmë, se debora e dyte nuk ka per te ikur shpejt, — ja bente xha Metja, kur ngriheshim ne mengjez. — Sot do te ndreqim kopshtin!

Në kopsht kishin mbetur vetom kercyejtë e domateve, te piperkave dhe hunjtë e fasuleve. Nepër gardhet kishte akoma ndonje zorrë kungulli. Xha Metja i qeroi te gjitha. Kercyejtë e domateve e te piperkave i nxuarrem nga dheu me gjithë rrënje. Xha Metja i la ato te

thahen përsipër për plehë; hunjtë i shpumë që të dy në mulli dhe i lamë t'i kemi gati për vitin e ardhshëm.

Xha Metja tani më linte dhe vetëm në mulli, kur dilte për shkarpa gjékundi afër mullirit. Po unë s'kisha më frikë, pastaj dhe Murxhon e kisha pranë e sikur më jepte zemër. Po dhe sikur u mësova. Veja afër sëndyqit, merja miellin në dorë, e shikoja a ishte bluar mirë, apo ishte i ashpër, ashtu si bënte dhe xha Metja dhe rregulloja trokashkën. Pastaj dilja te porta dhe rrija te sofati që kish bërë xha Metja për fshatarët — dy kërcunj të mëdhenj prëj lisi që as pesë vjetë nuk mund t'i lozin dot nga vëndi dhe shpesh vrisja mëndjen se si i kishin sjellë që nga mali e gjer aty! Dhe një ditë pyeta xha Meten.

— Xha Mete, — i thashë unë si i çuditur, — si i kini sjellë gjer këtu këta kërcunj të mëdhenj?

Xha Metja qeshi dhe m'u përgjigj:

— Duke i rrukullisur, mor bir. Ndryshe ata as që lozin nga vëndi!

Kur vinin fshatarët, xha Metja u thoshte:

— Tani mos kini qeder, s'jam vetëm, kam dhe nipçen këtu!

— Të të rrojë! Të të rrojë! — ja bënin fshatarët.

Skuqesha në fytyrë, kur i shikoja gjithë ata sy të ktheheshin nga unë, pa ditur ç't'u them.

Bashkë me xha Meten vamë një ditë dhe te mulliri i poshtëm. Gomari na ndjeu akoma pa hapur derën mirë dhe zuri të pëlliste. Xha Metja i thoshte:

— Prit, xhan, prit! — dhe kur e pa që ay s'pushonte, i foli: — Prit, de!

Gomari i xha Metes ishte një gomar i zi e i bëshëm. Në mulli ay s'kishte shumë punë. Xha Metja e përdorte më tepër për të hipur, për dru dhe ngandonjëherë shpinte dhe hakën në pazar për ta shitur. Me të na parë, zuri të vërtitej duke ngritur kokën.

Mulliri i poshtëm s'kishte asnjë ndryshim nga ay i sipërm. Vetëm se këtu tani nuk kish rregull. Xha Metja bluante vetëm vjeshtave, kur fshatarët i sillnin shumë

drithë dhe nuk ja delte dot vetëm me mullirin e sipërm. Tani që fshatarët e kishin vënë zahirenë e dimrit, aty ay mbante gomarin. I kishte bërë një si shtrat shtruar me dhoga dhe përsipër kishte hedhur kashtë. Nga ana tjetër e vatrës dergej një gur mulliri i prishur, disa rrathë, drurë, hunj të shpërndarë aty këtu edhe pyka.

Xha Metja e zgjidhi gomarin, i hodhi samarin në kurri dhe i lidhi qenglën. Pastaj më ngriti mua dhe më hipi duke më thënë:

— Mbaju mirë, Mentor, se ky qerata hedh vingla!
— Kurse gomarit i thoshte: — Hajde, bir, tani do të vemi për ujë! — Dhe e fërkonte.

Xha Metja nuk i jepte ujë gomarit në lumë, se ujët e lumi ishte të ftohtë tani në dimër, po e shpinte te burimi që ndodhej më të djathëtë të mullirit të poshtëm, ku mbushnim edhe ujë për të pirë. Si piu ujë, gomari u bë tërë qef, zuri të tendosej e të krekozej dhe herë pas here tundte kokën. Atë ditë dielli ishte i nxehëtë dhe kur u afroam te sheshi përpëra kopshtit, xha Metja më zbriti nga gomari, i hoqi samarë dhe e la të lirë.

— Le të mrijë një çikë në diell, të shgryhet dy tri herë sa të përzérë pleshtat, — tha xha Metja, dhe ndënjëm në ca gurë aty pranë.

Gomari sikur e kuptoi përsë e kishim lëshuar, vajti gjer në mes të kopshtit, e pa me sy vëndin përpëra, i shkoi një herë buzët përsipër, pastaj u ul me kujdes dhe zuri të shgryhej. U kthye më të djathëtë, u kthye më të mëngjërt dhe u shkaravit në një të tatëpjetë ku bëri të kthehej dhe një herë, por nuk mundi. Ahere u ngrit më këmbë dhe u shkund dy tri herë duke tundur kokën e duke vërtitür bishtin. Pastaj zuri të bredhë. Unë e shikoja i habitur. Xha Metja më thoshte:

— Shiko, bir, sa e shtrënjtë që është liria! Brënda gomari rri si i hutuar, bile as nuk i hahet, jashtë është si i dehur nga gaz! —

Pastaj xha Metja më merte më pranë dhe fillonte të më tregonte:

— I shikon ato majat e larta, andej, éshtë Furka, mal' i veshur me ah dhe boriga. Kurse ata shkëmbënjtë, nga ana tjetër, janë Shkëmbi i Bletës. Atje, një mot, Tahiri, një fshatar nga Thikësi, nxori aqë mjaltë sa s'kishte ku ta vinte. Atë mot ay bëri shtëpinë; ca nga arat, ca nga mjaltët dhe ja hodhi çatinë. Vitin e dytë Tahiri vajti prapë pér mjaltë, po bletët duallën më të mëngura, e vluan mjaltët në shkëmbënj akoma më të lartë, në pиргje ku s'ka shkelur këmba e njeriut. E ç'nuk bëri Tahiri? Se mjaltët éshtë të ëmbël, mor bir. U lë-shua dhe me litar, por nuk i gjeti dot vrimat. Fshatarët thonë se aqë mjaltë ka Shkëmbi i Bletës sa që tërë qypat e fshatit mund të mbushen, hallbu që nuk e arrijnë dot! Por mjaltët që e kërkojnë nëpér shkëmbënjtë e kanë sheshit, mor bir, se nën shkëmbënjtë janë ca sheshe, — vazhdoi ay, — ku bëhet një tërfil, një bar i ëmbël, që bagëtia s'ngopen sëngrëni. Qumështi i dhënve zë një gisht ajkë, kurse kosi bëhet pér të rrükullisur. Djathët të ëmbël, të ëmbël, të hash e mos fryhesh sëngrëni. Dhe mishtë éshtë të shijshëm, po ç'e do se i kanë të tjerët. Ua kanë rrëmbyer bejlerët e Khufkës dhe ua shesin vllehäve. Marin dyqind, treqind napolona në mot dhe rrojnë si pashallarë, kurse fshatarët e Thikësit s'kanë bukë të hanë. Venë e vinë nëpér kurbete, se vëndi nuk i mban dot. Kur kthehen, vinë të veshur e të mbathur, të mbeten sytë. Rrinë këtu të shumën një mot dhe bëhen si cironj të thatë, mbeten pa një kacidhe dhe nisen prapë andej nga kanë ardhur. Ata që janë në fshat mezi e nxjerrin bukën; as bujqër, bujqër, as mjeshtër, mjeshtër. Dimrit dalin andej nga Delvina, beharit mbledhin bereqetin. Gratë punojnë më shumë se burrat, tarkuzën nuk e heqin nga brezi, ngado që venë nuk kthehen bosh, do të ngarkohen me dru ose me shkarpa. Po ç'të bësh, kështu éshtë kurdisur kjo botë. Ca hanë e rrinë, ca punojnë e s'kanë ç'të hanë! Po hajde, Mentor, të ngrihem, se njeriu s'ngopet me fjalë. — Dhe hidhej xha Metja përpjetë si ndonjë djalë i ri.

Dita me ditë zura ta zëvëndësoja xha Meten në ndonjë punë. Pér ujë tanë veja unë. Rrëmbeja lagjinin dhe

rendja te burimi. Udhës do tē qëndroja vetëm kur kaloja anës lumi dhe shikoja peshqit tē lëvrijnë. Kish-të tē murrmë, pika-pika. Këta qëndronin në fund tē ujit dhe fshiheshin menjëherë nëpër gurët. Ca tē vegjël fare shkonin me mijra, si kope, herë poshtë, herë lart. Ujet e lumi ishte në këto ditë tē kulluar si ergjënd, dhe një para tē hidhje brënda, do ta shije. Po fët kujtohesha dhe rendja për ku isha nisur.

Xha Metja i kish bërë një çurkë burimit sa për lagjinin dhe gjer sa-mbushej ay, unë vështroja rrëth e rrotull. Jo nga frika po si për tē kujtuar ato që më kish thënë xha Metja. Hidhja sytë nga Furka, nga Shkëmbi i Bletës dhe thosha me vete: «Kur tē rritem, po s'vajta t'u mar mjaltët bletëve nga ata pirgjet e lartë!» Pastaj mëndja më vinte te xhufkallitë dhe menjëherë më kujtohej Nurçe beu që ua kish rrëmbyer malin fshatarëve të Thikësit dhe shtoja: «— Po pse s'venë t'u marrin me par-hir, more!»

Nga këto mëndime më zgjonte ndonjë laraskë që fluturonit aqë ulët sa mënt çikej me mua dhe unë kujtohesha për lagjinin. Kur hidhja sytë nga çurka, shtëmba ishte mbushur dhe derdhej jo vetëm nga lyfti por dhe nga gryka. E rrëmbeja dhe rendja. Xha Metja më priste me padurim tē pinte ujë tē ftohtë. Kur më shikonte te dera ja bënte:

— Të lumi tē, Mentor, më jep tē pi një ujë tan!

Dhe e merte lagjinin e kthente dhe gjerr, gjerr, gjerr e gjysmonte menjëherë. Vetëm kur hante lakruar mund tē pinte një lagjin tē tërë. Pastaj xha Metja më thoshte:

— Hajde, shko i jep ujë gomarit tan!

Dhe unë këtë sikur prisja, rendja te mulliri i poshtëm.

Dhe këto vënde tē shkreta, ku rrënim vetëm ne tē dy, unë dhe xha Metja dhe ndonjë shpesë e harrakatur, m'u bënë aq tē shtrënja dhe aq tē dashura, sikur kisha jetuar me vjete.

Gomari zuri tē më ndjejë dhe mua që nga larg dhe ja nistë tē pallurit. Unë i thosha si i madh, si xha Metja:

— Prit, xhan, prit!

Dhe me tē vërtetë gomari më priste me pàdurim dhe si i mallëngjyer ja bënte: hëhë, hëhë, hëhë. Kastile e shikoja në sy, ku i dukeshin lotët, si pika vese. Atëhere unë e pushtoja për qafe dhe e fërkoja me dorë në kurriz duke i thënë:

— Mos qaj, tani do tē tē nxjer jashtë!

E sillja afër mokrës së prishur dhe ja hipja, pa samar. Tani gomari nuk hidhte vingla, po nisej vetë për nga burimi, me ngadalë, kurse mua më dukej sikur fluturonte. Herë pas here i shtrëngaja kapistallin se kafshonte ndonjë degë shelgu a vidhi anës lumi. Murxhoja na ndiqte prapa dhe kur shikonte ndonjë zog, hidhej përpara duke lehur dhe nuhaste drizë më drizë. Një herë i ra pas një lepuri tē madh sa një qëngj. Në fillim Murxhoja e ndiqte prapa këmba këmbës dhe desh e zuri. Unë e nxisja me sa zë që kisha:

— Kape, Murxho, kape!

Po lepuri mori tē përpjetën dhe u zhduk nëpër drizat e pllajës. U kthyen Murxhoja pastaj me gjuhën një pashë dhe duke rënkuar.

Mbrëmave rrnim pranë kllanikut. Zjarri brumbullinte, macja gjërhinte gjëkundi dhe ne zinim muhabet me xha Meten. Binte fjala për luftrat, pse gjuha atje ku dhëmb dhëmballa vete, dhe i thosha unë:

— Me kë ke luftuar, xha Mete?

— E me kë s'kam luftuar, mor bir? Po lufta që bëmë ne ashtu vajti, për dhjamë qëni! — shtonte ay duke tundur kokën. — Po hallbu që qemë tē ndezur e s'duronim!

— Pse, — ja ktheja unë, — ja, Shqipëria u çirua, xha Mete!

— Kush e çlroi, kush e trashëgoi, i thonë kësaj, mor bir! Hë, s'janë tē gjallë Çeçua me Mihalin, pa do ta shikonin këta... po janë në varr e s'ngrihen dot!

— Edhe me Çerçizin ke qënë, xha Mete! Edhe me Mihalin bashkë ke luftuar?! Aman, më qafsh, me kë keni luftuar?

— Edhe kundër bashibozukëve turq kemi luftuar, mor bir, dhe në Gramoz kundër Junanit, dhe me sërbët... — dhe shtonte: — Të gjithë kamë dashur të na gllabërojnë, — dhe xha Metja nxirte një rënkim të thellë.

Drita e pishtarit e ndriçonte këtë fytyrë të skalitur e të fortë dhe sytë e tij të përshkënditur sikur lëshonin shkëndija. Prapa dallohej hija e tij e madhe si e ndonjë gjigandi dhe unë e merja me mënd se ç'tmer u kish futur armiqve ky burrë me trup ariu.

— Aman, xha Mete, — ja bëja prapë unë, — tregomë gjësendi për Çerçizin.

Dhe xha Metja, si i përmallur, fillonte:

— Çerçizi, mör bir, ishte burrë që nuk i gjendet shoku. për armiqtë — tmer, për miqtë — qëngj i butë. Ishte i madh e i bukur, me trup asllani, levend! Shumë ngjisnin me të vëllanë, me Bajo Topullin, po ky ishte më i rrëmbyer. Çerçizi ishte hem trim, hem burrë i matur; kurrë nuk e humbte zemrën edhe në rezikun më të madh. Një ditë ramë në dyfek me grekërit në Çardhakun e Korçës. Ata ishin nj'a dy qind a tre qind dhe të gjithë korofillakë. Ne pesëmbëdhjetë. Dymbëdhjetë nga ne kishin pushkë, të tjerët vetëm nga një kobure dhe nga një kamë në brez. Ndajnatëherë lufta u ndez mirë. Çerçizi na dha urdhër: «Zini vënd dhe shtini pa lëvizur!» Vërtet kishim zënë një pllajë dhe armikun mund ta shikonim nga të katër anët dhe megjithëqë ishin shumë, nuk mund të lëviznin dot pa rënë në errësira. Hallbu që edhe ne nuk kishim si të dilnim. «Shtini», ja bënte Çeçua, «të mos e lemë armikun të na afrohet! Shtini, po dhe plumbat i kursemi, të mos ju vënë kot!» Apo s'qëllonte ai, plumb nuk i vinte bosh.

Na u ndez gjaku, Sabriu, një komit që luftonte në krahun tim, u ngrit më këmbë! S'i durohej! Po kujt i durohej! Po lufta e ka me të duruar. Ahere Çerçizi iu afrua pranë, e zuri nga prapa dhe e shtiu poshtë duke i thërritur:

— Ore Sabri, ore vëlla, trimëri do të shesësh ti, hë! Ja, lëfto si të gjithë shokët!

Sabriu as që e hapi gojën. Pse kapedan Çeçua e kish-te me të drejtë, e kuptoi gabimin dhe heshti!

Korofillakët, si e panë që ballë për ballë nuk na e dilnin dot, ndrruan luftë. Po përpinqeshin të na rrrethojnë që nga larg. Çerçizi e kuptoi dhe na dha urdhër të têrhi-qemi. Po si ama? Ja këshту:

Sefte i tha Bajos, të vëllait: «Shko ti i pari!» Dhe me të vërtetë, me këmbë e me duar Bajua u fut në pyllin që kishim prapa krahëve. Pastaj me radhë. Çerçizi ja bënte: «Ngreu tū, Sabri! Hajde ti, Mete! Shko dhe ti Mihal!...» Ay mbeti i fundit. Ne të gjithë shtnim që nga pylli dhe vetëm me gjakftohtësinë e Çerçizit mundëm të shpëtojmë pa na rrrethuar, pse kishte filluar dhe të ngrysej. Nga ne asnëjë nuk u vra, as nuk u plagos. Dhjetë korofillakë e muarr kokën nën vete...

Unë e dëgjoja xha Meten me gojë hapur dhe tanë më bëhej akoma më i dashur, po gjumi m'i rëndonte sytë dhe megjithqë kisha dëshirë ta dëgjoj têrë natën, qepallat më mbylleshin dhe bija mbi plafin e dhirtë duke êndërruar trimëritë e Çerçizit me shokë.

Atë vit, dy javët e para të shënëndreut bënë si behar. Dielli dilte që në mëngjez dhe nuk zhdukej gjer në mbrëmje. Asnjë re në quell, asnjë erë në tokë. Dhe megjithëqë ishte dimër, dheu avullonte si në ditët e para të pranverës. Fshatarët vazhdonin të venë e të vinë në nulli. I shkarkonin hajvanët përpara derës, peshonin miellin, shkëmbenin dy tri fjalë me xha Meten dhe bënин përsëri për në fshat. Në këto ditë njoha dhe Kostë Përtejn, dhe Nastën e Mihalit, dhe Vason. Savën, e kë jo? Disa e sillnin drithët në krahë se s'kishin hajvanë. Kur arrinin në nulli, fytyrën e kishin si lulkuqe e të dërsitur. Sa afro-heshin te dera e mullirit e lëshonin barrën përmbi kërcunjtë e sofatit dhe rrinin ashtu një copë herë sa të mer-nin veten, se s'kishin fuqi të zgjidhnin as têrkuzën. Rendnim ne me xha Meten dhe u ndihmonim. Ata mezi mer-nin frymë, po gjene mallkonin dhe fatin e tyre, perëndinë... dhe kërkonin një pikë ujë sa për të lagur gurmazin! Xha Metja nuk u jepte menjëherë, po më thoshte mua:

— Mentor, shko të mbushësh ca ujë të ftohtë!

Merja, lagjinin dhe rendja sa më hanin këmbët. S'qëndroja tanë as nga lumi, as për zogjtë, as peshqit nuk i shikoja, por drejt e te burimi. Dhe me një frymë venja gjer atje dhe kthehesha. E merte xha Metja lagjinin dhe ja jepte fshatarit duke i thënë:

Hajde, tanë që u ftohe, pi një ujë mülliri!

Po ay as që e zinte me dorë, vetëm i thoshte si me lutje:

— Në kë perëndi, o Mete të ma bluash miellin cazë shpejt, se dhe mëngjiez nuk kemi ngrënë, ore, me vetë e me fémijë!

Dhe xha Metja e ndrronte radhën, zinte e u bluante atyre që nuk kishin fare ç'të hanin, se u njihte ay fshatarëve dhëmbë e dhëmballë.

Fshatari priste duke u ngrohur jashtë në diell, pastaj merte barrën prapë në kurriz dhe nisej për në fshat. Të gjorit, këmbët i epeshin nga barra e rëndë dhe po ta shikoje nga prapa nuk inund ta dalloje kafshë ishte apo njeri, se ecte i krrusur dhe i epur si ndonjë hajvan i çaplycr.

Në këto ditë me diell vamë dhe gjer Ersekë. Nxuarëm një killë grurë nga të hakës së xha Metes. Gjysmat e parave ja dërguam teze Aishes, me të tjerat blemë zahire për dimër — kripë, piper, ca kafe, ca sheqer, pastërmë e bakalaro, ullinj...

— Dëbora e dytë, — ja bënte xha Metja, — do të na mbylljë si në kuvli dhe kush e di kur do të shkojë!

XIX

DIMËR

Nuk kish shkuar mirë akoma një ditë dhe koha u prish. Nga Furka dhe nëpër pirgjet e Shkëmbit të Bletës duallén re të murme që nxitonin ca poshtë e ca lart, si dhën të trëmbura kur hyn ujku në kope, dhe gjer nga drekëhera e mbuluan tërë qiellin. Murxhoja rrinte sus përpara portës së mullirit me bishtin ndër shalë dhe duke u dredhur. Zogjtë vërtiteshin rreth e rotull mullirit tu-fa-tufa, qëndronin mbi çati, pastaj lëshoheshin për nga kërcunjtë e sofatit, rrëmbezin ndonjë kokër dhe prapë fluturonin nëpër degët e drurëve të xhveshur, por nuk largoheshin, rrinin nëpër to me kókën e tulitur nën krahn e të shpupurisur. Sefte zuri një llohë, as shi, as dëborë. Flokët ishin të lagur e të mëdhenj dhe e njomën vëndin menjëherë. Xha Metja, që rendi t'i hedhë gomarit gjë-kafshë për të ngrënë te mulliri i poshtëm, u Rthye qull. Kur hyri brënda në mulli, u shkund mirë, mirë dhe si të kujohej për ndonjë gjë që kish harruar jashëtë, ja bëri:

— Do kthyer dhe vija, Mentor, se tani s'do kemi më për të bluar! — dhe rrëmbeu një kazmë, hodhi një thes në kokë e dolli përsëri.

Dëbora tani ja kish marrë shtruar. Ca flokë të mëdhenj si lecka të bardha silleshin nëpër erë, sikur kërcenin valle, pastaj binin gjékundi dhe shkrinin mbi tokën e lagur. Zogjtë cicëronin nëpër degët e shelgjeve, pastaj binin si kokra grurë përmbi çati, futeshin në ndonjë vrimë dhe heshtnin: Vetëm macja vazhdonte të gjerrhiste pranë kllanikut.

Atë ditë nuk erdhi njeri në mulli. Dëbora ra shtruar gjer në mbrëmje. Unë dilja herë pas here gjer te dera e

mullirit, por toka ishte mbuluar tani me një pëllëmbë dëborë, që të vriste sytë nga bardhësia.

— Ja ka marrë shtruar, o Mentor, dy metro do të hedhë, kjo e flamosur! — ja bëri xha Metja kur u kthyë i merakosur.

Të nesërmen kishte rënë aqë shumë dëborë sa mezi e hapëm derën e mullirit.

Si duallëm përjashta, xha Metja tha:

— Po tani si do t'ja bëjmë gomarit; — dhe kroi zverkun.

Dëbora kishte pushuar. Vëndi zbardhë si vezë, që nga Furka e gjer në malet e zes të Qafëzezit. Degët e pemëve ishin të ngarkuara e të zbulkuara si nga një dorë magjike dhe herë pas here tundeshin nga ndonjë zog a nga era e lehtë dhe aty këtu ngriheshin re me pluhur dëbore si tym i hollë. Ujët e ergjëndtë të lumi tani shëndriste edhe më tepër. Të ftohtit ishte shtuar dhe jeta dukej sikur ishte nemitur.

Rrëmbyem nga një lopatë dhe filluam me xha Meten të çajmë një shteg pér te mulliri i poshtëm. Xha Metja gjerryente përpara, unë i veja pas. Po koha ishte e ftohtë, qelli qe rënduar me re dhe aty këtu fluturonin liliçka nëpër erë. Më ngrinë duart dhe i futa në xhepet e setrës. Xha Metja, që po ndizte cigaren me çakmak, më pa dhe ja bëri:

— Mos i fut në xhep se do të të ngrijnë më shumë, po fërkoji me dëborë, me dëborë!

Mora një grusht dëborë dhe zura t'i fërkoj, po ndjeva një të ftohtë të madhe dhe padashur e hodha dëborën përdhë.

Xha Metja e la lopatën, rrëmbeu një copë dëborë dhe zuri të m'i fërkonte vetë. Duart ca nga ca filluan të më ngrohen. Ay më pyeste:

— A t'u ngrohën, Mentor!

— Duart m'u ngrohën ca, — iu përgjigja unë, — po më djegin majat e gishtrinjve.

Ahere xhá Metja hapi krahérordin, pastaj më mori duart e mardhura dhe i futi nén sqetullat e tij. Ngrohtesià e trupit më vajti dalëngadalë gjer në majat e thonjve. Dhe ne ngjisnim si klloçka, kur i mer zogjtë e saj nén krahë. Si e mora veten filluam prapë të gërryejmé.

Gomari nga të ftohtit apo nga që na ndjeu se po i afroheshim, zuri të pëlliste. Xha Metja e qetësonte:

— Prit, xhan, prit! Kjo murtaja do të na marrë shpirtin!

Xha Metja nuk e donte dimrin, dhe kishte se përse të mos e donte — ay e ndante nga bota, e ndante nga puna, kurse xha Metja kur s'kishte punë në dorë e ndjente veten të sëmurë. Vetëm Murxhoja sulej poshtë e lart i gjuar dhe Xha Metja ja bënte:

— Mirë thonë, qëni s'do t'ja dijë nga të ftohtit!

Dhe me të vërtetë Murxhoja hidhëj nëpër dëborë, zhdukej gjékundi, pastaj dilte prapë duke u sulur, shgryhej dhe nga hundët i delte avull i ngrohtë.

Gomari na priste me padurim dhe kur na pa, ja bënte si njeri i mallëngjyer:

— Hëhë! Hëhë! Hëhë!

Frëngjinë e mullirit të poshtëm e kishim harruar hapur dhe dëbora kish hyrë bënda. Gomari dridhej i téri, dhe sado që ishte shkundur, akoma i kishte mbetur dëborë edhe në kurriz edhe nëpër veshët që i mbante të ulur si të thyer më dysh.

Xha Metja mori fshesën dhe e fshiu mirë mirë. Mua më tha:

— Sa të qëroj unë dëborën, ti, Mentor, ndiz zjarrin!

Mora ca shkarpa, ca tallash, ca kashtë, qërova vatrën dhe ndeza zjarrin. Po gomari akoma rrinte si i shastisur, dhe herë pas here dridhej i téri. Murxhoja hynte e dilte përjashta, shkonte nëpër këmbët e gomarit, po ky tani e duronte, nuk hidhte as vingla as nuk i derdhej me dhëmbë ta kafshonte si bënte më parë kur e ngacmonte qëni. Nuk e di pse, po Murxhoja me gomarin hiç nuk shkonin. De-

gët e shelgta zunë të kërcasin në kllanik dhe flaka, si gjuhë, nisi të lëpinte oxhakun. Shkëndijat, që shkrepnin herë pas here, dukej sikur qeshnin dhe një gaz sikur pushtoi téré mullirin e poshtëm. U ngjall jetë.

Xha Metja u shtrua në krye të kllanikut dhe hidhte në zjarr drutë që kisha mbledhur tok unë. Gomari bëri pér nga ne dhe qëndroi tri katér hapa larg zjarrit. Si pér çudi dhe Murxhoja u shtri në këmbët tonë. Dhe të gjithë ja kishim qepur sytë flakës së kuqërremtë që hidhej e përdridhej nëpër oxhak, si ndonjë vajzë që heq vallen në ditë festë lidhur në kokë shami allgjyvezi. Bashkë me të ngrohit na erdhë edhe fjalët edhe hareja dhe të gjithë u bëmë më qejf. Gomari s'dridhej më, e kishte marrë veten. Dhe mulliri i poshtëm vetë dukej si i gëzuar që kishin vajtur mysafirë.

Kaluan ditë, javë dhe njeri nuk vinte më në mulli. Udha ishte prerë. Ne u shkëputëm nga bota. Dhe u radhitën ditë monotone. Xha Metja ngrivej, më jepte mua një misur me fasule t'i qëroja dhe vinte xhezvenë në zjarr. Si pinte kafenë, ngrivej të shikonte gomarin. Në çengelin e oxhakut kusia me ujë vlonte.

Jashtë dëbora ishte shtuar. Edhe dy herë të tjera, kishim qëruar shtegün pér te mulliri i poshtëm. Mulliri ishte si i shurdhër, pënda nuk kthehej më, as mokrat nuk punonin. Xha Metja e kish nxjerrë gurin e sipërm dhe po e kalitëte. Unë i rrilia pranë dhe e shikoja me vëmëndje. Xha Metja merte një kalem të sheshmë dhe u binte dhëmbëve të gurit të mullirit. Cefla të vogla kërcenin më të djathitë e më të mëngjér. Dhe punonte xha Metja kështu me orë të téra, harrohej në punë. Herë herë ndizte nga një cigare me çakmakun e tij, dhe rrinte si i menduar, po sytë dhe ahore nuk i ndaheshin nga guri që kish përpara.

— Mentor, shiko, shiko, po zanati nuk mësohet duke shikuar! — dhe më merte dorën, më jepte kalemin e vinte në ndonjë dhëmb dhe më mësonte se si t'i bija.

Si kalit m mokr n e sip rme filluam t  poshtmen. N  k to dit  mulliri sik r ringjallej pak , se n  mulli po s'pati zhurm , nuk ka jet . Vet m se pluhuri dhe ceflat e mbulonin t r  vatr n dhe un  her  pas here i fshija dhe i mblidhja, n  nj  qoshe.

Jasht  frynte e mbante. Nj  er  fishk llente si g rnet , kalonte n p r fr ngjite e mullirit, pastaj largohej tutje dhe sikur merte t  p rpjet n e gryk s s  lumit. D -bora shk lqente si copra gur  t  c muar. Zogjt  futeshin her  pas here n  mulli, si hajdut , rr mbenin ndonj  kok r grur  a mis r, c't  gjenin, dhe dilnin nga fr ngjia prap , si fluturonin dy tri her  rr th e rrotull br nda. Macja ahere zg johed   zhurma e tyre dhe u derdhej t'i zinte. Po nj  mace q  fle, s'ze dot minj. K shtu i ngjante dhe maces son : sa t'i kapte, ata shkonin dhe ajo vinte p rs ri pran  kllanikut e binte n  gjum :

Si mbaroi gur t e mullirit, x  Metja zuri t  gdhente ca pyka. Po dhe ato i mbaroi br nd  dy dit ve. Un  kisha pun t e mia — fshija vatr n; ndizja zjarrin, q roja fasule; po si i mbaroja k to, ahere fillonte m rzitja. M  kujto-heshin shok t, lodrat dhe m  vi t  t  qaja e t  qaja e t  mos pushoja s  qari, po m  vinte turp nga x  Metja.

XX

METJA SJELL NË MULLI NASTËN E NGRIRE.

Kishte ca kohë që xha Metes nuk i haheshin as fasulet, as fierzat. Pastërmanë e kishim mbaruar. Kur ngriheshim nga sofra, xha Metja ja bënte:

— Eh, të kisha një çikë mish tani, si melhem do të më vinte në bark! dhe përdridhë mustaqet.

Një mbrëmje ay më tha mua:

— Ty, Mentor a të hahet, hë?

— Më hahet, — ja ktheva unë si me drojtje.

— Kur të hahet dhe ty, — ja bëri xha Metja, — nesër do të dal për gjah!

Dhe që atë natë nxori nga një sëndyq një dyfeg të vjetër, e pastroi mirë mirë dhe e leu me vaj. Pastaj i vuri një fishek, dolli te dera dhe shtiu një herë. Oshëtima e kërcitjes u dëgjua matanë bregut për një hop dhe pastaj plakosi prapë ajo qetësia e pérherëshme që mbretëronte tanë dimrit nga këto anë. Xha Metja nuk më kish thënë gjë gjer ahore se kish apo jo dyfeg dhe nuk di se si m'u duk dhe më i fortë! Ngandonjëherë ashtu si rrija i qetë dhe i mërzitur anës vatrës më kapte frika. «Po sikur të na vinë hajdutë këtu ç'do të bëjmë? Do të na therin si kecër që të dyve» thosha me vete. Xha Metja kish vetëm një thikë të madhe në brez, me myll të fildishtë dhe me zburime përsipër. Tjetër gjë s'i kisha parë. Kur nxori dyfegun, më shkoi ndërmënd që Xha Metja do të ketë edhe kobure, edhe shpatë e kush e di se ç'armë të tjera! Dhe jeta në mullinjtë e Thikësit nuk m'u duk më në rrezik.

Të nesërmen xha Metja u ngrit më shpejt se herët e tjera. Hodhi një torbë kalaqafë, dyfegun në krahë dhe e mbuloi me gunën përsipër.

— Murxhon ta le ty, Mentor, ta kesh si shok, — më tha ay dhë u nis.

Qëni bëri prapa tij, po xha Metja u kthye dhe i hodhi një top dëborë. Murxhoja u zembraps si pa qejf. Unë e zura për qafe që të mos ikte, duke shikuar xha Meten që po largohej. Aty këtu futej nëpër dëborë dhe prapë çante metalet përpara. Kur e humbëm nga sytë, u futëm brënda bashkë me Murxhon, po mulliri se si m'u duk si i zbrazët, i ftotë, megjithëqë në zjarr bubullinte një kërcu i téré. Dhe ahere e pashë qartë se sigurinë e rrojtjes në këtë shkretëtirë e bënte vetëm qenia e xha Metes, fjalët e tij kumbonjëse, puna e tij e palodhur; jeta, me një fjalë, këtu ishte e lidhur ngushtë më xha Meten. Murxhoja, si i zemëruar që nuk e mori me vete i zoti, u shtri pranë kllanikut, futi kokën ndër shalë dhe ra në gjumë. Herë tjetër ay lozta nëpër mulli, kurse sot, sot qdo gjë sikur ishte në heshtje. Dhe macja më dukej se nuk gjerriste. Vetëm unë sikur merja frymë në këtë rrëth të gurtë. Vendosa të vete të shikoj gomarin te mulliri i poshtëm. U nisa. Ndonjë drizë që zgjatëte kokën përbë dëborë, e vetmë në mes të pllajës përtej, më dukej si njeri, sikur luante nga vëndi, sikur ecte, sikur vinte drejt mullirit... Prapa meje ndjeva çape. Kush do të ishte? Nuk guxoja të ktheja kryet. Ishte Murxhoja që po më ndiqte me përtim nga prapa.

Me të më ndjerë, gomari zuri të pëlliste. Po tani zëri i tij më trëmbte, më dukej sikur do të dëgjonte ay njeriu në pllajë dhe do të vinte... Kur ktheva te mulliri i siperim, fasulet zjenin në çengel, avulli ngrihej përpjete dhe përhapej nëpër vatër, si gjithnjë, ndonjë pikë binte mbi prush dhe ja bënte cerr, cerr pér një hop dhe prapë heshtje. Vura një thes në kokë dhe dolla përsëri jashtë. Nuk binte as dëborë, as erë nuk frynte. Ndoqa me sy çapet e Xha Metes, po ata humbisnin gjëkundi në dëborën e bardhë, që ndrinte si qelq. Hodha shikimin më tutje nga e merja me mënd se mund të kish vajtur xha Metja, po kudo shkëlqente dëbora, si ndonjë napë e bardhë, aty këtu e zhübrosur dhe vënde-vënde e tendosur sa mënd këpuntej. Vura vesh mos dëgoja ndonjë të kërcitur.

po në-vënd të saj dëgjova të trokiturat e zemrës sime, dhe heshtje, prapë heshtje. Dhe e ndjeva veten përsëri vetëm, fare vetëm! Ahere zura të thërres me sa zë që kisha:

— O xha Meteeee! O xha Meteeee!

Por vetëm oshëtimë e bregut përtëj më përgjigjej:

— Meteee, Meteee...

Sa kohë kisha thërritur as unë nuk e di, po kur u-ktheva në nulli, fasulet kishin mbetur pa një pikë ujë dhe këmbë e duar i kisha akull të ftohta. Murxhoja dhe macja më ndjenë dhe u zgjuan nga gjumi. Macja m'u afrua pranë duke u përkëdhelur nëpër këmbë dhe duke ja bërë miau, miau. Dreka kishte shkuar qëkuri. Po ditët e dimrit janë të vogla dhe ngrysen shpejt. Sa më tepër afrohej mbrëmja, më shumë më shtohej edhe mua frika. Kur ishte xha Metja në nulli, as trarët më trëmbnin më, as errësira, po tani dhe sytë e maces që më shikonin si me lutje dhe bishti i Murxhos që e tundte nga mirënjojja, më ndrydhnin shpirtin. Shtrëngóva rrripat e llastikave, dhe me thesin në kokë dolla jashtë. Kishte zënë të errej. Xha Metja s'dukej as nga ndonjë anë dhe unë s'durova dot më. Ndolla Murxon dhe u nisa ta kérkoja.

Koha ishte ftohur alkoma më shumë. Një thëllim i hollë-ta priste si me brisk fytyrën. Qëni ecte përpëra duke nuhatur nëpër gjurmat e xha Metes. Unë e ndiqnja prapa. Në një si breg qëndrova dhe zura të thërres:

— O xha Meteee! O xha Meteeee! Meteee!

Por asnjë zë nuk më përgjigjej. Vetëm Murxhoja angulliti dy tri herë.

Errësira po binte dalëngadalë edhe sikur nuk dallohej, se hëna, si ndonjë çyrek i grynjë, kishte zgjatur kokën prapa maleve të Furkës dhe, si vajzë e turpshme, ecte me naze, e ndrojtur. Dëbora shkëlqente si e spërkatur me gurë xhevahirë. Gjurmët mezi cquheshin. Fillova të ecij kulturë. Eca sa éca dhe prapë qëndrova, vura vesh, po asgjë nuk dëgjohej. Vetëm thëllimi ja bënte nëpër honet fiu-fiu. Gjurmat ishin zhdukur, dëbora këtej ishte e shkrifët dhe era e ngrinte përpjetë si pluhur. Unë me thesin në kokë ecja kokëulur. Në një vënd, Murxhoja filloi të lehë.

Një herë, dy, papushim. Një e rrënqethur më shkoi nëpër trup. Më shkoi ndërmënd mos i kish rënë era ujqër. U tulata pas një shkëmbi. Murxhoja rendi përpara. Sikur dëgjova zëra, s'prita më, po ja buçita:

— O xha Mete!

Zëri i xha Metes u dëgjua si ndonjë kambanë, fare afër.

— Ehhh!

Frika menjëherë sikur m'u zhduk, dhe ujqrit u zhdukën, dhe të ftohtët e harrova dhe renda për nga zëri i xha Metes. Iu afrova i gëzuar. Po ay më priti me inat:

— Ku je nisur kështu, — më tha ay, — të të çajnë ujqrit, apo do të ngordhë nga të ftohtit, si kjo këtu?

Ngriva në vënd.

Xha Metja shtoi:

— Nga një anë mirë bëre që erdhe se të gjitha nuk i sillinja dot. — Dhe më dha mua dyfegun dhe torbën. Të ngrirën e mbështolli me gunën e dhirtë dhe e hodhi në kurriz. U nisëm. Murxhoja anglliti dy tri herë. Unë i çuditur e i trëmbur nuk guxoja ta pyes xha Meten se cila ishte. Po ecnim pa fjalë e në heshtje. Dëgjohej vetëm të rënkuarit e thellë të xha Metes nga barra e rëndë. Aty këtu ay qëndronte për të marrë pakëz frymë dhe ja bënte i merakosur:

— Eh, Mihal, Mihal!

Kur erdhëm në nulli, xha Metja e la të ngrirën mëjanë, larg zjarrit dhe ndezi menjëherë pishtarin. Mua më tha:

— Hidh ca dru në zjarr dhe zbatch çorapët!

Nën driten e rrëmbyer të pishës pashë fytyrën e të ngrirës. Ishte Nasta, e shoqja e Mihal Gjeçit. E bardhë e bardhë si dëbora vetë. Sytë i kiske si gjysmë të hapur. Por as lëvizte, as frymë nuk mirte. Xha Metja i zuri duart, i vuri veshin në zemër dhe tundi kokën! Pastaj filloj t'i lëvizë duart, këmbët dhe ja bënte:

— Mor për e ngrohtë e ngrchtë është akoma. po...
— dhe prapë tundte kökën.

Sa ndryshim kishte midis xha Metës dhe Nastës. Ai ishte i skuqur në fytyrë, sytë i ndrinin, djersa fllucka-fllucka i kishte mbuluar ballin, kurse Nasta ishte si ndonjë napë e bardhë, si nga duart ashtu dhe nga fytyra.

Xha Metja mori një shtëmbë me ujë të ftohtë dhe ja zbrazi në fytyrë. Pastaj e fshiu ujët seftë me dorë, duke i shtrënguar dejet e qafës, të zverkut, por ajo s'bënte asnjë lëvizje.

Unë, strukur anës gllanikut, shikoja i trëmbur në njerën anë vdekjen dhe në tjetrën — jetën. Jeta po lëftonte me vdekjen.

Xha Metja rendi përjashta, rrëmbeu një grusht déborë dhe zuri prapë t'i fërkonte duart, dejet. Nasta e shikonte si me qesëndi, pse buzët i kishin shkuar pakë mënjanë dhe sikur qeshnin.

Namëtë u dëgjuan zëra përjashta:

— O Mete! O Mete!

Murxhoja zuri të lehë. Xha Meteja hapi derën. Ishte Tasi, ay burri zeshkan, që njoha ditën e parë, Miti Kosta Miçuà dhe një djalë i ri. Të gjithë kishin nga një kopaçe me dorë dhe ishin me fytyra të brengosura. Vetëm Tasi kishte çifte në krahë, ay ishte gjahtar.

— Mor Mete, — ja bëri Miti që nga dera, — mos erdhi këtu sot ajo Nasta e Mihalit, more?

— Hyni, hyni brënda! — ja ktheu xha Metja.

— Ne pandehëm se e kanë ngrënë ujqrit, — tha Tasi. — Te Përroi i Nuses i gjetëm thesin me misër dhe tërkuzën!

Ata akoma nuk e kishin parë të ngrirën dhe njeri prej tyre ja bëri:

— Nastë moj, të martë djalli se na trëmbe! Lebetite dhe fëmijën!

Por kur u afruan dhe e panë Nastën të shtrirë sa gjatë gjërë dhe pa shpirt, sikur ngrinë dhe ata vetë më këmbë.

— Po si ngjau, mor Mete? — ia bëri Tasi.

— Lere, aman, ç'e gjeti Mihalin, ja ktheu xha Metja. — Sot në mëngjez dolla për gjah. M'u hëngër ca mish. I rashë tërë korijes dhe s'gjeta asgjë, nejse! Kur po kthehesha e gjej në mes të rrugës. Kishte qëndruar mbi një gur si pa frysë. Me t'iu afruar, zura t'i thérres: — Oj Nastë, oj Nastë! — Por ajo nuk m'u përgjigj. Dreq o punë, thashë me vete, ç'është kjo, as e gjallë e gjallë, as e vdekur e vdekur. Pse kish qëndruar si e gjallë, dhe sikur s'donte të llafoste, si e zemëruar? Ju afrova dhe e zura për dore. Ishte e ngrohtë dhe nga goja nxirrte frysë. Ka ngirirë ja bëra unë dhe fillova ta férkoja me dëborë, po zuri të erret dhe s'dija ç'të bëja. Namëtë vjen Mentor, nipçëja dhe e suallëm gjer këtu si e shikoni.

Ndënjenë të pesë fshatarët rrëth e rrotull saj. Miti e e zuri për dore dhe tha i pikelluar:

— Eh, ka shkuar e gjora! Ndjesë pastë!

— Ja ç'ështëjeta, — ja bëri Tasi, — hiç gjë! Djë qemë bashkë në pazar. Kishin mbetur pa bukë, ndjesë pastë, po shyqyr Mihali u dërgoi ca para nga Delvina dhe mori një tridhjetë okë mësér. Unë ja solla me kalin tim. «Nesër, më tha, po të jetë koha e mirë, do ta shpie në mulli, metale, pa metale, fëmija s'më kanë ç'të hanë!» Apo s'ka pakë, e gjora, katër, si kërpudha, dhe të gjitha çupa.

— Unë e pashë kur po shkonte për në mulli, — ja bëri Miti, — e gjeta në rrugë dhe e pyeta: «Për ku kështu, moj Nastë, me këtë thes në krah?» «Gjer në mulli, më tha, zoti Miti. — Ja koha u ndreq ca... i kam fëmijën pa bukë!»

— Ta ngremë tanë, s'bën, — tha Tasi, — natë është, kanë dalë dhe kuluminj. Njëditézaj Pandoja, bekciu, i kish parë andej nga Izvori.

— Ç'vete që larg ti, — ja ktheu Miçua, — dje mbrëma i çanë Gulit Pértej dy dhën dhe Balon, që çfarë qëni ishte?

Dhe sikur e harruan tē vdekurën, i hodhë një gunë përsipër dhe u shtruan rreth zjarrit. Pastaj filluan tē flasin pér qënér, pér dhën dhe si gjithnjë erdhi më në fund fjala në kullotat që ua kishin marrë bejlerët e Xhufkës. Ca thoshin t'i hedhin në gjyq, ca tē dërgonin njerëz gjer në Stamboll pér tē nxjerrë tapitë e vërteta, ca thoshin t'ua merrnin më zor si ua kishin rrëmbyer dhe ata...

Xha Metja i dëgjonte duke shkoqur herë pas here kërcurin e gllanikut dhe thekte këmbët e lagura prej dëborës. Një avull që ngríhej përpjetë digjte në hundë, bashkohej me tymin e cigareve dhe çdo gjë dukej si në ndonjë mjegull tē dëndur. Nga kjo mjegull apo nga fatkeqësia e Nastës, mua asnjë nuk më vuri re, bile dhe Miti me tē cillin isha mik i vjetër.

Tërë natën e gdhim me fjalë. Të nesërmen në mënjes fshatarët bënë një tezgë me ca dhoga që u dha xha Metja, vunë Nastën mbi tē, e mbuluan me një gunë dhe një përpara, një prapa u nisën pér në fshat.

Me javë tē tēra pastaj në mullinjtë e Thikësit sikur ndodhej dhe hieja e së vdekurës. Xha Metja u bë më i heshtur. Unë s'guxoja t'i flisja. Mbrëmave, kur binim në robat, i mbyllnja sytë dhe e mbulonja kokën, po Nasta prapë më dilte përpara dhe gjumi mezi më zinte, po dhe ahere shikoja ca éndërra tē liga, sa që lebetitesha dhe menjéherë zgjohesha duke kërcyer përpjetë.

XXI

UJQE

Dimri vazhdonte i hidhur e i ftohtë. Kishte dhe ditë me diell, po dielli sikur kishte dhëmbë e të kafshonte. Pothuaj se gjithë ditën e kalonim anës kllanikut. Dilnim vetëm sa i hidhnim gomarit gjëkafshë për të ngrënë, sa vinim për ujë ose për të marrë dru nga stava prapa mullirit.

Një natë u zgjova nga gjumi i trëmbur. Përjashta dëgjoheshin ulërima — ulërima ujqërish!

Xha Metja që ishte zgjuar, si zakonisht, më tha për të më qetësuar:

— Mos u trëmb, Mentor, këtu s'kanë si të vinë! — Dhe shtoi: — Sivjet dimri qe më i gjatë dhe s'kanë ç'të hanë malit! Do çajnë njëri tjetrin! Ti mos u trëmb!

— Po uqrit s'pushonin. Dhe megjithëqë fjalët e xha Metes ishin të drejta, nuk më qetësuan. Një e dredhur dhe një e rrënqethur më kaloi nëpër trup dhe më dukej sikur i shikoja ujqrit përpara derës së mullirit, të më-dhenj sa gomari ynë, të murmë e me bisht ndër shalë, me gojë të hapur e të kuqe si flakë e me dhëmbët të mprehtë thikë, gati të më hidheshin në grykë e të më bënин copë copë.

Si e pa xha Metja që s'kishin ndërmënd të pushojnë, ndezi pishtarin, rrëmbeu dhe pushkën dhe hapi derën ngadalë. Pastaj shtiu dy-tri herë në erë. Ulërimat pushuan për një hop. Unë i trëmbur dhe me kokën ngritur përmbi plafin e dhirtë, vështroja për nga xha Metja. Ay ja bëri:

— Sikur janë një kope e tërë, bre! Ujqër e ulkonja na paskan ardhur në gosti! — dhe e mbylli derën përsëri.

Por pas pakë uqrit ja filluan prapë havazit të tyre: auuuu, auuuu, auuuuu... dëgjoheshin pranë mullirit të

sipërm dhe kjo këngë e vajtueshme e urisë së ujqërve s'kishte të mbaruar.

— Mor po do të na pinë sytë këta dreqër sonte! — ja bëri xha Metja. — Tani po ua ndreq unë! — tha ay dhe ndezi një flegër të madhe pishe. Flaka e saj llapsi tërë vatrën e mullirit. Pastaj, që nga baxha e nxori përjashta dhe e vërtite më të mëngjér e më të djathtë duke thërritur: — Hyyy, hyyy, hyyyy!

Sic duket këtë radhë ujqrin u trëmbën më shumë, se sa ndénji xha Metja te baxha nuk u dëgjuan. Po dhe më vonë, kur ay u kthyesh dhe e hodhi flegrën e nxirë në gllanik, heshtja mbretëronte kudo. Ne me veshët përpjetë si te ndonjë lepuri — unë nga frika, xha Metja përfshirë të më qetësuar, mua, — dëgjonim.

— Hajde, fli tani, — më tha më në fund ay, — ujqrin e thyen qafën!

Tri net me radhë ujqrin na zgjonin nga gjumi në mes të natës me ulërimat e tyre. Xha Metja i shante nëpër dhëmbë, merrte pushkën dhe që nga baxha shtinte dy-tri herë. Oshëtima buçiste matanë bregut, i shurdhonte ulërimat e ujqërve dhe xha Metja kthehej i kënaqur dhe rrinte prapë anës killanikut. Unë mbuloja kryet hem me duar hem me plafin dhe më zinte gjumi.

Që nga dita e vdekjes së Nastës mulliri sikur kishte rënë në zi. Çdo gjë sikur ishte në heshtje. Mokrat rrinin shtrirë, si të plagosura dhe s'rrotulloheshin e s'këndonin si në ditët e vjeshtës, kur bluanin me ditë e me netë misër e thekër, e elb, dhe tek tuk grurë. Tani edhe çapet e rëndë të xha Metes, edhe gjërritja e përjetëshme e maces, edhe të hapurit e gojës së Murxhos përtac, që e kalonte gjithë ditën në gjumë, më mërzitnin dhe mëndjen e kisha te teze Aisheja, te shokët, që sigurisht tani lozni në oborin e shkollës me topa dëbore, të qeshur e të gëzuar. Dhe më vinte t'u mbathja këmbëve, po kisha frikë, hem nga dimri, hem nga ujqrin!

XXII

DITËT E FUNDIT TE DIMRIT

Xha Metja nuk gatuante më kulaçe të grynya. Një misërnike e hupët, si shur, hynte delte nga magjeja. Gjellë hanim më tepër — kripë dhe piper, duke ngijyer kafshoret në kapakun e drunjë të kupës. Jeta në mulli kish-te ndryshuar.

Xha Metja prapë sillej vërdallë dhe kurrë s'rrinte me duart kryq, sot gdhënte fletën e mullirit, nesër përgatiste hunj pér jazin o pér cfratin. Sëpatat, që të dyja, të madhen dhe të voglën, i mpreu, i bëri halë. Edhe sqeparin e limosi dhe sharrës ja bëri dhëmbët, po tërë në heshtje. E linte pakë punën, ndizte një cigare dhe e thëthiste tymin gjer thellë në mushkëri. Pastaj duke shikuar gjékundi nëpér trarët, rrinte i menduar.

Në këto ditë unë s'dija ç'të bëja. As këndimin e kisha marrë me vete, as ndonjë libër tjetër, dhe shkolla m'u bë tani më e dashur, tani që e kisha humbur pér përgjithënjë. Viendjen gjithë atje e kisha. Më dilte përpara Drita, më-suesja jonë dhe sikur e shikoja të gjallë, me ata sytë e saj të bukur e me ato fjalët e saj të embla. Shpesh dilja gjer te dera dhe, kur jashtë frynte e binte, kthehesha menjëherë i brengosur brënda, po kur koha ishte me diell, rendja jashtë, hidhesha gjer nga gomari, e përkëdhelja, e kruaja, pastaj ja hipja dhe e shpija pér ujë. Gomari aty këtu shikiste, po unë i isha qepur në kurriz me këmbët shtrënguar në bark dhe nuk bija, po si ndonjë ketër i zë-në pas ndonjë dege, i varesha pas qafe duke e pushtuar me të dy duart. Dëbora e bardhë shkëlgente, irezet e die-llit më binin drejt e në sy dhe unë pulitesha si i përcëlluar nga zjarri. Lisat e xhveshur nxin. Ndonjë zog fluturonte i shpejtë si plumb dhe zhdukej. Heshtja mbretëronte nëpër honet dhe nëpër gërxhet. Vetëm lumi perç-

shkumbë e i rrëmbyer gjerrnjitej duke rrjedhur poshtë e duke u përpjekur nëpër shkëmbënjtë e nëpër akujt përanësh.

Po dita më ditë të ftohit sikur pakësohej. Dita po zmadhohej. Aty nga mesi i Marsit zuri të shkrinte dhe dëbora. Rrëketë vinin të rrëmbyera që nga brigjet dhe përplaseshin pas lumi, që nisi të turbullohej. Vëndi zuri të nxihej vurrata vurrata. Sefte u nxinë plajat karshi diellit. Dhe pastaj më radhë, të nesërmen do të shikoje ndonjë vurratë gjetkë, si ndonjë ishull në mes të dëborës. Dolli dhe juga dhe brënda një javë e hëngri të tërë dëborën. Një shi që ra pas saj e mbaroi fare. Dheu u nxi e avullonte gjë nga drekëhera si bukë e valë. E të gëzohej shpirti kur shikoje se si po ripërtërihej jeta.

Dy tri ditë me radhë bashkë me xha Meten qëruam jazin. Ngriheshim me natë, akoma pagdhirë mirë, merrnim lopatat dhe dalëngadalë arrinim gjë nga cfrati. Xha Metja zgjeronte vijën, unë qëronja gurët. Si mbaruam jazin, rregulluam edhe cfratin. Xha Metja zbathur hynte në mes të lumi, rrukulliste gurët, i vendoste gjékundi dhe u hidhte përsipër dëllinja, u binte me lopatën, i ngjeshte me dorë. Ujët e shpejtë të lumi përplasej pas tyre, po nuk i merte dot. Gurët kishin zënë vënd mirë dhe ja prisnin forcën rrymës, e cila bënte një të kthyer prapa. pastaj kalonte përmbi ta dhe merte poshtë, më e shkumbëzuar, më e rrëmbyer. Më në fund ujët kërceu për nga jazi, sefte si një bisk i hollë, i pakët, po pastaj gjeti udhën dhe si ndonjë foshnjë që ecën me dorë e me këmbë, u rrukullis për nga mulliri. Jazi dhe cfrati ishin gati. Qysh atë ditë lëshuam mokrat. Dhe mulliri filloi të këndonte si më parë.

Të nesërmen erdhi në mulli dhe fshatari i parë. Ishte Kosta dhe që nga larg zuri të thérresë:

— O Mete! O Mete!

Ne iu derdhëm përpara.

— Si jini, more, ku jini? — thosh ay dhe e lëshoi thesin mbi kërcurin e sofatit.

Xha Metja, pa i' zgjidhur akoma litarin, e përqafat. Këshfu u përqafua edhe me mua.

— Po ju ç'bëni, more Kostë? Si e nxuart dimmën?

— Me halle, me halle dhe pa bukë! — e nderpireu Kosta gazin e takimit tënë. — Na u mbarua mielli dhe ja u hodha gjer në mulli të më bluash pakë misér, se i kam fëmijën pa bukë, ore! Le de të gjitha, po sivjet: na u mbaruan dhe drutë dhe keimi ngirë si qëni, o Mëte!

Pastaj e muarën që të dy thesin, njëri nga gryka, tjetri nga fundi dhe hynë brëndau ta zigjasin: Xha Metja i thoshte Kostës:

— Dje i lëshova mokrat, po hiç mos! Ki qedër, se nuk janë pas farke! Blova seftë tagjinë e gomarit, nja njëzet okë tershëre dhe ca urov, dhe hiç mos ki qeder!

Si hodhi misrin në kosh, lëshoi mokrat. Trokashka filloj këngën e saj monotone — trak, trak, trak, trak, trak, trak! Xha Metja ndënji si gjithënje anës sëndyqit dhe herë pas here merte nga një drudhe miell në majë të gishtrinjve dhe e shikonte se si bluhej, duke e ferkuar dhe duke e lepirë. Dhe Kosta ndënji afér tij dhe aty këtu shkëmbenin nga ndonjë fjale, duke therritur se zhurma e trokashkës dhe e mokrave të shurdhojnë veshët.

Dita me ditë fshataret shtoheshin. Vinin bluanin me nxitim, kush njëzet, kush tridhjet okë, sa për të mbajtur shpirtin. Xha Metja lëshoi dhe mullirin e poshtëm. Gomarin tani e mbanim jashtë. Xha Metja bluanante te mulliri i poshtëm, mua më linte të i sipermi, Zura dhe unë të bluaja e të zgjasja si xha Metja. E zija thesin nga gryka dhe mezi e ngrija më këmbë. Pastaj ja vërtitja qafën dy tri herë me zinxhirin e zigjit dhe e varnim në sup mbi shufër. Këmbët më epeshin nga barra e rëndë.

— Mbaju, mos biesh, — ja bënte fshatari duke qeshur.

— Mbahem, mbahem! — ja ktheja unë, i krrusur si ndonjë plak nga barra e vjetëve?

Pastaj, me ndihmën e fshatarit, e hidhja thesin në kosh, lëshoja mokrat dhe trokashka ja fillonte këngës. Herë pas here merja në dorë nga pakë miell, ashtu si bënte

xha Metja; e férkoja; nëpër gishtrinjt dhe e lëpija me gjuhë, i menduar.

Fshatari më thoshte:

— Shiko se mos më prishësh drithin, ore, se është fundi i hambarit dhe më mori përroi!

— Mos kë qedér, — ja bëja unë. Dhe për ta qetësuar i jepja ca miell me majën e lopatës.

Fshatari e shikonte me dorë, e lëpinte, e gjente të mirë dhe më përgjigjej me buzë në gaz:

I vogël, por kolopuç je, të lumtë!

Herë pas here dilja të shikoja dhe jazin, mos ishte kthyer gjékundi a mos e kishin shkelur bagëtia, pse qëkur u hap koha dhe u shkri dëbora, çobani i Thikësit i nxirte bagëtinë gjer-këtej nga mulliri. Me shatë në krahë, kaloja anës vijës, aty hiqja një gur, më tutje nxirja ndonjë plis dhe e zija, vijën atje ku ish lëshuar. Kështu arrija gjer te cfrati, zbatohur e në këmishë duke vështruar natyrën e përtëritur. Pemët nuk ishin më si njerëz të varfér e të grisur, ato kishin veshur rrëbra të reja e dukeshin sikur qeshnin nga lumtëria, Pllajat dhe brigjet kishin filluar të gjelbërojnë. Anës lumit, nëpër shelgjishtat, gumëzhanin zogjtë. Dallëndyshet fluturonin përmbi ujë, po aqë ulët sikur u çikej barku në të dhe zhdukeshin nga ndonjë anë. Kishin dalë dhe zhizhikët dhe u vinin vërdallë luleve të murrizave. Dhe cdo gjë lëvrinte e nxitonë, sikur donte të vinte në vend kohën e humbur gjatë dimrit.

Lejzatorët i përfunduan, më shumë rreth 1500, që tashmë varet e lajmeve. Gjatë përfundimit, shpërthimet e kësaj kohë, që tashmë varet e lajmeve.

U mbushin shpellat e rrafshëve me muri, përmes të cilave mund të vijnë përfundimi i shpellave e shkëmbit. Në mënyrë që përfundim, u përmend që vështirësia e cilës së përfundimit e përfundim i shpellave e shkëmbit, u përmend që vështirësia e cilës së përfundimit e përfundim i shpellave e shkëmbit.

Prampara që përfundim, më shumë rreth 1500, që tashmë varet e lajmeve. Gjatë përfundimit, shpërthimet e kësaj kohë, që tashmë varet e lajmeve. Gjatë përfundimit, shpërthimet e kësaj kohë, që tashmë varet e lajmeve.

XXIII

NJE DITE NË THIKËS

Zahirenë e dëmrit kishim kohë që e kishim mbaruar. Nuk kishim as kafe, as sheqer, edhe duhan i kishte imbetur fare pakë xha. Metës dhe një dite më dérgoi në fshat, te Markoja, më një pusullë në dorë për të më dhënë ca plaçka veresie.

U mbatha, se në mulli rrija zbatohur, vësha dhe sëtrën që kisha sjellur nga K., hodha torbën kalaqafë dhe mora të përpjetën për në Thikës. Kur u largova pakë nga muilliri zura, të vërvhelleja, pastaj ja mora dhe këngës. Ecja, po mua më dukej sikur fluturoja, si i ciliaruar nga ndonjë barrë e rendë. Po s'ishte dhe pakë, një dimër të gjatë e kisha hedhur prapa kurrizit.

Dielli kishte bërë nja katër a pesë hostenë në qiell dhe rrezet e tia të ngrohta sikur më ledhatonin butë-butë si dora e nënës. Udhë hiqej dhe unë vetë nuk e pashë kur u gjenda në majë të bregut. U ulë të çlodhem në një gur. Përpëra meje shtrihej Thikësi dhe më tutje, shumë më tutje, dukeshin dhe fshatra të tjera. Sa afër paskëshin qënë njerëzit! Një xhade e bardhë si qumësht gjarpéronte, nëpër fushë dhe zhdukej në të përpjeta dhe të tatëpjeta. Fshati kishte dy miellallë — të supërmën dhe të poshtmen, që i ndante një përrua në mes. Shtëpitë me dy kate e me gurë, të mbuluara me dërrasa, dukeshin që ishin bërë nga mjeshtër të vërtetë. Po kishte dhe ndonjë të rënë, të braktisur fare dhe si të shkretë. Një udhë e ngushtë hynte nëpër ca kopshte dhe atje humbiste. Anës saj ndodhej një paraklis. Një plakë, që kaloi andej, u fal dy tri herë dhe pastaj kokëulur u fut në një kopsht. Ca cupa me bucela në krahë po vinin përujë. Ato llaforeshin duke nxituar dhe herë pas herë dëgjofeshin të qeshurat e tyre.

Dy gra tē tjera tē ngarkuara me shkarpa po ecnin tē epura nga barra e rëndë. Nj'a katër a pesë fëmijë po losnin në hajatin e një plevice. Asnjë burrë nuk më zunë sytë nëpër udhët e fshatit. Dhe m'u kujtuan fjalët e xha Metes, që burrat e Thikësit e kalojnë jetën kurbeteve.

Më tē djathtë derdhej përroi i vogël nëpërmes një gryke, brigjet e së cilës sikur putheshin njëri me tjetrin. Kur u ktheva nga kjo anë, pa shë njiç çifçi tē vogël që po ngiste një pendë që duke thërritur:

— Ajs Bardho! Hajde Kazil!

M'u duk si i njohur ky zë. Dhe me tē vërtetë nuk u gabova; kur iu afrova, njoha Mandin. Dhe ay më kish parë e më kish njohur. I la qetë dhe bëni për nga mua duke më thënë:

— C'bën, mo, Mentor, si vete? — Dhe u përqafuam si shokë tē vjetër.

Ndénjém anës një visi. Qetë na shikonin me sytë e tyre tē mëdhenj e tē njomë, si me kureshtje. Toka e posa kthyer avullonte dhe pezhishka dridheshin nëpër brazat. Mandi u ngrit duke më thënë:

— Prit pakë, Mentor, t'u hedh ca misrishta qeve!

Mandi lëronte zbatbur e ndër brekë. Këmbët iu fundosën në tokën e shkriftë, gjer në kërci, si në pambuk. Kishte një këmishë tē bardhë prej pëlhure, po kopsat e përparme i kishte çkopsitür dhe me llérët e përveshura dukej si ndonjë bujk i vërtetë. Po kur u hodhi misrishtat qeve m'u duk si ndonjë lomçkë, aq i vogël dukej përpara tyre. Qetë tundën kryet dhe zinë tē shtyhen me njëri tjetrin. Mandi u therriti:

— Ajs Kazil! Ajs! — dhe i ra me dorë që tē sprapset. Kau u zbyth dhe zuri tē hante me zhurmë duke përtypur misrishtat. Kur u kthyë Mandi dhe ndénji, ja bëri:

— Dhe kafshët, ore, janë si njerzit. Kazili heq nga vetja, kurse Bardhoja është i urtë dhe bën udhë. — Dhe vazhdoi: — Kazili është më i dobët, Bardhoja një herë t'i bjerë do ta bënje copë, po ja që s'guxon.

— Ashtu është, — ja ktheva unë pa u thelluar shumë shumë në fjalët e tia dhe shtova: — Po si vini, o Mandi? Xha Miti si është? Nënën si e ke?

— Babanë hiç s'e kam mirë. E ka zënë përdhesi dhe s'luan dot nga vëndi. U plevitos që në dimër, kur suallën Nastën të ngrirë nga mulliri dhe akoma s'e mer dot yeten. Po ti ku je nisur, mo? — më pyeti ay.

— Gjer te Markoja, të blej ca placka, — iu përgjigja unë.

Ky emër e çetësoi Mandin, dhe ja bëri i mërakosur:

— Eh, ndezëm ne nga ky Markoja. I këmi për të dhënë ca para dhe na ka hedhur në gjyq. Kush e di se kú do të dalë fundi!

Kazili i kish ngrënë misrishtat e tia dhe po mertë nga ato të Bardhos, dhe i llufitëtë me nxitim si i pafryrë.

— E shikon, — më tha Mandi, — duke iu kanosur

— Kazil, ajs! Ajs, Dhe i hoqi një hosten vithevë. Kazili u spraps dhe ngriti kokën i zemëruar. Jargë i ranë përpara, në dheun e lagavitur. Bardhoja si i cuditur e shikonte me sytë e mëdhenj të zotin, që po i çfrynte Kazilit. Si çetësoi qetë, Mandi vazhdoi fjalën që e kishte lënë për gjysmë: — Ja, dhe Markoja është si Kazili yne. Po s'ka kush t'i heqë një dru e të rrije rehat!

Pastaj Mandi më tregoi më gisht se ku ndodhet dyqani i Markos prapa ca shtëpive të larta andej nga fundi i fshatit; dhe u ndamë.

Markon nuk e gjeta në dyqan. Një djalë i vogël që rrinte pranë derës, me një vezë në dorë, më tha se dyqanxhiu kishte vajtur, për drékë. U ulat prisja te sofati përpara dyqanit, ndërtuar apostafat nga Markoja karshi diellit. Nja katër pula dhe një këndezi me lëfshë të prerë e të rënë si një copë mish po vinin vërdallë afér derës. Fshatarët i sillnin Markos dhe bereget dhe, kur e zgjasnin te porta, çoku binte nga ndonjë kokërr dhe pulat çukitnin këtu, çukitnin atje, kurse këndezi, kur gjente ndonjë farë, ja bënte «khë, khë, kthë» duke i rënë tokës me njerën këmbë dhe pulat derdheshin për nga ay e ziheshin në mes tyre kush ta rrëmbente më parë. Djalin e vogël me vezën në dorë e zuri gjumi mbi sofatin karshi diellit. Për djall dyqani qe në rrugicë, futur thellë në ca shtëpi të vjetra, që as syri s'kishte se ku të shikonte. Një grua që erdhë duke nxituar më pyeti:

— S'është këtu, Markoja?

— Ka vajtur për drekë, — i thashë unë.

— Hé, — ja bëri ajo dhe shtoi: — ay kur vete për drekë, po s'fjeti, s'nginjet! — dhe u kthyte si pa qejf. Kush e di se ç'hall kishte!

Markoja erdhi nga ndajnatëhera, kur dielli thyhet dhe s'bën më vapë. Unë nuk e njihja, po e kuptova kur hapi derën e kyçur me tre pale kyçe.

Djali i vogël u zgjua nga zhurma e derës dhe e kyçeve dhe hyri në dyqan. Pas tij hyra dhe unë.

Markoja, që kish qëndruar prapa tezgjahut, më këmbë, e pyeti: djalin e vogël me emër:

— Ç'do, Lake, me këtë vezë?

— Një rrrotull penjë të bardhë, — ja bëri Lakeja dhe shtoi: — Po tetja do të më rrahë se u vonova duke të priatur, zotí Marko.

Markoja ishte një thatim, me dy buzë të holla dhë dy sy të vegjël që i ndrinin si dy shkëndija. As i gjatë, as i shkurtër, po nga trupi vinte pakë i plotë. Vetëm zérin e kishte allasoj, si të çjerrë.

Ay nxori nga një kuti një rrrotull me penjë ja dha Lakes. Ahere edhe iu përgjigji:

— Rashë të fle pakë, se s'jam mirë me shëndet. Të gjitha i kam; po me shëndet s'jam mirë! Po ti ç'do? — më pëyeti mua Markoja, me zérin e tij të çjerrë.

Nxora pusullën e xha Metos dhe ja dhashë në dorë:

— I nipi i xha Metes qënke ti? — më tha ay si me të geshur.

— Po, — iu përgjigja unë.

Ay filloj të zgjasë plaçkat. Më tutje s'më tha asnje fjalë.

“Ay filloj të zgjasë plaçkat. Më tutje s'më thaasnje fjalë. — I nipi i xha Metes qënke ti? — më tha ay si me të geshur. — Po, — iu përgjigja unë.

XXIV

HYZMEQARËT E NURÇE BEUT

Puna në mulli sa vente po shtohej. Fshatarët e kishin mbaruar zahirenë e dimrit dhe derdheshin tani në mulli, kush me thes e kush me torbë krahëve. Sa e zgjasnin dhe pastaj dilnin përjashta dhe prisnin duke u thekur në diell nëpër sofatet përpara mullirit. Ngandonjëherë mblidheshin gjer dhjetë, pesëmbëdhjetë veta dhe zjente mulliri si jashtë ashtu edhe brënda. Ne me xha Meten e ndanim punën. Ay vente te mulliri i poshtëm dhe atje ngrysej. Unë bluaja si gjithnjë te i sipërti. Vinin fshatarët si hije të grisur e të brengosur dhe zinin t'i luteshin njëri tjetrit pér t'i lëshuar radhën. Në muhabetet e tyre të rralla, se ata më te pér heshtnin, do të flisnin vetëm pér kullotat që ua kishin rrëmbyer bejlerët e Xhufkës dhe që tani ishin në gjyq: Ndonjë ja, bënte:

— Mo po s'dolli një nga ne Thikësit e të vejë t'ja bëjë bromp atij gjykatesit!

Të tjerët heshtnin. Si e shikonte që s'merte përgjigje, heshtëte dhe ay vetë. Dhe rrinin duke shtrënguar dhëmbët nga inati gjersa t'u bluhej trasta me misër.

Një ditë erdhi në mulli hyzmeqari i Nurçe beut me dy mushka të ngarkuara më nga dy thasë grurë. Pa pyetur, ay i shkarkoi mushkat përpara mullirit dhe i lëshoi azat të kullosin anës kopshtit. Aty u ndodh dhe xha Metja; duallëm ne ta presim. Fshatarët i kishin ndihmuar pér të shkarkuar mushkat dhe të gjithë ishin ngritur më këmbë. Ishte Tasi, Miçua, ay që erdhi atë natë kur muarën Nastën e ngirirë dhe tri gra, Ristovica, e Kostës, dhe një e re, që unë nuk e njihja. Radhën pér të bluar e kishë. Tasi, dhe priste t'i bluheshin nj'a tridhjetë okë misër që posa i kishim hedhur në kosh. Të tjerët vinin pas tij, po do të prisnin si gjithnjë gjer sa t'u bluhej mielli, makar dhe gjer në mes të natës.

— Ç'kemi Zylyftar? — i tha xha Metja hyzmeqarit tē Nurçe beut.

— Dasmë kemi! — ja bëri ay si me mburrie. — Nurçe beu marton Xhafer benë këtë tē xhuma dhe erdha tē na bluash pakë grurë. Pas meje vjen dhe Etemi me një barrë tjetër. Se djalë beu martohet, helbete more Mete, s'i thonë shaka!

— T'i trashëgohet, t'i trashëgohet, — tha xha Metja si i gjuar dhe shtoi: — Pa hallbu që unë jam shumë i zënë, mor Zylyftar, dhe sot e nesër nuk t'i bluaj dot.

Fshatarët, që gjer ahëre prisnin se ç'do tē thoshte xha Metja, u gjuan. Fyturat e tyre tē zbeta e tē bengostura silkur u ngjallën. Dhe mua më erdhi mirë, se e mbaja mënd akoma atë ditë kur Nurçe beu desh na shtypi me atin e tij.

Sytë e qelqtë tē Zylyftarit u mbushën si me ujë nga zemërimi.

— Do t'i bluash, — i tha ay. — Do ta presësh radhën, se helbete, fshataret mund tē presin, dasma s'pret.

— Jo, or vëlla, unë s'pres dot, — ja bëri me tē mirë Tasi. I kam lënë femijën pa bukë në shtëpi.

Po tē kishte qenë vetëm, Zylyftari ndofta do tē kishte ngritur dorën t'i binte, po tanë shtatë palë sy e panë me zemërim dhe ay e mbajti veten. Në vënd që t'i përgjigjej, ay hyri si i marrë në mulli. Nga ne asnje nuk e ndoqi. Xha Metja rrini tē menduar me kokën poshtë, duke gërmuar dheun përparrë këmbëve me furkaçen që mbante në dorë. Një nga mushkat e beut kishte hyrë në kopsht dhe po shkelte nëpër qepujkat që kishim mbjellë një javë më parë dhe që posa kishin dalë. Xha Metja, sa e pa, iu vërsul me furkaçen përpjete dhe e përzuri, duke i rënë dy tri herë pas vitheve. Nëpër dhiembë seç bluante me zëmërim kundër beut dhe bejlereshave. Ahere u duk dhe Zylyftari te dera dhe i thirri xha Metes:

— Do ta bluash, o Mete, dhe tanë ta bluash! — Dhe u derdh, rrëmbeu një thes, mezi e ngriti vetëm në sofat, pastaj e mtoi në kurri dhe hyri brënda. Xha Metja, Tasi dhe tē gjithë tē tjerët i ramë pas. Për një hop tē gjithë u gjendëm në errësirë dhe asgjë s'shikonim dot. Dëgjoreshin vetëm këpuçët me thumba tē Zylyftarit. Me inat

ay e lëshoi thesin dhe dolli prapë përjashta. Dhe kështu me radhë i solli që të katër.

— Tani, — i tha xha Metes, — zbraze koshin dhe hidh grurët tim!

— Këtë nuk e bëj dot, — ja ktheu xha Metja.

Tjetri ka radhën dhe

— Ahere do ta bëj unë! — ja preut fjalën ay xha Metes me inat dhe rrëmbeu lopatën dhe u derdh përm nga koshi. Po Tasi e zuri për krahun dhe i tha:

— Mos më trazo bukën e fëmijës se...

— Hiqu, more harbut, more qën, — fu kanos ay Tasit dhe e shtyri.

Tasi ra mbi duart. Po kurku ngrit nishte i verdhë dyllë, dhëmbët i kishte shtrënguar sikur donte t'ilthyente dhe me sytë gjysmë të mbyllur iu afroa dhe i hoqi një dackë turirit. Zylyftari u tund një herë, bëri sikur të binte, po e mori veten dhe zuri të nxirrite thikën nga mylli, që e mbante në brez. Ahere i u hodhi dhe xha Metja me Miçon. Unë rrëmbeva një shkop të thatë që gjeta prapa derës. Gratë thërrisinin të lebetitura. Burrat u rrukullisën mbi tokë dhe as që dukej se cili goditej. Vetëm të shara të ndyra dilnin nga gojët e shkumbëzuara të tyre që bash-koheshin me zhurmën shurdhonjëse të mullirit.

Ahere hyri brënda në mullinjë burrë i shëndoshë, me një kamzhik në dorë dhe thërriti kë mullirit.

— O Méte! O Mete!

Zylyftari e njoju nga zëri dhe bërtiti:

— Etem, hajde more, se më vranë harbutët!

Etemi u hodhi si i tërbuar dhe filloi të godiste kë mundte me kërbaçin e tij të lëkurët. Gratë, pinë dhë ato nga një pas kurrizit e zunë të thërrisinin e të mallkonin. Unë, duke u mbrojtur me shkopin tim, i rasha Etemit një dy herë pas kurrizit.

Zylyftari u shpëtoi nga duart të tre burrave dhe dolli përjashta. Pas tij rendi dhe Etemi. Ne i ndoqëm prapa.

Thika e Zylyfarit i kish çarë Tasit faqen dhe një copë mish i varej si lafshë këndezi e kuqe dhë më gjak. Duart e xha Metes dhë ato ishin të gjakosura. Për një hop të dy palët sikur po përgatiteshin përsulm. Këtë radhë gratë e filluan të parat.

— Po ti, mor i mallkuar, kë godet, hankon tënde, që t'i shkurloftë perëndia ditët!

— Pusho, moj bushtër! — ja bëri Etemi.

— Bushtër t'i thuash hankos sate! — dhe u ul e mori një popël në dorë. Etemi i ra me kamzhik. Tasi iu hodh Etemit me grushte në fytyrë. Miçua zuri prapë Zlyftarin që bëri pér nga Ristovica. Xha Metja u fut në mes të Tasit dhe të Etemit pér t'i ndarë.

Punën këtë radhë e mbaruam ne të tjerët — gratë dhe unë. Stapi im i thantë kërcitë nja tri a katër herë mbi kurrizin e Zlyftarit. Gratë po rrihnin Etemin. Ato e shtinë poshtë dhe i binin me grushte të mbyllura, ku mundnin, në kokë, në kurriz... Etemi gulçonte:

— Hiquni, moj bushtra!

Ristovica dhe Kostovica ja kthenin:

— Bushtër t'i thuash hankos sate! — dhe bamp ja lëshonin grushtet gjékundi.

Mirëpo Zlyftari e ktheu Miçon poshtë dhe po e shtërgonte në grykët. Unë e pashë dhe zura të thërres:

— Xha Mete, Tasi! e mbytti Miçon Zlyftari!

Ata i e lanë menjëherë Etemin dhe u derdhën pér nga Miçua. Ahere Zlyftari e lëshoi dhe u ngrit me zor më këmbë duke u tundur. Nga ana tjetër u ngrit dhe Etemi i gjakosur dhe më një sy të mbyllur. Dhe që të dy po zembrapseshin duke sharë. Ata u larguan nja tridhjet hapa, se ç'thanë në mes të tyre, pastaj mblodhën hajvanët dhe ikën. Drithët e lanë në mulli.

Si shkuan hyzmeqarët e beut, gratë i lidhën Tasit fagen me një copë pëlburë që ua dha xha Metja dhe ndënjën perséri përparrë sofatit të mullirit të prisnin gjersa t'u bluhet drithi.

Të nesërmen erdhi në mulli vetë djali i vogël i Nurçe beut, Ismaili; ngarkoi mushkat dhe kalin, i zemëruar dhe iku pa na thënë as një «rrini me shëndet»!

S'kishte kaluar asnjë javë, kûr një mëngjez hynë në mulli dy xhandarë me dyfekë krahëve dhe bashkë me ta kryeplaku i Thikësit, Minaj i Lukës. Xha Metja po mbushë një thes miell që ja mbaja unë. Pahu i miellit ja kish mbuluar qepallat dhe nuk i njohu se cilët qenë dhe

po vazhdonte punëri si gjithnjë i çkujdesur. Ahere u dëgjua zëri i njërit prej xhandarëve:

— Po ti s'dëgjon, bre, apo s'shikon se kush ka ardhur?

Xha Metja, jo se u trëmb, po e kishte zákon që cilido hynte në mulli ta priste me të mirë, e iu përgjigj:

— Më falni, zotérinj, se s'ju pashë; po urdhëroni, urdhëroni!

Unë me të vërtet u trëmbla, se fytyrat e tyre as që lëvizën nga fjalët mikpritëse të xha Metes.

— S'kemi ardhur për të ndënjur, — ia bëri Minaj i Lakes, — kemi ardhur për punë.

Xhandari tjetër që akoma nuk kish folur dhe që dukej se ishte më i madh, se në dorë mbante një kamzhik më rruaza, nga ata që bëjnë të burgosurit dhe kishte mustaqe të gjata e të përdredhura, foli rëndë rëndë:

— Merr teshat nji për nji dhe eja me ne në postkomandë!

— Pse? — ua ktheu xha Metja.

— Ajo është puna jonë! — ja bëri xhandarisi parë Minaj i Lakes i thoshte xha Metes si më të butë:

— Hajde Mete, mos u bëj kokëfortë, hajde menjëherë!

— Si të vij menjëherë, o Mina, në kosh kam akoma dyzet okë miell të Vasil Kozmajt! Këtu kam dy thasë të Dhosit dhe dy të Noxovicës. Shikoji në mos beson! Pastaj c'më doni?

— Ti e din vetë, — ja bëri ay që kishte mustaqe dhe shtoi prapë: — Merr teshat nji për nji dhe mos kthe fjalë!

— Dhe zuri të ecte poshtë e lart nëpër mulli duke u rënë çizmeve me kamzhikun me ruaza, dhë si për t'u përgjigjur shtoi: — Tasi, ai që rraffi Zilyftarin e Nürçë beut asht në bimsën e postkomandës; Miçon, gratë dhe ty po u thërrresim sot. Dhe ky mistrec do të dijë gja! — ja bëri ay duke më parë mua.

Struktur prapa një thesi, unë s'nixora asnjë fjalë nga goja.

Xha Metja iu përgjigj për mua:

— Mos përzjeni mudobare nipçen; ja unë po vij! — dhe mori setrën e tij nga zhgérjapi prapa derës, vuri dhë qeleshen në kokë dhe më tha mua:

— Kur të mbarohet thesi i Vasil Kozmajt, të he-

dhësh atë të Dhosit, se ay e ka radhën. Pasdreke shohim e bëjmë.

Mirë, ja bëra unë duke kërcitur dhëmbët.

Pastaj xha Metja dollin i pari nga mulliri. Ata i venin pas. Për mua s'bënë më fjalë.

Murxhoja e ndoqi xha Meten prapë dhe sado që ay iu kanos, qeni s'donte që s'donte të kthehej. Po si e ndolla dhe unë dy tri herë, ay qëndroi, angulliti dhe bëri prapa me bishtin ndër shalë.

Pasdreke xha Metja nuk u kthyte. Vasili i Kozmajt, që erdhi në mulli të marrë miellin, më tha se do t'i shpijen gjér në Korçë, të gjithë, të gjithë edhe gratë dhe se do t'i mbajnjë atje në burg gjersatë hapet gjyqi.

Më erdhi shumë keq por e mbajta veten. Sytë m'u mbushën me lot dhe ngrita kryet lart si për të kerkuar ndihmë dhe pashë në tra dy dallëndyshe që po më shikonin ngafoleja e tyre si me keqardhje. Atë mot, në mullirin e Thikësit, katër dallëndyshe kishin ngritur fole nëpër trarët në zezë të trashë të tavanit. Jeta në mulli kishte ndryshuar. Erika më kish dalë dhe unë vendosa të vazhdoj punën e xha Metes gjersatë kthehej.

Vinin fshatarët në mulli shkarkonin drithin dhe filionin muhabetin e fjalët tjerë atje i kishin — te xha Metja, te fshatarët e tjerë që i shpunë në Korçë dhe te hyzmeqarët e beut. Ndonjë ja bënte:

Dorta pinë të gjorët, për hiç mos gjë!

Dy javë i kalova vetëm filli, në mulli. Unë bluaja, unë shikoja gomarin, unë dilja dhen nga jazi përtaparë se mos lëshohej gjékundi. Fshatarët më thoshin:

— Të lumtë, kolopuç, nuk e turpërove xhaxhanë! Xha Metja lu kthyenjë natë i lodhur, i këputur. Kishte ardhur që nga Korça më këmbë. Pastaj dhe në burg e kishin munduar shumë, jo në hetime, jo në pyerje, më të shara e më të shtyra gjersatë u sqarua puna.

— Po ç'të sqaruar, mor bir, — ja bënte xha Metja. — Tasi me Miçon e pinë ngai një mot burg. Muà dhe gratë na lëshuan. Më bënë një me gratë, more nipçë. Hallbu që u plaka, përua trëgojan qefin unë atyre. — ja bënte xha Metja dhe tundte kokën duke nxjerrë ndonjë të sharë.

— O Mentor! Hajde, qëndroni i mëdha qëndroni i mëdha! —
— O Mentor! Hajde, qëndroni i mëdha qëndroni i mëdha! —
XXV — O Mentor! Hajde, qëndroni i mëdha qëndroni i mëdha!

HAJDUTE

— O Mentor! Hajde, qëndroni i mëdha qëndroni i mëdha! —
— Erdhi behari i nxeh të si saq! Barbu tha poshtë: fu-
shave dhe djemuria i nxirrin hajvanët natën! nga she-
shet e Korijes. Udha u binte nga mullinjtë: Vihin atá
duke kënduar é duke vërvhellyer shkonin si në dasmë:
Kuri arrinin te mulliri i sipërm, qëndronin dhe zinin të
thérrisinin:

— O Mentor! Hajde, o Mentor! Hajde, o Mentor! —
Unë që isha gati qëkuri dhe i prisja më padurim, u
përgjigjesha:

— Po vij, po vij! Si i lidhni! Duket që nuk ka më
një. I hipja gomarit dhe që të gjithë bashkë niseshim
për nga korija. Këngat jzentë përsëri: nëpër honet dhe
nëpër pyjet.

— Kur arrinim në vënd, ndaheshim ca këtu, ca atje
tej dhe secili zgjidhte ndonjë lëndinë të mire me bar të
njomë. Si i lidhni hajvanët, shtronim velenxat gjë-
kundi dhe sa na zinte gjumi, bënim muhabet më sytë
në qill, duke shikuar yjtë që xixëllonin dhe hënën që
shëtiste si ndonjë vajzë lozonjare herë duke u fshehur,
herë duke zgjatur kokën nëpër retë e përhapura ca këtu,
ca atje tej si shtëllunga të bardha! Në qetësinë e natës
dëgjoheshin vetëm hajvanët, që prisnin bafin me dhë-
mëbë si më gërshërë të imprehta! Qëntë vërtiteshin dy
tri herë rrrotull hajvanëve, pastaj mblidheshin kufullaç
dhe i zinte gjumi menjëherë, sikur ua mbyllte sytë ndo-
një njeri me dorë. Por dhe ne nuk e zgjatnim shumë;
të lodhur nga puna e ditës, gjumi na mundte dhe të
gjithë binim të çkuidesur. O mëdha qëndroni i mëdha!

Një mbrëma, qëntë u ngritën nga mesi i natës dhe
filluan të lehin. U zgjuam dhe rë. Hëna ndrinte si ditë.

Kafshët kullošnin të qeta. Vëtëm qëntë nuk gjenin rehat. Vinin nga vinin dhe lehnin. Ne nuk kishim armë, po latat të gjithë i mbanim në krye.

— O Mentor, — ja bëri Mandi duke ngritur kokin nga rrobat, — ç'kanë këta qëntë sonte?

— Mos kanë ndjerë ndonjë egërsirë! — ja ktheva unë duke dëgjuar me vëmëndje të lehurat e tyre dhe shtova: — Si më ujk lehin!

— S'më besohet, — tha Mandi, — tani në mes të beharit! Por s'është dhe çudi! Dhe u ngrit, mori latën në dorë dhe bëri për nga doriu. Pas tij u ngrita dhe unë: U ngrit dhe Koli i Qirioit. U ramë rrëth e rrotull kafshëve, po nuk vumë re gjë të dyshimitë. Kuajt kullošnin akoma, kurse gomari im ishte shtritur mbi barin e njomë dhe rrinte si i menduar. Qëntë rendnin përpara, ktheheshin dhe ngandonjëherë qëndronin në një vend, ngrinin kryet dhei mierrnin erë duke tundur bishtin.

— Do të ketë kaluar ndonjë njeri këtej, — tha Koli, — qëntë e kanë ndjerë dhe janë ngritur. S'më besohet të ketë egërsirë në këtë kohë, se dhe hajvanët kullošnin të çkujdesur! — tha ay dhe u kthy prapë në rrobat. Dhe qëni i tij, një qën stani, i murrimë dhe i madh i vajti pas.

Asgjë s'pripetinte. Nata ish aq e qetë, sa që dukej sikur kish qëndruar, të marrë frymë. Ndonjë zile binte aty këtu, e çkëputur, sipas çapeve që bënte hajvani duke kullotur. Dhe pastaj prapë heshtje.

Ramë dhe ne në rrobat, po gjumi nuk na zinte. Zumë të flasim me Mandin ngadalë, po fjalët, në netë të tilla, sado ulët, t'i thuash, ndihen dhe Koli, që akoma nuk kish fjetur, ja bëri:

— Hajde, flini tani se ja u gdhij! Nesër kemi për të shirë.

Dhe në heshtëm, secili si i humbur gjékundi në oqeanin e matës mendonte përdicë; përsë mendonte as vëtë nuk mund ta përcaktonte, po sigurisht në netë të tilla njeriu s'mund të mendonte përgjëra të liga.

Gjumi e mundi edhe Mandin, pse e ndjeva të gërhësë. Po edhe unë që isha me sy hapur, sikur dremitja i

dehur nga erërat dhe nga flëidi i ëmbël që frynte herë pas here. Dhe si nëpër èndërr dëgjova një krrëk, krrëk dhe pastaj disa çape kali. Qëntë u ngritën dhe u turrën përpara duke lehur. U ngritëm edhe ni. Rrëmbyem latat dhe bëmë për nga hajvanët. Doriu i Mandit nuk ishte.

— Hajdutë! — Thirri Koli i Qiricit dhe u derdh për nga qëntë.

— Hajdutë! Hajdutë! — thirri, dhe Mandi kur pa terkuzën e prerë të doriut. Dhe zuri të shantë pa ditur nga t'ja mbante.

Për një çast u ngritën më këmbë të gjithë djemuria. Qëntë lehnin kaf, kuf, kaf, kuf. Ndonjë thërriste:

— Kapeni, kapeni hajdutin!

Zérat dëgjoheshin dhe një herë akoma të mbytura nga pylli matanë: — Kapeni! Kapeni!

Kush me latë e kush me shkop në dorë rendte për nga qëntë. Nata ishte me hënë të plotë dhe i téré vëndi dukej si në pëllëmbë. Vjedhësi do t'i kish hipur kalit, se nëpër pyll dëgjoheshin çape troku dhe zhurmë fletësh.

Nga ndonjë anë vinte zëri i Mandit:

Këtej shkoj, more këtej! Kodoshi i m...

Koli i Qiricit dhe unë që e pikasëm të parët i ishim futur një monopati, pas të lehurave të qenërvë. Ne rendnim me të katër; shkelnim nëpër gurë, drurë dhe me gjithëqë degët e pemëve na pengonin, ne nuk i ndaheshim.

U dëgjua dhe një kobure, dhe jo shumë larg nesh. Kjo në vënd që të na trëmbte, na dha kurajë akoma më shumë dhe filluan të thërrësim:

— Këtej, more, këtej është kodoshi!

Qëntë sikur pushuan për një hop të trëmbur, pastaj filluan prapë të lehin. Vetëm njëri syresh angullinte. Kur u afroam, gjetëm të shtrirë Balon e Kolit që po jepte shpirt. Plumbi e kishte marrë në kokë dhe ay po përpëlitez dhe dridhej herë pas here. Koli e përkëdheli dhë, si e pa që qëni po shikonte, nxori një të sharë:

— Ah në më rënç në dorë, po s'ta... — dhe bëri përpara si i tërbuar.

— Qëntë rendëngjer në përrua dhë qëndruan. Dhe të lehurat sikur pushuan. Népér pyll dëgjoheshin vetëm zérat tonë: — O Mañdi, këtej more! këtej!

— Të gjithë u mblohdhën te përroi. Qëntë vërtiteshin në një vënd dhe lehnin herë pas here, po përpara nuk bënin.

— O e ka lënë kalin këtu, o i kanë humbur gjurmë qëntë, — tha Koli i Qiricit, — po s'duhet të humbim kohë, duhet ta zëmë atë kodosh e ta bëjmë fërtle; — dëshoi prapë një të sharë... dëshoi: — Ti Mandi, Koci dëti Pañdi bjerin nga kjo anë. Ne me Mentorin do të marrim përpjëtë përruan. Sado që të ketë ikur, këtu afër do të jetë, — dëshoi ndamë ca andej, ca këtej. Mandi ishte si i hutuar. Qëntë rendnin pas nesh. Nuk angullinte më as qëni i Kolit. Sigurisht që do të kishte ngordhur.

Ecëm sa ecëm ne me Kolin dëshoi pastaj qëndruam, po as një zë nuk ndihej, vetëm përroi gurgullintë, i qetë, megjithëqë do të dinte ndonjë gjë më tepër nga ne për hajdutin, i cili ose do të kishte kapérxyer, ose do të që tulatur gjékundi anës tij. Po ne ashnjë shënjë nuk gjetëm, që nga fundi e gjer në krye! Ishte thatësirë dësh gjurmë nuk kishim shpresë të zbulonim. Vetëm po të kishte kaluar përruan ay do të kishte lënë ndonjë shënjë, pra ndaj dëshoi ne kalonim gjithë anës përroit, po më kota.

Tërë kori ja zjeu atë natë nga të bërtiturat tonë dëshoi lehurat e qënve! Po hajdutin nuk e kapëm dot. Si i ramë ne përroit dëshoi ata pyllit, u mblohdhëm prapë tok. Tani Mandi ishte shumë i çjetësuar dësh gjithëqë ne i jepnimit zémër, ay ja bënte!

— Na shkoi, doriu, na shkoi! — dëshoi lotët hë hë t'i bien nga sytë.

Koci tha:

— Me tärë këto që bëmë ne, s'më besohet ta këtë marrë kalin, po kush e di ku kullot ay në ndonjë gropë!

Koli i Qiricit ja bëri ahore:

— Ty Mandi ay ta njeh zérin: ta kérkojmë dhe një heré duke e ndjellé. — Dhe u nisém përséri.

Mandi zuri tē thërriste:

— Dori, kërr, na! kërr, na! kërr, na!

Po doriu nuk bëhej i gjallé. Sa pér hajdutin, s'kishim më shpresë ta zinim, se kaloi shumë kohë dhe si-gurisht do tē qe larguar.

Kur zuri tē zbardhëllente dhe drita e mundi mugë-tirën, asnjë nuk shpresonte se mund ta gjenim doriun e Mitit. Prandaj Mandi i ngarkoi rrobat te pela e Koli Qiricit dhe si i vrarë ecte prapa nesh. S'ishte gjë e vogël, doriun kalën e shtëpisë, që e kishin si pjesëtar e shkuar pjesëtarin e familjes, e kishin humbur. Asnjë nuk kuvëndonte, kurse pér tē kënduar as që na shkonte ndërmënd; ecnim tē heshtur dhe tē gjithë mendonim vëtëm pér një gjë: pér doriun e Mitit.

Kur arritëm te mulliri, unë u ndava si fshehurazi, pa u lënë shëndet, se prapë duhej t'i thosha gjësendi Mandit pér doriun. Po ç'mund t'i thosha unë kur na e muarr nga duart përpara syve!

Me tē hyrë në mulli, ja tregova tē gjitha xha Metes. Dhe atë ditë te mullinjtë e Thikësit sikur pllakosi një vdekje e dytë pas asaj tē Nastës së ngrirë. Po nga drekëhera erdhi në mulli Kosta dhe na solli një lajm të papritur:

Kali i Mitit kish vajtur vetë në mes tē natës në shtëpi!

Si duket, hajduti, si e kish parë pisk që mund ta zinin, e kish lëshuar kalin dhe ua kish mbathur këmbë-ve pér tē shpëtuar lëkurën. Ndjekjet tonia nuk kishin vajtur kot. Vetëm Balua i Koli Qiricit u bë theror atë natë.

XXVI

NJË FIRAR

Shpesh na vinin në muli mysafirë, sidomos netëve të errëta; kur qielli mbulohej me re të zeza, të cilat ule-shin gjer poshtë mbi kokën tonë, gati të bien e të na pllakosin, sikur donin të na merrnin frymën. Në kohë të tillë asnjë nuk i nxirte hajvanët jashtë, se ishte lagë-shtirë dhe rrezik nga egërsirat. Se si thotë dhe një fjalë e urtë: «Ujku mjegull do!» Ahere ne mblidheshim me Xha Meten që shpejt anës kllanikut të mullirit të sipërm dhe bënim muhabet të ëmbël.

Në një natë të tillë u dëgjuan të trokitura në derë. Por asnjë zë. Ishte shumë vonë dhe xha Metja u ngrit vetë të shikonte se kush ishte. Të trokiturat u përsëritën me ngutësi. Xha Metja ahore as që pyeti, po e hapi menjëherë derën. Dhe hyri brënda një djalë i ri, të shumënja njëzet e pesë vjec, i gjatë e i hollë dhe i parruar.

— Ay nuk përshëndeti, po tha:

— A prisni miq, xhaxho?

— Urdhëro, urdhëro, — ja bëri xha Metja duke i zgjatur dorën. Pastaj e solli anës vatrës.

I panjohuri më zuri dorën dhe mua dhe ndënji pranë zjarrit duke shikuar nga dera si me frikë, pastaj pyeti:

— Humba udhën xhaxho, nga errësira e madhe dhe tani as që e di bile se ku ndodhem.

— Në mullinjtë e Thikësit, — ja ktheu xha Metja menjëherë.

Po këto fjalë sikur nuk shprehën gjë për të panjohurin, se ay pyeti përsëri:

— Unë jam nisur për në kalivet e vllehëve; kam ca të njojur atje. A bien larg që këtej?

— Janë nja... dy sahat larg. — ja bëri xha Metja, si u mendua pakë dhe shtoi: — Po në këtë kohë dhe katër s'do të të arrijnë. Prandaj fli son te këtu dhe nesër që menatë do të të shpjerë nipçaja gjer në kalivet brënda.

Nga kalivet e vllehäve ne bënim drutë dhe unë kisha vajtur shumë herë me gomarin dhe me djemtë e fshatit dhe ato udhë e shtigje i dija mirë.

— Ju faleminderit shumë, xhaxho, — tha ay, — po s'më pret puna, duhet të vete që son te, nesër do të jetë vonë!

— C'nxiton kaqë, — ja iktheu xha Metja me të qeshur, — sikur të ndjekin xhandarët?

Ahere i panjohuri u përgjigji i çqetësuar:

— Po, po, xhandarët, xhaxho! Po ti më dhe strehë pa më pyetur se ç'jam, e kush jam, më pranove për mik dhe nuk do më tradhëtosh?!

— Pse, ç'ke bërë? — i tha si me kaqardhje xha Metja.

— Faj, që nuk është faj; kam qëlluar qeverinë me artikuj dhe me shkrime nëpër gazetat.

— Dhe për këtë të ndjekin dhe duan të të vënë në burg?! — ja bëra edhe unë i çuditur.

— Ata nuk e lenë njeriun të mendojë i lirë dhe jo të shkruajë kundër tyre, — tha ay me një psherëtimë të thelli dhe shtoi: — Unë tani jam në dorën tuaj, xhaxho, dhe ju gënjeva kur ju thashë se jam nisur për në kalivet e vllehäve, se unë po shkoj për në Greqi dhe sa më parë, se po më ndjekin këmba këmbës dhe çdo minutë është rrezik për mua. Ajri i Shqipërisë është helm për atë që e do më shumë se veten e tij.

— Ahere do të jesh i urët, more djalë? — e pyeti xha Metja.

— Vërtet i urët jam, — u përgjigji ay, — se kam dy ditë që kam dalë nga Korça dhe po bredh maleve, pa kallur asgjë në gojë. Pojeta është më e shtrënjtë nga të gjitha. Prandaj ju lutem të më nxirni nga ky burg!

Fliste me zjarr dhe aqë bukur sa fjalët e tij m'u dukën si diçka përrallore, si diçka që e dëgjoja për herë

të parë dhe që ishte aqë e bukur, si ato gjérat që shikohen vëtëm nëpër éndra.

— Më nxore mallin e komitëve, more djalë, mallin e kohëve të vjetra, kur lëftonim për Shqipërinë kundëri Halldupit, — iu përgjigj xha Metja, dhe u ngrit më këmbë. — Në këto raste dhe një dalkikë ka të bëjë! Hajde, bëju gati dhe ti, Mentor, — tha dëshirat dhe zuri të mbathë opingat, pastaj hodhi në trastë një çyrek bukë dhe kupën me gjizë, nxori dhe dyfegun nga sëndyqi ku e mbante fshehur, e hodhi krahëve, vuri gunën përsipër dhe shtoi: — Hajde, djema, të nisemi. Tani unë jam kapedani juaj. — Dhe duallëm. Murxhoja na ndoqi prapa, po xha Metja e ktheu duke thënë: — Qëni éشتë si kollauz dhe i rrezikshëm në këto gjëra, — dhe e kyçi brënda

Jashtë ishte xup. Po xha Metja i dinte shtigjet edhe symbyllurazi. U nisëm. Xha Metja ecte përpara, pas tij vinim ne. Ecnim ngadalë, pa folur. Kaluam anës lumit, pastaj muarëm një të përpjetë dhe xha Metja na nxori te Izvori. Kur arritëm pranë burimit, xha Metja na tha duke pëshpëritur:

— Hajde këtu të rrimë të çlodhemi pakë!

Xha Metja nuk kish marrë as cigare, as fenerin e mori me vete dhe, si ndënjam, ja bëri:

— Hë, të kisha një cigare tani, një mijë florinj bënte! Po hallbu që nuk duhet të bëjmë dritë, se e liga nuk dihet nga vjen! — Të panjohurit i tha: — Tani merr këtë copë bukë dhe këtë gjizë dhe ha! Na dhe ti, Mentor, ca! Të hamë dhe ne nga një kafshatë se na pret udhë akoma, — dhe prapë shtoi: — Po më nxore mallin e komitëve, more djalë, mirë bëre që erdhe. Dhe mos flisni, hani dhe pushoni se zërat tani dëgjohen nga bregu në breg dhe e liga s'dihet nga vjen!

Sytë sikur na u mësuan me errësirën dhe megjithëqë s'kishte hënë dhe qelli ishte i mbuluar me re, duke shin siluetat tonë dhe lëvizjet që bënëm me dorë duke ngrënë. I panjohuri hante shpejt. Kjo dukej nga lëvizjet e duarve të tia. Si hëngrëm bukë, xha Metja u ngrit dhe piu ujë e u shtri sa gjatë gjerë mbi burimin. Pastaj i tha firarit dhe mua:

— Tani, djema, pini nga një ujë dhe ju se do kalojmë shtigjeve dhe s'besoj të rastisim burime udhës.

Gjiza ishte shumë e kripur dhe e kërkonte një ujë. U shtritëm dhe ne të dy me radhë mbi burimin dhe pastaj u nisëm përsëri.

Duke ecur, unë e merrja me mënd udhëni që kishim bërë. «Izvori bie në lindje të mullinjve, d.m.th. kishim marrë vahun e lumi, pastaj kishim kaluar pranë shkëmbinjve të Shën Kollit, dhe andej drejt te Izvori, po tani, thosha unë me vete: «Eh, xha Mete, xha Mete, ti qënkérke si dhija, ngjitesh dhe në majë të ckërkave dhe di dhe dialet më të fshehta të pyjeve e të maleve dhe në mes të natës, e në errësirë; të lumtë!» Po ngjiteshim në një të përpjetë thikë pse gjunjët na epeshin dhe këmbët na shkisnin për prapa. «Ku do të jemi këtu, ja bëja unë, mos kemi arritur në të përpjetat e Sufariut, apo jemi nga pllajat e dhënve!» Kur xha Metja ja bëri:

— Tani, djema, i shtrëngoni rripat mirë, se po i futemi Gramozit.

— A është dhe shumë larg kufiri? — ja bëri i panjohuri:

— Kufiri nuk është larg, të jetë, të jetë dhe nja gjysmë ore, po do gjetur shteg i volitshëm, — ja ktheu xha Metja.

Në këtë çast u dëgjua një e vërvshëlyer, pastaj dhe një tjetër, akoma dhe një tjetër.

— Kush mund të jetë? — tha i panjohuri dhe shtoi:
— Mos na kanë rënë prapa?

— Jo, jo, — ja ktheu xha Metja. — Janë vlehet, ruajnë bagëtinë këtej dhe herë pas here lajmërojnë njëri tjetrin që s'ka gjë. Po gjene mirë që s'ramë në ndonjë kope, se kanë qënër shumë të këqinj dhe do të na kishin pikasur.

Hymë në një pyll. Drurët sikur këndonin dhe çapet tonë nuk dëgjoheshin. Fletët e aheve fëshférinin, përtiqeshin njëra me tjetrën sikur pëshpërisnin diçka vesh më vesh midis tyre, po me aqë ëmbëlsi, me aqë dashuri, sikur përqafoheshin. Pastaj kjo këngë shtohej e shtohej sa kapte tërë pyllin, tërë drurët dhe një fiu, fiu sillej

nëpër erë dhe të gjëzonte shpirtin, sikur të jepte krahë për të ecur. Vënde-vënde përpinqeshim pas ndonjë dege, kapeshim pas fletëve, binim, ngriheshim, po asnë nuk nxirte as gjysmë fjale, se në pyll s'ka vetëm egërsira, sidomos anës kufirit. Xha Metja ecte si ndonjë djalë përpara dhe s'kishte ndërmënd për të qëndruar. Ne ecnim si të verbër prapa tij. Kur dëgjonim ndonjë zhurmë, qëndronim pakë, vinim veshin, pastaj xha Metja i thoshte:

— Hajde, djema!

Dhe ne niseshim. Unë doja të mbaronte sa më shpejt kjo lodër e verbër, dhe jo se isha lodhur apo nga frika, po më shumë nga që s'shihja se ku venim e se ç'bënim. Vetëm kapedani ynë e dinte këtë punë dhe ne ja kishim lënë jetën atij ndër duar, siç kish lënë jetën firari në duart tonë.

Në një vënd xha Metja qëndroi, u kthyte prapa nga-dale dhe na tha duke pëshpëritur:

— Ju prisni këtu, të shikoj dhe një herë mirë se ku jemi! — Dhe u largua nj'a dhjetë hapa. Ne mbetëm si dy hunj më këmbë mbështetur pas një ahu. Por xha Metja nuk u vonua, u kthyte menjëherë dhe pëshpëriti përsëri:

— Tani, more djalë, mund të të themi udhën e mbarë! — Dhe i hodhi të panjohurit duart në qafë e, si u puthën, i tha: — Dhe mirë bëre që erdhe, besa, se më nxore mallin e komitëve!

Pastaj u përqafova dhe unë. I panjohuri nxori nga brezi një nagan të vogël dhe ma dha, duke më thënë:

— Xhaxhoja ka dyfegun e tij, ay ka lëftuar me të kundër Halldupit, ti dhe unë të lëftojmë kundër tiranëve të sotëm.

Xha Metja që po na dëgjonte ja bëri:

— Djema, lerini fjalët tani, se jemi në gojë të ujkut! — dhe shtoi: — Ti, more djalë, do të marrësh drejt, do të ecësh një pesëdhjetë çape dhe pastaj je matanë. Hajde, udhën e mbarë! Ne do të presim këtu gjersa të largohesh. — Dhe u ndamë.

Ndaj të gdhirë hymë përsëri në mullinjtë e Thikësit si të mos kish ngjarë asgjë në natën e errët.

XXVII

KULLOTAT E SHKËMBIT TË BLETËS

Lajmet vinin, më shpejt se kudo gjetkë, në nulli. Rrinin gratë nëpër kërcunjë e sofatit përpara derës dhe fillonin fjalët dhe nuk kishte të re që dilte në fshat e të mos hidhej dhe gjer në nulli, ngandonjëherë bile më parë se edhe në fshat vetë. Po kjo që thoshin tani ishte me të vërtetë e çudiçme. Të djelë do të nxirnin bagëtinë nga sheshet e Shkëmbit të Bletës, në kullotat që ua kishin rrëmbyer xhufkallitë, dhe jo burrat, po gratë, gratë, ore, kishin ngritur krye. Dhe e djela pritej hem me frikë të madhe, hem si diçka e re, e gjëzuar.

Tri katër ditë zjenë këto fjalë në fshat dhe hidhe-shin gjer te sofati i mullirit. Gratë po përgatiteshin për të djelën dhe jo fshehurazi, po sheshit, ua thoshin në sy dhe xhufkallinje kur shkonin nga fshati i tyre. Po ata nuk e besonin, se kush i kish kundërshtuar Nurçe beut gjer ahere?... Ay të pinte me shikimin e tij në udhë e pa gjë dhe jo t'i veje në mallin që e kish me tapi «den baba den» si thosh ay vetë.

Se si u bë dhe kush e kurdisi vajtjen e grave në kullotat, asnjë s'mund ta shpjegonte, po që të gjitha kishin vendosur të vinin, asnjë të mos mbetej në fshat dhe qeshnin: «Gjer sot Thikësit i thoshin fshat i grave, tani e tutje le t'i thonë fshat i burrave, se të djelën vetëm burra do të ketë në fshat!»

Dhe ne djemuria kur dilnim me hajvanët përjashta nuk flisnim për gjë tjetër, po vetëm pér të djelën. Dhe që të gjithë ishim të një mëndjeje, që dhe ne duhej të venim bashkë me to, se ishim të vegjël dhe sidomos që të ngjiste, skishin se ç'të na bënin!

A i kini vënë re mjeshtrit nëpër mademet kur çaj-në shkëmbën? Ata bëjnë sefte me qysqi një vrimë të thellë, pastaj vendosin brënda dinamitin dhe që nga larg ndezin një fitil. Kështu ngjiste dhe Thikësi në këto ditë. Fitili ishte ndezur, po dinamiti nuk kish plasur akoma.

Të djelë, që menatë, në vënd të çobenjve, bagëtinë i muar gratë e fshatit përpara. Dhe jo një e dy, po të gjitha. Në fshat mbetën vetëm çupëria dhe burrat që nuk ishin në kurbet. Një karvan djem i ndiqnin prapa. Ato i përzinin, u kanoseshin, po pas pakë ata u dilnin nga ndonjë anë tjetër, kështu që kur kaluan nga mullinjtë, nuk ishin vetëm gratë po dhe një pesëmbëdhjetë djem të vërsës sime. Midis tyre Mandi, Koli, Koci... Me ta u bashkova dhe unë. Xha Metja ishe nga ana e grave si gjithnjë me ata që vuanin dhe jo që nuk më ndaloj, po i qeshi dhe buza kur më pa që dhe unë u bashkova me ta.

— Rrrr! Rrrr! — ja bënin gratë kur shikonin ndonjë dele të ndahej nga kopeja dhe i binin të shkonte përpara. Ato nxitonin t'i shpinin sa më parë në kullotat e majme të Shkëmbit të Bletës. Dhe një pluhur ngrihej përpjetë, se ato nuk i ngisnin bagëtinë mbi rrugë e nën rrugë, po drejt në mes të udhës dhe nxitonin sikur do të vonoheshin dhe sheshet nuk do t'i gjenin më.

Ndonjë edhe këndonte bejte:

— Dil e dil, o Nurçe be,
Se të vimë me kope...

Pastaj të gjitha qeshnin.

Dhe kishin të drejtë gratë e Thikësit të lëftonin për sheshet e Shkëmbit të Bletës, se ata janë një bukuri e rrallë; sidomos beharit, kur bari poshtë në fshat thahet, aty gjelbëron vëndi si ndonjë qilim i bukur i gjelbër e plot me lule, dhe çfar bar kanë... mjaltë të ëmbël!

Kur arriten aty gratë dhe i lëshuan dhëntë të kullosin, këto zunë të hanin si të pangrëna dhe nuk luanin nga vëndi.

Ndonjë ja bënte:

— Hani, xhan, hani!

Ato më plakat zunë vënd mbi barin e blerët dhe me furkat në dorë zunë të tjerrin. Më të rejat u bashkuani me ne djemurinë, dhe filluan të lozni dhe ato cingëlazi.

Gjithëçka vazhdonte si të mos kishte ngjarë asgjë, si të thuash, sikur ishin përpara sofatit të mullirit — plakat fjaloseshin duke tjerrur dhe herë pas here hidhnin nga një sy poshtë për të parë se mos vinin njerëzit e Nurçe beut. Ne lozni.

Gjer nga drekëhera ishte qetësi. Gratë nxuar nga torbat ç'kishin marrë me vete, kush gjizë e kush qepë dhe i shtruan në mes të hanë, fshaçë. Aty ishte ç'ishte! . . . hidhnin rromuze për Nurçe beun e për xhufkallitë dhe kërdiseshin së qeshuri.

Po si hëngrëm drekë, u dukën tutje nga Izvori nga pesë veta. Njëri prej tyre ishte hipur në kalë. Ata nxitonin përpjetë dhe pluhuri ngruhej si bisht prapa tyre. Në i pamë dhe për një hop të gjithë sikur ngrimë më këmbë. Një e rrënqethur kaloi nga njëri te tjetri. Gratë u mblodhën xhumble, me stërpinj në dorë dhe të vrënjtura. Ne djemuria u vinim vërdallë, donim të dëgjonim se ç'toshin e ç'do të bënin!

Akoma që nga larg xhufkallitë zunë të thërisnin duke sharë:

— E ku i kini lëshuar dhëntë, o bushtra!

— Tani do t'ju çaplejmë! — ia bënte tjetri.

— Mos pandehni se kemi vdekur, hë! — ja bënte i treti.

Ay që ishte hipur në kalë, qe vetë Nurçe beu. Unë e njoha menjëherë dhe në shpirt m'u ngjall ajo urrejtja e vjetër e asaj dite kur desh na shtypi me atin e tij. Nuk thërriste, po hijerëndë, shikonte herë më të mëngjër, herë më të djathë dhe ngadonjëherë seç u thoshte njerëzve të tij. Kur u afroan, si të tèrbuar zunë të përzinin dhëntë, t'i ndiqnin me gurë. Dhe kopeja sulej një herë këtej, një herë andej si re që venë nga i shtyn era. Bleqerinin, pengoheshin dhe binin njëra mbi tjetren dhe si të harra-katura ja mbanin nga ndonjë anë. Edhe gratë u trëmbën. Vetëm ndonjë plakë u thoshte:

— Prisni, more, ç'bëni kështu si të marrët!

Po si çdo gjë ka fund, kështu ngjau dhe këtu. Një gjë e papritur e ndrroi menjëherë gjëndjen. Një popël e xhufkallinje kishte lënë në vënd delen e Sotiricës, bejkën, atë më të mirën, që u jepte një okë qumëshët në vaht dhe bashkën më të mirë. Iu errën sytë kur e pa Sotirica dhe u derdh për nga delja, po ajo kishte ngordhur. Ahere iu lëshua një xhufkalliu dhe i u hodh përsipër duke e mallkuar, po ay ishte më i fortë, burrë hesapi, dhe e vuri poshtë. Gratë e tjera këtë sikur prisnin; iu turrën xhufkallit dhe kush me stap e kush me dorë e shtrinë përdhe. Ahere dhe xhufkallitë e tjerë i lanë dhëntë, u derdhën për nga gratë dhe zunë të rrihen. Nurçe beu rrinte mënjanë dhe shikonte si ndonjë gjeneral kur vëzhgon se si vete lufta. Kur pa që njerëzit e tij humbën fare në mes të grave, u derdh dhe ay t'u ndihmonte. Po kush të pyeste atje se kush je?! Hëngri dhe ay ca stërpinj të mirë pas kurrizit dhe u largua pakë. Po u fye keq, nxori koburen nga brezi dhe zuri të shtinte në erë. Ahere gratë u shpérndanë, një këtej, një andej dhe ne djemuria, që po mblidhnik bagëtinë, u kthyem të trëmbur prapa të shikonim se ç'po bëhej. Dy xhufkallinj akoma po dergjeshin mbi barin e njomë. Sotirica, Sava, Limbia, Ristovica ishin të gjakosura dhe leshralëshuara, po as që loznin nga vëndi. Tani nuk shanin më xhufkallitë, po ato u thërrisin dhe i malkonin:

— Hë, more të paudhë! More qënër! More të mallkuar!

Po ata s'u kthenin përgjigje, përpinqeshin të sjellin në vete dy prej shokëve të tyre që akoma nuk ishin ngritur. Më në fund njëri prej tyre u ngrit, po mezi mbahej më këmbë. Tjetri **vetëm hapi sytë, se nuk luante dot nga vëndi**. Gratë e kishin shëmkosur rëndë.

Ahere Nurçe beu, që rrinte më këmbë, seç i tha mengadalë njërit prej tyre. Ai rendi dhe solli kalin. Dhe atë që dergjej mbi dhe tre veta mezi e hipën në kalë.

Pastaj u nisën duke sharë e duke u kanosur. Dy veta e mbanin të rrahirin një këtej, një andej si nuse me tele. Nurçe beu ecte pas tyre me koburen në dorë, se kishte frikë mos u lëshoheshin gratë nga prapa.

Ato po i mallkonin:

— Hi e shkrumb u bëfshi! Që na pitë sytë na pitë!

Si u largua Nurçe beu me xhufkallitë, gratë e muar veten dhe zunë kush të ndreqte flokët, kush të fshinte gjakun, se ca prej tyre ishin çjerrë e shpupurisur. Pastaj Sotirica vajti te bejka ta shihte se mos kish ardhur në vete: Po jo, ajo kishte kafshuar gjuhën mënjanë dhe shikonte me sy të çakarritur e të hapur si kamare. Sotirica nuk qau, po mallkoi një herë rëndë. Nurçe benë duke e fërkuar butë butë në kurri z delen e saj, si të përkëdhelte një njeri të afërm, shumë të afërm.

Gratë, atë natë, s'u kthyen në shtëpi. Ne djemuria zbritëm poshtë t'u marrim bukë dhe u kthyem prapë. Dhe ashtu si e prisnin, ashtu ngjau. Të nesërmen erdhën në kullotat e Shkëmbit të Bletës nga dhjetë xhandarë. Po dhe ata s'i bënë dot zap gratë. Mor u folë me të mirë more me të keq, gratë përgjigjeshin:

— Ne këtu do të vdesim dhe s'ua lemë kullotat tona xhufkallive!

Një kapter që kishte ardhur me xhandarët deshi t'i përcajë. Ay u thoshte cave:

— Hajde, shkoni ju se asgjë s'do t'ju bëjmë!

Të tjerat i trëmbte se do t'u arrestonte burrat:

— Burrë s'do të le në fshat, ta dini!

Po ato i përgjigjeshin:

— Burrat s'kanë gjë në këtë mes, bëni si të doni!

Dhe panë ç'panë, ikën dhe ata.

Një javë të tërë gratë ndënjen në mal, bashkë me dhëntë. Xhandarët hynin e dilnin në fshat, kanoseshin, po asnjeri s'trazonin. Dhe nga se do të thoni ju? Se si gratë e Thikësit ishin ngritur dhe ato të Rripësit dhe, pa c'pa beu, hoqi dorë me anë të forcës dhe vendosi t'u mirrte hakun grave me anë të ligjit, pse i paskëshin rrëmbyer mallin që e kish «den baba den», dhe i hodhi Thikës që e kish «den baba den». Dhe duhej të vente gjer në Stamboll për t'i marrë dhe Thikës tanë i kullosnin hajvanët nga sheshet e Shkëmbit të Bletës dhe s'ja kishin më frikën as atij as xhufkallive.

XXVIII.

SHTËRGATE

Aty nga mesi i gushtit, dy ditë me radhë bëri rëjë vapë aqë e madhe sa që dhe ujët e pakë të lumit, që hiqej zvarrë si ndonjë gjarpër i plagosur, dukej se si avullonte. Gropa e mullinjve ngjiste si furrë qymyri e posashuar, po që akoma ka prush dhe një afsh i ngrohtë të përcëllonte tërë trupin. Mbremave koha binte pakë, po të nesërmen, posa shkrepente dielli, të përvëlonte sikur kish vendosur të thante çdo gjë të gjallë që kishte mbetur akoma më këmbë. Bari kishte kohë që ishte tharë, po dhe fletët e pemëve që gjelbëronin, u fishkën dhe rrinin kokëposhtë, si zogj të vrarë. Ndonjë cërré, duke fluturuar, binte përdhe, përpelitej dy tri herë dhe pastaj e shpupurisur dhe pashpirt mbetej në vënd si një gur i murrmë.

Xha Metja ja bënte duke fshirë djersët e ballit:

— Vapë të tillë nuk mbaj mënd. Bëri vërtet kur erdhi gjonglia, po jo kaqë! Do të bjerë ndonjë shi i zi a i kuq, një perëndi e di!

Dhe me të vërtetë, në qiellin e kaltërt atë ditë u dukën ca re përtej maleve të Qafëzezit, të cilat duallën si fshehurazi, sefte të vogla e të murrme, po pastaj zunë të vërtiteshin si shtëllunga, të zmadhoheshin, të zmadhoheshin dhe sa më lart venin aqë më shumë bëheshin të zeza dhe sikur rëndonin, se lëviznin ngadalë, fryheshin dhe ca nga ca po e zinin qiellin e kaltërt, që ishte mbuluar si me ndonjë rjetë nga qiqi që dridhej nëpër erë.

Ishte ndajnatëherë vonë, po gjersa u ngrys qielli u mbush plot me re dhe nga dy tri anë zuri të vetëtinte e herë pas here të dëgjoheshin gjëmime të thella, larg. Shi akoma nuk kish zënë, po një erë kolendroje u përhap nëpër hapësirë dhe shpesët s'dinin ku të gjenin vënd; fluturonin, kush poshtë e kush lart shpejt dhe të trëm-

bur, kurse Murxhoja u fut në mülli, u mblohd kutullaç afër vatrës dhe ra në gjumë.

Xha Metja bënte ç'bënte dhe dilte jashtë shikonte motin. Kur hynte brënda thoshte:

— Mor që lipsej një shi, lipsej, po më duket se do të na vijë shtërgatë!

Para se të binim në gjumë, xha Metja dolli dhe kë-puti jazin në dy tre vënde. Kur u kthyte, më tha:

— Shi akoma s'ka zënë, po andej nga Furka retë po vinë vërdallë sikur po bëjnë luftë. Retë e Furkës janë të pabesa, Mentor. Pylli është i dëndur dhe e tërheq shumë shinë.

Nga Furka ishin izvoret e lumiit të mullirit, ndaj ua kish frikën xha Metja.

Ramë të flinim. Dhe brënda në mulli, ku mokrat rënkonin si të sëmura, hynte ndonjë vetëtimë dhe pas saj dëgjohej një bubullimë që trondiste gjithë vëndin. Shiun nuk e dëgjuam kur zuri, po të nesërmen në mëngjez, kur u ngritëm, binte një shi i rrëmbyer e i dëndur sa që nuk shikoje dot përpara.

Herë pas here hidheshim me xha Meten gjë te dera për të shikuar se mos pushonte, por për të shtuar shtohej e për të pushuar as që kishte ndërmënd.

Xha Metja ja bënte:

— Kështu si e ka nisur as që ka për të pushuar! Do të bëjë ndonjë gjëmë ky shi sot!

Atë ditë asnje njeri nuk na erdhi në mulli. Dhe s'kishte se si të vinte se përrënjtë u frynë si lumën, lumënjtë u bënë det.

— Do parë cfrati, — ja bëri xha Metja aty nga drekëhera, kur e pa që shiu vazhdonte të binte ashtu si kishte filluar që me natë. — Ky shi mund edhe ta marrë. S'do të bëjmë keq sikur të vemi t'i vëmë ca direkë prapa, hë?! — Dhe pa pritur përgjigje nga unë, shtoi: — Ti, Mentor, mer shatën, unë do të mar direktë dhe hajde të vemi të shikojmë një herë!

U nisëm nëpër shi, zbathur me nga një thes në krye. Po shiu binte si me ibrik, vëndi ishte bërë qull dhe këmbët herë pas here na fundoseshin nëpër tinën e jazit, i cili megjjithëqë qe këputur, ishte mbushur plot ujë

nga rrëketë dhe vijat e vogla që derdheshin me rrëmbim në të. Unë e këputa dhe në ca vënde të tjera, po aty këtu dheu ishte vithisur dhe ujët kalonte si lumë poshtë.

Lumi ishte i turbullt e i rrëmbyer, kërcente me tèrbim mbi shkëmbënjtë, sikur donte t'i coptonte e t'u merrte hakun për gjëkafshë.

Herë pas here fapëtinte dhe ahore dukej fare mirë trupi i xha Metes me të dy trarët në sup, pastaj një gjëmim të shurdhonte veshët dhe përsëritez në kodrën matanë; një tjetër i përgjigjej nga tutje dhe gjithë vëndi zjente nga gjëmimet dhe jehonat.

Cfrati me të vërtet ishte në rrezik. Ujët e lumbit vinte gjer atje, përpigjet pas murit, kërcente përpjetë dhe i shkumbëzuar hidhej matanë, aty sikur qetësohej pakë dhe vazhdonte përsëri vallen e tij të marrë.

Xha Metja i lëshoi trarët mënjanë. Hoqi thesin, zveshi dhe këmishën e mbeti vetëm në brekë. Pastaj rrëmbeu njërin tra dhe zuri të futej në lumë. Shkelte dhe qëndronte një hop sa t'i zinte këmba vënd mirë, pastaj bënte dhe një çap akoma. Unë mbaja trarin jashtë lumbit. Vala e lumbit i kërcente mbi kokë, e spërkatete, e shtynte, po ay ecte ngadalë përpara.

Kur arriu nga mesi i cfratit, ay e tèrhoqi tèrë trarin dhe e pérplasi pas murit, anën tjetër e shtrëngoi në një shkëmb anës lumbit. Si e vuri, e tundi dy tri herë me dorë dhe kur e pa që kishte zënë vënd mirë, dolli përsëri, rrëmbeu trarin tjetër dhe u fut prapë në lumë.

Shiu, po vazhdonte i rrëmbyer si më parë, lumi sikur rendte poshtë, si ndonjë at i tèrbuar dhe t'i merrte mëntë me shpejtësinë dhe shtelljet e tia.

Tani xha Metja po kalonte mesin e lumbit për të vënë tranë prapë gjékundi prapa murit dhe po lëftonte me valët. Aty këtu qëndronte sikur donte të merrte frymë. Kur kaloi në mes, vala i ra mbi kokë dhe ay humbi një çast nëpër ujët, po tranë nuk e lëshoi nga duart. Një vetëtimë që çau qiellin si ndonjë sharrë, me dhëmbë më bëri të mbyllja sytë. Muri i cfratit zuri të tundej.

— Xha Metee! Xha Meteee! Xha Meteeee! — zura t'i thërrisja unë, por zëri im humbiste në zhurmën e lumbit dhe të bubullimavë dhe as që dëgjohej.

Xha Metja po përpiquej t'i gjente vënd trarit të dytë,
kur një anë e murit u këput dhe gurët u rukullisën
poshtë.

— Xha Metee! Xha Meteee! — po thërrisja unë.

Xha Metja e kishte vënë re rrezikun që po e kërcë-
nonte dhe po përpiquej të dilte, po nuk nxítonte dot se
ujët ishte i rrëmbyer dhe i thellë. Trarin e kishte lëshuar.
Pa lumi që kishte rrëzuar anën e sipërme të murit,
zuri ca nga ca të hante dhe pjesën tjetër. Gurët binin në
lumë dhe rrukulliseshin poshtë. Valët vinin më të rrëm-
byera. Direku i parë i xha Metes kishte zënë vënd mirë
dhe lumi e hëngri gjer atje cfratin, po gjysma mbahej.
Xha Metja po bënte çapet e fundit dhe unë me duar të
ndera po e prisja përjashta për t'i ndihmuar, kur një kér-
citje na shurdhoi veshët. Dhe trari tjetër u thye, muri i
cfratit u përplas si ndonjë shkëmb poshtë dhe e mori xha
Meten përrpara.

Unë me duar të ndera po thërrisja:

— Xha Metee! Xha Meteee! Xha Meteeee!

Po Xha Metja u zhduk në valët e rrëmbyera e të
turbullta të lumbit. Dhe mbeta vetëm në mes të shtërg-
gatës!

* * *

Një shtërgatë e tillë, në mos edhe më e tërbuar,
kishte shpërthyer edhe anembanë Shqipërisë. Nuk ka-
luan më tepër se gjashtë muaj dhe tërë vëndi u shkel nga
Italia fashiste.

PËRMBAJTJA

Faqe

Vdekja e nënës	3
Teze Aisheja	10
E Dervishit, Hallë Fatimeja dhe Sali Agai	15
Si na shkoi nga quartë Shabani i vogël	19
Babai niset për në kurbet	24
Çuarja e fëmijëve	27
Dita e parë e shkollës	33
Si u rrukullis një vit	37
Fundi i vtit shkollor	41
Një fatkeqësi e papritur	47
Tre muaj në spital	51
Si ika edhe unë nga K....	57
Një udhëtar i panjohur	60
Miti, Tasi dhe Nurçe Beu	64
Një natë te Miti	70
Mullinjt e Thikësit dhe xha Metja	76
Si u ndryshua xha Metja	83
Jeta në mulli	88
Dimër	97
Metja sjell në mulli Nastën e ngrirë	102
Ujqër	109
Ditët e fundit të dimërit	111
Një ditë në Thikës	115
Hyzmeqarët e Nurçe Beut	119
Hajdutë	125
Një firar	130
Kullotat e Shkëmbit të Bletës	135
Shtërgatë	140